


REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT



ZBUTJA E RISKUT NË VEND DEPOZITIME

RAPORT FINAL

TIRANË 2018

TITULLI: ZBUTJA E RISKUT NË VEND DEPOZITIME / RAPORT FINAL

Qershor 2018

Autorësia dhe kontributet: Ky dokument u përgatit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nën drejtimin zv. Ministres znj. Ornela Çuçi, mbështetur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (DLDP), përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC), me ndihmesën teknike të konsulentit UTS-01.

Grupi i punës:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: Ornela Çuçi, Lediane Karalliu, Rezart Fzhazi, Borana Antoni; Sonila Pashaj; Juldin Braholli; Polikron Horeshka.

DLDP: Valbona Karakaçi, Rikard Luka

Konsulentit UTS-01: Markel Baballëku, Olti Marko, Alfred Lako, Gjergji Foto, Erion Bukaçi, Rezeart Zgjanjulli, Ani Verzivolli, Marsida Tuxhari, Paolo Kraja, Ana Bregu.

Fjala hyrëse dhe falënderime

Nisma “Për zbutjen e riskut në vend depozitime” lindi si një nevojë për të njohur në thellësi gjendjen ekzistuese të vend depozitimeve në rrafsh kombëtar dhe për të adresuar një grup zgjidhjesh të përshtatshme për zbutjen e risqeve që këto infrastruktura shfaqin. E udhëhequr nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, kjo Nismë përfshiu stafet e Prefekturave dhe Bashkive në të gjithë Shqipërinë.

Procesi i nisur në fillim të muajit Shkurt dhe i përmbyllur në një afat rekord 3 muaj, përfshin punën në terren të mbi 250 ekspertëve lokal, të cilët në mënyrë të vazhdueshme pasuruan platformën e të dhënave me gjithë informacionet teknike të nevojshme. Vlen të theksohet që, vlera e shtuar e këtij procesi ishte bashkërendimi i ngushtë i punës së strukturave të qeverisjes qendrore dhe atyre vendore.

Mbështetja nga programi dldp (Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor) mbuloi aspekte metodologjike, ngritje kapacitetesh dhe lehtësim të proceseve organizative. Studimi ndërton mbi disa baza praktike (si ajo e Dibrës) të zbatuara me sukses në Veri të Shqipërisë. Kompania zvicerane CSD Engineers, e përfshirë përmes dldp, që përpara nisjes së procesit, hartoi Metodologjinë “Për zbutjen e riskut në vend depozitime” duke sjellë përvojën ndërkombëtare në dokumentin që udhëhoqi teknikisht këtë Nismë.

Për të mundësuar zbatimin e kësaj Metodologjie është amenduar VKM Nr. 452, dt. 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”, me mbështetjen e GIZ Albania. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që bashkitë sot të arrijnë disa standarde për vend depozitim të mbetjeve të tyre për një periudhë tranzitore deri në ndërtimin e lëndfilleve dhe inceneratorëve sipas Masterplanit.

Vleftësimi i të dhënave të grumbulluara dhe analizave teknike, thuajse me gjithë aktorët publikë dhe privatë që janë të angazhuar aktualisht në sektorin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, rrit ndjeshëm qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura. Së fundi, harmonizimi i kësaj Nisme me instrumentet strategjike kombëtare, që janë në hartim e sipër, si dhe vlerësimi që ekspertiza akademike i dha procesit, metodologjisë dhe rezultateve të platformës së ngritur janë një bazë e sigurtë për kalimin në fazën e zbatimit të nismës “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”.

Së fundmi, shpreh vlerësimin maksimal për të gjithë ekspertët e përfshirë në këtë proces, e në veçanti atyre vendor të angazhuar nga Prefekturat dhe Bashkitë, të cilët në punën e tyre të pareshtur pasuruan në mënyrë të vazhdueshme këtë platformë.

Dr. Ornela Çuçi

Zv. Ministër

Ministria Turizmit dhe Mjedisit

AKRONIME

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BE	Bashkimi European
DLDP	Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor
FIN	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrument i Para Aderimit
IPA-CBC	IPA Cross Border Cooperation
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KRRT	Këshilli i Rregullimit të Territorit (i Bashkisë ose i Qarkut)
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
KRWM	Korça Regional Waste Management
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban (ish Ministri nga viti 2017)
NJA	Njësi Administrative
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
RAT	Reforma Administrative Territoriale (Miratuar 2014)
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VD	Vend-depozitim
ZM	Zonë (Zona) e Mbrojtur

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Parathënie	1
2. Metodologjia “Për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime”	3
2.1. Përshkrimi i Metodologjisë	3
2.1.1. Evidentimi i vend depozitimeve	4
2.1.2. Pikëzimi i vend depozitimeve	6
2.1.3. Raporti i kategorizimit të vend depozitimeve në nivel qarku/bashkie	8
2.1.4. Vendim marrja për ndërhyrjet në vend depozitime	12
2.1.5. Raporti i rekomandimeve (Plani i masave dhe kostot e ndërhyrjeve)	14
2.2. Limitet (Kufizimet) e Metodologjisë.....	18
3. Organizimi i punës në nivel qendror dhe lokal	19
3.1. Ngritja e Grupit të Punës në nivel qendror	19
3.2. Ngritja e Grupeve të Punës në nivel lokal	20
3.3. Trajnimet.....	22
4. Vleftësimi i procesit (validimi).....	23
4.1. Përfshirja e ASIG	25
4.2. Përfshirja e AKPT	26
4.3. Përfshirja e kompanisë konsulente	29
4.3.1. Bashkërendimi me aktorët e tjerë	29
4.3.2. Harta e vend depozitimeve të ish MZHU	29
4.3.3. Vleftësimi i të dhënave	33
4.3.4. Llogaritja e volumeve të punimeve dhe transportit të mbetjeve	36
4.3.5. Platforma Web GIS	39
4.4. Prezantimi në Simpozium Shkencor Ndërkombëtar “Trajtimi i mbetjeve dhe sfidat drejt të ardhmes”	44
5. Mbështetja ligjore për Nismën “Zbutja e riskut në vend depozitime”	45
6. Rezultate dhe skenarë	47
6.1. Skenari bazë (rezultatet e Nismës)	47
6.2. Skenarë të ndryshëm	50
6.2.1. Skenar 1 – Largimi i mbetjeve me hekurudhë në ITM Elbasan	51

6.2.2.	Mbrojtja e lumenjve	53
6.2.3.	Skenar 2 - Ndërhyrja në lumenj	56
6.2.4.	Skenar 3 - Ndërhyrja në Zonat e Mbrojtura dhe Bregdetare	60
7.	Vend-depozitimet në nivel Qarku	63
7.1.	Hyrje	63
7.2.	Gjendja e vend-depozitimeve për secilin Qark	64
7.3.	Qarku Shkodër	67
7.4.	Qarku Kukës	73
7.5.	Qarku Lezhë	77
7.6.	Qarku Dibër	80
7.7.	Qarku Durrës	84
7.8.	Qarku Tiranë	88
7.9.	Qarku Elbasan	93
7.10.	Qarku Fier	98
7.11.	Qarku Berat	104
7.12.	Qarku Korçë	108
7.13.	Qarku Vlorë	114
7.14.	Qarku Gjirokastrë	121
Aneks 1	Formular pikëzimi i vend depozitimit	129
Aneks 2	Urdhër i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit	131
Aneks 3	Trajnimet e Grupeve të Punës në nivel lokal	133
Aneks 4	Vlerësimi i Komitetit Shkencor të Simpoziumit “Trajtimi i mbetjeve dhe sfidat drejt të ardhmes”	137
Aneks 5	Baza Ligjore për menaxhimin e mbetjeve	140

LISTA E FIGURAVE

Fig. 2.1 Fazat e vlerësimit të vend depozitimeve sipas Metodologjisë për zbutjen e riskut	3
Fig. 2.2 Pamje orientuese për pikat e grumbullimit që duhen konsideruar	5
Fig. 2.3 Material grafik sjellë nga Grupi i Punës për bashkinë Fushë Arrës.....	10
Fig. 2.4 Material grafik sjellë nga Grupet e Punës nga Malësi e Madhe dhe Durrës	11
Fig. 2.5 Rast hipotetik për ndërhyrjet në vend depozitime	12
Fig. 3.1 Pamje e hapësirës elektronike (Google Drive) për raportim	19
Fig. 3.2 Paraqitje skematike e organizimit të punës në nivel qendror dhe lokal.....	20
Fig. 4.1 Procesi i vleftësimit.....	23
Fig. 4.2 Pamje nga faja zyrtare Gjeoportali (ASIG).....	25
Fig. 4.3 Hartë treguese për PPV të miratuara dhe në proces hartimi.....	27
Fig. 4.4 Harta e AKPT për vend depozitimet.....	28
Fig. 4.5 Pamje nga faja zyrtare e hartës së vend depozitimeve të ish-MZHU.....	30
Fig. 4.6 Vend depozitime në bashkinë Selenicë	31
Fig. 4.7 Pamje e pozicionit të vend depozitimit të zhvendosur në Gramsh	32
Fig. 4.8 Përcaktimi i distancës nga zonat e banuara	34
Fig. 4.9 Përcaktimi i koeficienteve ks dhe kv	37
Fig. 4.10 Grafik i ndryshimit të kostos së transportit	38
Fig. 4.11 Pamje nga platforma dixhitale e MTM.....	39
Fig. 4.12 Aktivizimi i menuesë Shtresat	40
Fig. 4.13 Pamje e vend depozitimeve në bashkinë Mirditë, në platformën WebGIS	41
Fig. 4.14 Platforma tregon “Ndarja sipas Qarqeve”	42
Fig. 4.15 Platforma tregon “Ndarja sipas Baseneve”	42
Fig. 4.16 Platforma tregon vend depozitimet sipas kriterit të afërsisë me lumenjtë.....	43
Fig. 6.1 Harta e ndërhyrjeve për skenarin bazë	49
Fig. 6.2 Harta skematike për Skenarin 1.....	52
Fig. 6.3 Harta e baseneve ujëmbledhëse të lumenjve kryesor të Shqipërisë.....	53
Fig. 6.4 Harta e monitorimit të lumenjve, viti 2016 (burimi AKM).....	55
Fig. 6.5 Harta skematike për Skenarin 2.2.....	59
Fig. 6.6 Harta skematike për Skenarin 3.....	61
Fig. 7.1 Harta e qarqeve të Shqipërisë (sipas Ligjit Nr. 115/2014)	63
Fig. 7.2 Pamje e landfillit të Bushatit	67
Fig. 7.3 Vend-depozitimet e referuara nga Grupi i Punës për bashkinë Shkodër	69
Fig. 7.4 Vend-depozitimet në Qarkun Shkodër	72
Fig. 7.5 Pamje nga vend-depozitimi Bregu mbi Bozhë për mbetjet inerte në Kukës.....	74
Fig. 7.6 Vend-depozitimet në Qarkun Kukës	76
Fig. 7.7 Zonat e shërbimit në bashkinë Lezhë (sipas PMIM 2017-2021)	77
Fig. 7.8 Vend-depozitimet në Qarkun Lezhë.....	79
Fig. 7.9 Vendim i KRRTRSH Nr.1, datë 21.05.2001 për vend-depozitim të Peshkopisë.....	81
Fig. 7.10 Vend-depozitimet në Qarkun Dibrë.....	83
Fig. 7.11 Pamje nga rruga hyrëse dhe gjendja e vend-depozitimit në Porto Romano	84
Fig. 7.12 Vend-depozitimet në Qarkun Durrës	87
Fig. 7.13 Plani dhe organizimi i sheshit të ZTMT-së	88
Fig. 7.14 Vend-depozitimet në Qarkun Tiranë	92

Fig. 7 15 Plani i sheshit të ndërtimit të Impiantit të trajtimit të mbetjeve të Elbasanit	93
Fig. 7 16 Pamje e landfillit Elbasan, pjesë e impiantit të trajtimit të Mbetjeve të Ngurta	94
Fig. 7 17 Pamje e impiantit të prodhimit të energjisë Elbasan	94
Fig. 7 18 Vend-depozitimet në Qarkun Elbasan	97
Fig. 7.19 Vend-depozitimet në Qarkun Fier.....	103
Fig. 7.20 Vend-depozitimet në Qarkun Berat	107
Fig. 7 21 Pamje nga landfill i Maliqit	108
Fig. 7.22 Vend-depozitimet në Qarkun Korçë	113
Fig. 7 23 Pamje nga landfilli i Bajkaj	114
Fig. 7.24 Vend-depozitimet në Qarkun Vlorë.....	120
Fig. 7.25 Vend-depozitimet në Qarkun Gjirokastrë	125

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1Risqet kryesore që vlerësohen për çdo vend depozitim.....	6
Tabela 2-2 Informacion i përmbledhur për vend depozitimet ne nivel qarku/bashkie.....	8
Tabela 2-3 Informacion i detajuar për çdo vend depozitim.....	9
Tabela 2-4 Katalogu i masave ndërhyrëse	15
Tabela 2-5 Specifikimi i masave për secilën ndërhyrje	16
Tabela 6-1 Rezultatet e skenarit bazë	47
Tabela 6-2 Lista e lumenjve të Shqipërisë	54
Tabela 7-1 Popullsia sipas Qarqeve (burimi INSTAT 2018)	64
Tabela 7-2 Distanca nga landfill i Bushatit.....	68
Tabela 7-3 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Shkodër	71
Tabela 7-4 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Kukës.....	75
Tabela 7-5 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Lezhë	78
Tabela 7-6 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Dibër.....	82
Tabela 7-7 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Durrës.....	86
Tabela 7-8 Investimet e parashikuara në ZTMT	89
Tabela 7-9 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Tiranë	91
Tabela 7-10 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Elbasan	96
Tabela 7-11 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Fier.....	102
Tabela 7-12 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Berat	106
Tabela 7-13 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Korçë	112
Tabela 7-14 Mbetjet që gjenerohen nga bashkitë që depozitojnë në Landfill Bajkaj	115
Tabela 7-15 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Vlorë	119
Tabela 7-16 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Gjirokastrë.....	124

1. Parathënie

Raporti “Për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime” është produkti final i Nismës me të njëjtin emër që u iniciua nga MTM në fillim të muajit Shkurt 2018. Dokumenti paraqet një platformë informuese ku në formë të përmbledhur jepen aspekte teknike dhe organizative të një procesi të udhëhequr nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim të ngushtë me Prefekturat dhe Bashkitë.

Pavarësisht përfshirjes së shumë aktorëve në këtë Nismë, autorët e vërtetë të këtij Raporti janë mbi 250 ekspertë lokal (pranë bashkive dhe prefekturave), të cilët në një angazhimin disa mujor, bënë të mundur skanimin, vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për gjithë vend depozitimet në territorin e vendit.

Procesi përveçse një ushtrim teknik, në lidhje me vlerësimin e vend depozitimeve, u shoqërua me elementë të rëndësishëm organizativë dhe bashkëpunim të ngushtë mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, fakte këto që ndikuan pozitivisht në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura.

Me qëllim evidentimin e gjitha aspekteve që mbarti ky angazhim, struktura e Raportit ndjek, në vija të përgjithshme, ecurinë e procesit nga fillimi, me ngritjen e Grupeve të Punës, deri në fazën finale të tij. Në vijim jepet një përshkrim i kapitujve të Raportit.

Kapitulli 2 jep një përshkrim të Metodologjisë që udhëhoqi gjithë procesin. I hartuar nga ekspertët e CSD Engineers, me mbështetjen e dldp, ky dokument përveç eksperiencës ndërkombëtare merr në konsideratë kontekstin dhe veçoritë lokale të zhvillimit të këtyre infrastrukturave në vendin tonë. Përveç disa aspekteve teorike dhe praktike të Metodologjisë, në raport jepen dhe problematikat kryesore që kanë hasur grupet e punës në nivel lokal, në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të kërkuara.

Kapitulli 3 paraqet aspekte organizative të procesit. Aty trajtohen ngritja dhe organizimi i punës në nivel qendror dhe lokal. Struktura dhe ekspertiza e nevojshme që duhet të kishin grupet e punës dhe rolet që ato kanë patur në hierarkinë organizative të procesit.

Kapitulli 4 përshkruan procesin e vleftësimit të informacionit të grumbulluar nga grupet e punës në nivel lokal. Për një shfrytëzim sa më efektiv të kohës ky proces filloj paralelisht me grumbullimin e informacionit, në mënyrë që hap pas hapi, të dhënat e bashkive të korrigjoheshin dhe njëkohësisht t’u shpërndaheshin grupeve të tjera më me pak kapacitete.

Kapitulli 5, pavarësisht se mjaft i shkurtër, paraqet në formë të përmbledhur nismën ligjore të marrë nga MTM me mbështetjen e GIZ Albania, për të amenduar VKM Nr. 452, dt. 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”, që do bëjë të mundur zbatimin e ndërhyrjeve konkrete.

Kapitulli 6 përmbledh rezultatet përfundimtare të Nismës “Për zbutjen e riskut në vend depozitime” të cilat bazohen në gjithë të dhënat e grumbulluara nga grupet lokale dhe

procesin e vleftësimit nga gjithë aktorët e përfshirë. Në vazhdim, jepen dhe disa skenarë për ndërhyrje në vend depozitime, të bazuar në prioritetet e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit.

Në kapitullin 7, jepet një përshkrim i përgjithshëm i sistemit të menaxhimit të mbetjeve për secilin Qark. Informacioni i paraqitur është një sintezë e të dhënave të grumbulluara nga Grupet e Punës në nivel lokal të plotësuar këto edhe me komentet, korrigjimet dhe kostimin e masave për zbutjen e riskut mjedisor nga kompania konsulente e angazhuar për validimin e procesit.

Anekset në fund të Raportit japin informacion plotësues, kryesisht në lidhje me procesin e punës në terren, trajnimet dhe vleftësimin e të dhënave për vend depozitimet.

2. Metodologjia “Për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime”

Metodologjia “Për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime” ka si objektiv kryesor evidentimin e vend-depozitimeve në të gjithë territorin e vendit dhe bazuar në vlerësime ligjore dhe teknike të orientojë organet vendimmarrëse në nivel qendror dhe lokal në përzgjedhjen e atyre, që kanë një risk më të ulët për popullatën dhe mjedisin. Gjithashtu pjesë e kësaj metodologjie, është dhe një katalog masash konkrete që synojnë të përmirësojnë maksimalisht kushtet teknike të shfrytëzimit dhe operimit të vend depozitimeve.

Me qëllim uniformizimin e procesit të vlerësimit të grupeve punës në nivel lokal, u hartuan formularë/raporte standarde të cilat iu shpërndanë atyre për t’u plotësuar.

Metodologjia dhe e gjithë paketa e formularëve/raporteve standard u hartua nga kompania zvicerane CSD Engineers.

2.1. Përshkrimi i Metodologjisë

Në kuadër të kësaj Nisme, termi vend-depozitim nën-kupton ato legale dhe ilegale, të cilat për një periudhë të caktuar kohe kanë shërbyer si vend-hedhje e mbeturinave për një komunitet të caktuar (lagje periferike, fshat apo qytet).

Bazuar në Metodologjinë e propozuar, procesi ndahet në 5 komponentë kryesorë:

1. Evidentimi,
2. Vlerësimi (pikëzimi);
3. Kategorizimi i vend depozitimeve;
4. Vendimmarrje për tipin e ndërhyrjes (cilët vend-depozitime do rehabilitohen/ do mbyllen/ do zhvendosen);
5. Plani i masave për zbutjen e riskut dhe vlerësimi ekonomik i tyre për çdo vend depozitim




Fig. 2.1 Fazat e vlerësimit të vend depozitimeve sipas Metodologjisë për zbutjen e riskut

Gjithashtu, Metodologjia jep edhe disa masa për operimin dhe monitorimin e vend depozitimeve të cilat pas kryerjes së ndërhyrjes ndikojnë direkt në jetëgjatësinë e investimin dhe kontrollin e risqeve mjedisore.

Në vijim, për secilën nga fazat e mësipërme jepen koncepte teknike dhe përmbledhje të dhënash me qëllim sqarimin e aspekteve metodologjike të përdorura në proces.

Gjithashtu, për çdo fazë janë evidentuar edhe problematikat e hasura, të cilat në shumicën e rasteve janë zgjidhur në komunikim direkt me grupet e punës në nivel lokal ose me ndihmën e kompanisë konsulente (UTS-01) që ka asistuar Ministrinë në këtë proces.

2.1.1. Evidentimi i vend depozitimeve

Kjo përbën fazën parapërgatitore të punës, ku ekspertët në nivel vendor, evidentojnë çdo vend depozitim në territorin e bashkisë / qarkut përmes:

- Vizitave në terren
- Grumbullimin e dokumentacionit teknik apo ligjor që ka të bëjë me miratimin e infrastrukturave të grumbullimit të mbetjeve.

Problematika të hasura

a. Mungesa e dokumentacionit teknik

Shpesh herë konstatohet që miratimi i vend grumbullimeve nuk ka kaluar në asnjë proces vlerësimi teknik por thjesht administrativ. Bashkitë e gjendura para nevojave emergjente për menaxhimin/depozitim të mbetjeve kanë miratuar me vendime Këshilli Bashkiak, parcela kryesisht prona publike të cilat kanë shërbyer për vite me radhë si vend depozitime të mbetjeve bashkiake. Si rrjedhim, bashkitë nuk administrojnë asnjë dokumentacion teknik (studime gjeologjike, projekte teknike, leje ndërtimi apo mjedisore) në lidhje me vend depozitim që ndodhen në territorin e tyre. Mungesa e dokumentacionit teknik ndikoi drejt për drejt në punën e ekspertëve lokal të cilët nuk kishin asnjë bazë për vlerësimin e vend depozitimeve dhe gjithçka duhej të bazohej në vizitat në terren.

Vlen të theksohet që edhe në rastet kur vend depozitimet janë miratuar në komisione teknike në nivel vendor apo qendror (KRRT apo KRRTRSH / KKT), bashkitë nuk disponojnë vlerësime të mirëfillta teknike se si është përcaktuar një pozicion i caktuar për t'u shfrytëzuar si vend depozitim. Konstatohet që në përgjithësi ka patur disa kritere bazë që kanë orientuar vendimarrjen:

- i. Parcela duhet të jetë publike (për të shmangur kostot e shpronësimeve)
- ii. Zona duhet të jetë sa më afër qendrës urbane kryesore (për të shmangur kostot e transportit të mbetjeve)
- iii. Kritere gjeologjike, në lidhje me përshkueshmërinë e terrenit.

b. Kriteret e përfshirjes së vend depozitimeve

Kryesisht gjatë trajnimeve të grupeve lokale ka patur mjaft diskutime teknike mbi madhësinë e vend depozitimeve që duhen përfshirë në këtë platformë. Nga ekspertët e MTM dhe dldp është referuar që duheshin konsideruar vetëm ato vend depozitime që për një kohë të caktuar i kanë shërbyer një komuniteti (lagje periferike, fshati apo qyteti). Kjo me qëllim shmangien e atyre pika grumbullimi rastësore (fly tips) të krijuara rishtas nga kundërvajtës të ndryshëm.

Sqarojmë që në platformë janë përfshirë edhe vend depozitimet e abandonuara, që nuk përdoren më nga bashkitë për depozitim të mbetjeve dhe janë lënë pa asnjë ndërhyrje për mbyllje/kapsulim apo zhvendosje të mbetjeve.

Nga një vlerësim fillestar, në fazën e parë të grumbullimit të informacionit (në fund të muajit shkurt 2018) u konstatua që nga grupet e punës në nivel lokal, referoheshin rreth 60-70 pika grumbullimi që nuk duheshin konsideruar. Kjo vihej re kryesisht në ato raste kur në grupet e punës në nivel prefekturë, mungonin përfaqësuesit e bashkive që kishin një njohje më të mirë të shpërndarjes së pikave të grumbullimit të mbetjeve në territorin e tyre administrativ.



Fig. 2.2 Pamje orientuese për pikat e grumbullimit që duhen konsideruar

c. Nga grupet e punës në nivel lokal nuk është kërkuar informacion i detajuar për:

- lëndfillet sanitare të mbetjeve (ekzistuese: Bushat, Sharrë, Maliq dhe Bajkaj)
- impiantet e trajtimit të mbetjeve (ekzistuese: ITM Elbasan)
- vend depozitime të rehabilituara rishtas (ekzistues: Pukë dhe Peshkopi)
- apo projekte për infrastruktura të trajtimit mbetjeve (të planifikuara: ITM Fier, landfill Vlorë, etj.).

Konkludojmë që, pavarësisht nevojave për mirëmbajtje/ndërhyrje rehabilituese që mund të kenë këto infrastruktura legale të trajtimit të mbetjeve, ato nuk janë në fokus të Nismës për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime.

d. Kushtet atmosferike

Duke konsideruar që faza e parë e vizitave në terren u zhvillua gjatë muajit shkurt 2018, në disa raste, kryesisht në zonat malore, kushtet atmosferike ndikuan në afatet kohore të vlerësimit dhe në cilësinë teknike të informacionit që referonin. Reshjet e dëborës ulën ndjeshëm qëllimin e vizitave në terren pasi kjo bënte të pamundur vlerësimin, matjet dhe evidentimin e problematikave kryesore

Në disa raste bllokimet e rrugëve lokale bënë të pamundur aksesimin në vend depozitime. Gjithashtu emergjencat civile në lidhje me përmbytjet ndikuan në afatet e dorëzimit të raporteve teknike. Kjo bëri që në disa raste, grupi i ekspertëve të rikthehej në një moment të dytë për vlerësimet në terren.

2.1.2. Pikëzimi i vend depozitimeve

Pikëzimi i vend depozitimeve është bërë duke u bazuar në formularin uniform (shiko Aneks 1) të shpërndarë grupeve të punës për këtë qëllim. Pikëzimi bëhet duke u bazuar në 14 kriteret teknike dhe ligjore të cilat janë të grupuara në 4 grupe/risqe kryesore:

Tabela 2-1 Risqet kryesore që vlerësohen për çdo vend depozitim

Risku që lidhet me:	Nr. Kriteret	REZULTATI	
		Min.	Max.
Mbrojtja e ujit	6 kriteret	0	30
Mbrojtja e popullatës dhe shqetësimi	3 kriteret	0	15
Mbrojtja mjedisore dhe atraksion turistik	4 kriteret	0	8
Kriteri i operimit	1 kriter	0	5
Total		0	58

Sqarime në lidhje me plotësimin e formularit:

Numri maksimal dhe minimal i pikëve (58 pikë – 0 pikë) është i njëjtë për çdo vend depozitim që vlerësohet në gjithë territorin e vendit.

Në rastet kur vend depozitimi, për shkak të pozicionit gjeografik nuk shfaq një risk të caktuar, atëherë aty bëhet vlerësimi maksimal. P.sh. të gjithë vend depozitimet e qarkut Kukës janë vlerësuar me 5 pikë (pikët maksimale) për kriterin 2 – *distanca nga deti*.

Problematika të hasura

a. Vlerësimi gjeologjik i terrenit ku ndodhet vend depozitimi

Në disa raste, mungesa e dokumentacionit teknik për vend depozitimet dhe mungesa e ekspertëve gjeolog në përbërjen e grupeve të punës bëri që vlerësimi gjeologjik i terrenit (në lidhje me përshkueshmërinë dhe stabilitetin ndaj rrëshqitjeve) të ishte kryesisht i pabazuar dhe i përafërt teknikisht.

b. Afërsia e vend depozitimeve me zonat e banuara

Vlerësimi në lidhje me afërsinë e vend depozitimeve me zonat e banuara në disa raste ka qenë subjektiv. Konstatohet që në disa raste janë marrë për bazë ndërtesa të izoluara të cilat nuk mund të konsiderohet si përcaktuese për këtë kriter.

Nga trajnimet është sugjeruar që si bazë për vlerësimin e këtij kriteri të merren:

- vijat kufizuese të qendrave të banuara (vijat e gjelbra për bashkitë që kanë PPV të miratuar);
- vijat kufizuese të zonave të urbanizuara sipas vendimit të KKT Nr. 5 dt. 29.12.2014 "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban".

c. Degradimi i peizazhit

Vlerësimi i grupeve të punës në lidhje me ndikimin e vend depozitimeve në degradimin e peizazhit ngelet subjektiv. Fokusi i këtij kriteri ka qenë evidentimi i ndikimit negativ të vend depozitimeve në imazhin e zonave që mbartin vlera turistike. Për arsye të mungesës së ekspertizës së nevojshme, vetëm në disa raste (kur në grupet e punës janë përfshirë ekspert turizmi/gjeograf) rezulton që ky kriter është plotësuar korrektësisht për vend depozitimet që ndodhen pranë zonës bregdetare.

d. Zonat e mbrojtura me VKM

Një nga kriteret për vlerësim ishte dhe distanca e vend depozitimeve nga zonat e mbrojtura me VKM (apo zona me interes kombëtar). Shpesh herë kufijtë e këtyre zonave, që përcaktojnë dhe distancën që duhet respektuar, kërkojnë një ballafaqim të vlerësimeve në terren me materiale hartografike që shoqërojnë aktet ligjore sipas të cilave kanë marrë statusin e veçantë. Pavarësisht informacionit që përmban Gjeoportali (ASIG), në mjaft raste ky kriter ka rezultuar i plotësuar në formë subjektive.

Vetëm për zonat e mbrojtura mjedisore ekziston një hartë e publikuar në faqen zyrtare dhe ASIG.

Për monumentet e natyrës, trashëgiminë kulturore dhe zonat me vlera arkeologjike, informacioni në platforma digjitale është i pjesshëm dhe si i tillë i vështirë për t'u konsideruar saktësisht.

e. Kriteri i operimit

Kriteri i operimit ka patur si qëllim evidentimin e nivelit të shfrytëzimit të vend depozitimit, pasi mundësia për të vazhduar depozitimën e mbetjeve në 3-5 vitet e ardhshme përbën një kriter të rëndësishëm për Nismën në përgjithësi. Kuptohet që një vend depozitim që

shfrytëzohet përtej kapacitetit për të cilin është projektuar apo miratuar duhet detyrimisht t'i nënshtrohet mbylljes.

Shumica e vend depozitimeve janë thjesht parcela publike të vëna në dispozicion nga bashkia për grumbullim të mbetjeve, në të cilat mungojnë kushtet minimale të operimit, si rrethimi, ngjeshja e mbetjeve etj. Në kushte të tilla gjykimi për nivelin e shfrytëzimit apo jetë-gjatësia për të cilën mund të përdoret në të ardhmen vend depozitimi, ngelen subjektive.

2.1.3. Raporti i kategorizimit të vend depozitimeve në nivel qarku/bashkie¹

Kategorizimi i vend depozitimeve është bërë bazuar në formatin uniform të Raportit e Kategorizimit të shpërndarë gjithë grupeve të punës. Struktura e këtij raporti, plotësohet me informacionin e mbledhur në fazën e parë dhe ndahet në dy pjesë kryesore:

Pjesa 1. Vlerësim i përgjithshëm i vend depozitimeve në nivel qarku / bashkie

Në këtë pjesë të Raportit jepet priorizimi (renditja) i vend depozitimeve të mbetjeve në nivel qarku/bashkie. Përshkrimi i përgjithshëm që jepet në nivel qarku mbyllet me tabelën e mëposhtme ku jepet informacioni i përmbledhur për secilin vend depozitim.

Tabela 2-2 Informacion i përmbledhur për vend depozitimet në nivel qarku/bashkie

Renditja	Emri/Kodi i vend depozitimit	Rezultati Total	Distanca e transportit deri në vend-depozitimet e tjera të qarkut/bashkisë	Vend depozitimi gjendet në një pozicion të afërt me prioritet për zhvillimin e turizmit (apo të përcaktuar me VKM).	Rekomandime për vend depozitim
1					Rehabilitim / mbyllje / Zhvendosje e mbetjeve
2					
3					
...	...	...	...	...	...

Aty, fillimisht për secilin vend depozitim jepen pikët e grumbulluara (kolona e Rezultatit Total), pastaj vazhdohet me distancën e tyre nga njëri tjetri dhe kërkohet të sqarohet nëse ka ndonjë impakt direkt në lidhje me zonat me prioritet zhvillimin e turizmit (apo zona të tjera, me rëndësi kombëtare të përcaktuara me VKM).

Siç shihet, në kolonën e fundit përcaktohet edhe ndërhyrja që propozon grupi i punës për secilin vend depozitim. Pra këtu përcaktohet nëse:

- Vend depozitimi do rehabilitohet (me qëllim shfrytëzimin e tij për një periudhë afat mesme, 3-5 vjeçare)

¹ Duhet konsideruar fakti që Grupet e Punës të organizuara në nivel prefekturë kanë hartuar fillimisht Raporte në nivel Qarku. Në procesin e vleftësimit të të dhënave, Raportet u hartuan në nivel bashkie, me qëllim që ato të ishin pala konfirmuese finale në këtë proces.

- Vend depozitimi do mbyllet / kapsulohet (sipas masave të përcaktuara në Metodologjinë për Zbutjen e Riskut)
- Vend depozitimi largohet, mbetjet largohen në vend depozitimin më të afërt të rehabilituar apo në landfillin sanitar më afër.

Duke qenë se ky rekomandim ka të bëjë me vendim marrje jo vetëm teknike, të gjitha aspektet që lidhen me këtë proces jepen në paragrafin në vijim.

Pjesa 2 Vlerësim i përmbledhur për çdo vend depozitimi sipas formatit në vijim

Pjesa e dytë e Raportit të Kategorizimit jep informacion të përmbledhur për çdo vend depozitim. Ky informacion përmbledhet sipas strukturës së formularit të paraqitur në vijim dhe hartohet i veçantë për secilin vend depozitim.

Tabela 2-3 Informacion i detajuar për çdo vend depozitim

Rezultati final për Vend depozitimin i lokalizuar në koordinatat në Bashkinë Qarku	[Vendosni emrin/kodin e Vend depozitimit], [fusni koordinatat] [fusni emrin e bashkisë] [fusni emrin e qarkut]
--	---

Risku që lidhet me:	Rezultati
Mbrojtja e ujit	0 ÷ 30
Mbrojtja e popullatës dhe shqetësimi	0 ÷ 15
Mbrojtja mjedisore dhe atraksioni turistik	0 ÷ 8
Kriteret e operimit	0 ÷ 5
REZULTATI TOTAL	0 ÷ 58

Komente për rezultatin e vend-depozitimit të mbetjeve. (Gjendja e vend-depozitimit / Risqet kryesore mjedisore / Risqet kryesore lidhur me popullatën)

[Plotëso]

A ka ndonjë vend-hedhje mbeturinash afër? A ka ndonjë vend turistik të dukshëm nga vend-depozitimi? Ose ndonjë zone me rëndësi kombëtare të përcaktuar me VKM?

[Plotëso]

Harta / Fotografia / Skicat e vend-depozitimit të mbeturinave

[Plotëso]

Përveç pikëve që duhen plotësuar në përputhje me Formularin e Pikëzimit, respektiv për secilin vend depozitim, kërkohet që në rubrikat në vijim të plotësohen, me komente teknike, edhe veçori që lidhen me rekomandimin final që do jepet.

Siç konstatohet, formulari jep mundësi të sqarohet edhe vendim marrja për një vend depozitim (rehabilitim, mbyllje apo zhvendosje mbetjesh) pasi pavarësisht pikëve që ka marrë në lidhje me të tjerët, këtu evidentohen specifikat teknike dhe aspekte të përgjithshme

të menaxhimit të mbetjeve në një rajon apo bashki që kanë udhëhequr grupin e punës për Rekomandimin e dhënë.

Plotësimi me korrektësi i Raportit të Kategorizimit në mjaft raste ka qenë në varësi të ekspertizës së përfshirë në Grupet e Punës në nivel lokal dhe materialeve teknike që këto ekspertë kanë patur në dispozicion. Në vijim disa nga problematikat kryesore të evidentuara.

Problematika të hasura

a. Plotësimi i koordinatave gjeografike

Grupet e punës në disa raste referuan sisteme dhe projeksione të ndryshme gjeografike dhe gjeoreferencimi i vend depozitimeve pati fillimisht mjaft probleme. Gjithashtu, në disa raste grupet e punës referonin një pikë të vetme për vend depozitim, ndërsa të tjerë referonin pikat e skajeve të perimetrit.

b) plotësimi i skicave / plan vendosjeve të vend depozitimeve.

Në shumicën e rasteve në vend të skicave të përpunuara nga inxhinierët e grupeve të punës sollën skanime të certifikatave të pronësive, pamje nga ortofoto apo google map. Kjo bëri që shpesh herë këto të dhëna nuk kryenin funksionin për të cilin ishin kërkuar në lidhje me llogaritjen e sipërfaqeve apo volumeve të vend depozitimeve. Në vijim disa raste të materialeve grafike të sjella nga grupet lokale të punës.





Fig. 2.3 Material grafik sjellë nga Grupi i Punës për bashkinë Fushë Arrës.

Vend-depozitim nr.1
(Bader te Mehajve, Koplik)



Vend-depozitim Porto Romano
Durrës



Fig. 2.4 Material grafik sjellë nga Grupet e Punës nga Malësi e Madhe dhe Durrës

c) Mbartja e gabimeve apo parregullsive nga vlerësimi fillestar.

Mungesa e dokumentacionit dhe ekspertiza e pamjaftueshme teknike bënë që në disa raste të konstatohet Pikëzim i gabuar, si një përshkrim/vlerësim jo i saktë i gjendjes ekzistuese të vend depozitimeve, problematikë kjo që u mbart edhe në fazën e plotësimit të Raportit të Kategorizimit.

2.1.4. Vendim marrja për ndërhyrjet në vend depozitime

Sa i takon vendim marrjes për ndërhyrjen në vend depozitime, Metodologjia mbështetet kryesisht në vlerësimet teknike të bëra nga grupi i ekspertëve në nivel lokal duke u mbështetur në disa kriteret kryesore:

- Vend depozitimi që do rehabilitohet të mos bie ndesh kriterëve ligjore (kryesisht për zonat e mbrojtura me përparësi turizmin dhe rrjetin hidrologjik)
- Çdo bashki mund të rehabilitojë vetëm një vend depozitim, ndërsa të tjerët do mbyllen ose zhvendosen.
- Nuk lejohet rehabilitimi i vend depozitimeve që janë më afër se 40 km me infrastruktura sanitare të trajtimit të mbetjeve.
- Largimi i mbetjeve nuk këshillohet duke konsideruar problematikat e reja mjedisore që shfaqen nga ngacmimi i tyre dhe transporti. Sugjerohet që ato të depozitohen në landfillin më të afërt sanitar ose në raste kur nuk ka një të tillë afër të dërgohen në atë më të afërt që rehabilitohet.

Në vijim jepet një rast hipotetik, prezantuar tek Metodologjia, që tregon procesin e vendim-marrjes në lidhje me ndërhyrjen në vend depozitime.




Fig. 2.5 Rast hipotetik për ndërhyrjet në vend depozitime

Sipas këtij skenari rezulton:

1. Vend-depozitimi B (11 pikë), duhet mbyllur/larguar duke qenë se është më afër se 300m me bregun e detit, pa gjykuar fare se sa pikë ka grumbulluar nga formulari i Pikëzimit.
2. Vend depozitimi C (10 pikë), duhet mbyllur meqë është afër me vend-depozitimit A (18 pikë). Vend depozitimi C mbyllet, pavarësisht afërsisë me Qytetin 1 (me 10 000 banorë) në krahasim me A. Për këto distanca, dominon fakti që A ka më tepër pikë se C, d.m.th. A është më pak i rrezikshëm për popullatën dhe mjedisin.
3. Nga bashkia ngelet për të vendosur nëse do rehabilitohet vend depozitimi A(18 pikë) apo D (8 pikë) që është mjaft afër me qytetin me 100 000 banorë.
4. Duke marrë në konsideratë faktin që maksimalisht bashkia duhet të rehabilitojë vetëm një vend depozitim, Metodologjia propozon mbylljen e vend depozitimit D meqë ka më pak pikë (është më shumë i dëmshëm për mjedisin dhe popullatën).

Skenari hipotetik i marrë në konsideratë ka si qëllim të qartësojë prioritetet që duhet të ndikojnë vendim marrjen e bashkive. Në vijim paraqiten në formë të përmbledhur:

1. Pozicioni i vend depozitimit nuk duhet të thyejë kriteret ligjore. Në rastet kur ato nuk respektohen duhet mbyllur ose larguar, dhe si rrjedhim nuk mund të rehabilitohet;
2. Afërsia e dy apo më shumë vend depozitimeve dikton vendim marrjen duke rehabilituar atë që ka më shumë pikë (pra atë më pak të dëmshëm për popullsinë dhe mjedisin);
3. Çdo bashki mund të rehabilitojë maksimalisht një vend depozitim, atë që është vlerësuar me më shumë pikë ("më pak i dëmshëm")

Problematika të hasura

a. Rehabilitim i më shumë se një vend depozitimi për bashki

Grupet e punës në disa bashki kërkuar rehabilitim të më shumë se një vend depozitimi. Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër është një rast tipik që ia vlen të konsiderohet pasi ekspertiza e Grupit të Punës ka qenë mjaft e lartë dhe njëkohësisht me një bashkëpunim maksimal në proces. Nga bashkia, në këtë rast kërkohet rehabilitimi i 3 vend depozitimeve, kjo pasi ato trajtohen si një infrastrukturë e vetme për depozitimin e mbetjeve bashkiake. Duke konsideruar rrjetin rrugor ekzistues këto 3 vend depozitime janë miratuar me të njëjtin vendim të Këshillit Bashkiak.

b. Rehabilitim i vend depozitimeve në afërsi të lumenjve apo zonave me rëndësi kombëtare (VKM)

Evidentohen disa raste që bashkitë, në pamundësi tjetër, kërkojnë rehabilitim të vend depozitimeve pranë lumenjve, brenda zonave të mbrojtura mjedisore apo brenda zonës bregdetare me prioritet zhvillimin e turizmit. Të gjitha këto raste do jenë subjekt diskutimi teknik me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2.1.5. Raporti i rekomandimeve (Plani i masave dhe kostot e ndërhyrjeve)

Raporti i Rekomandimeve për Përmirësimin e vend depozitimeve, i hartuar në nivel qarku ose bashkie, është dokumenti përmbyllës i procesit të vlerësimit.

Rekomandimet teknike apo konkretisht masat që duhen ndërmarrë për vend depozitimet përmbledhen në formatin uniform të Raportit të Rekomandimeve të shpërndarë gjithë grupeve të punës në nivel lokal. Struktura e këtij raporti, plotësohet me informacionin e mbledhur në fazën e parë dhe konkluzionet e Raportit të Kategorizimit dhe ka këtë përmbajtje:

- Qëllimi dhe kufizimet e raportit
- Gjendja ekzistuese
- Risqet kryesore të identifikuara dhe statusi i vend depozitimit
- Masat e propozuara
 - Masat specifike
 - Masat e menaxhimit të ujit
 - Masat e stabilizimit dhe mbrojtjes
 - Masat për menaxhimin e bio-gazit
 - Masat për mbylljen
- Rekomandim për operimin e vend depozitimit
- Përmbledhje dhe konkluzione
- Planifikimi (Skica, preventiv)

Siç shihet në strukturën e raportit, përveç masave ndërhyrëse, duhet të parashikohen edhe disa rekomandime shtesë për operimin e mëtejshëm të vend depozitimit, duke plotësuar kushtet minimale të funksionimit të përshkruara në kapitullin përkatës të Metodologjisë. Këto kushte/standarde minimale operimi garantojnë qëndrueshmërinë e masave të ndërmarra (jetëgjatësinë e investimit) dhe ndikojnë në rritjen e sigurisë në këto vepra.

Bashkëlidhur Raportit të Rekomandimeve për Përmirësimin e vend depozitimeve duhet të vendoseshin edhe draft projektet (skicat) e hartuara për secilin vend depozitim dhe preventivat përkatës të hartuar bazuar në manualët e çmimeve të miratuara zyrtarisht. Gjithashtu është rekomandohet që për secilën masë të parashikuar të paraqiteshin dhe foto nga terreni, ku konkretisht tregohet risku prezent në vend depozitim.

Ndërhyrjet në vend depozitime (rehabilitim, mbyllje apo largim) janë masa konkrete ose kombinim i tyre nga katalogu i mëposhtëm. Në raportin e Metodologjisë, secila prej tyre ka “pasaportën” e vet ku sqarohen:

- Synimet – për të cilën përdoret masa konkrete;
- Risqet – që mënjanon/zbut masa konkrete;
- Përshkrimi – ku jepen sqarime teknike për zbatimin e masës ndërhyrëse;

- Skica/figura – që sqarojnë skematikisht/grafikisht tipin e masës apo konkretisht të zbatuar

Katalogu i masave ndërhyrëse që më sipër u dhanë të grupuara (shih struktura e Raportit) jepet më e detajuar në tabelën në vijuese.

Tabela 2-4 Katalogu i masave ndërhyrëse

1. MASAT SPECIFIKE
1.1 Largimi i mbetjeve
1.2 Sistemimi i mbetjeve
1.3 Ngritja e rrethimit
1.4 Prerje e pyjeve dhe shkurreve, si siguri kundrejt zjarreve
2. MASAT E MENAXHIMIT TË UJIT
2.1 Mbledhja e ujit të shiut me drenim periferik
2.2 Drenimi dhe grumbullimi i leksivateve
2.3 Menaxhimi i ujërave sipërfaqësor
2.4 Grumbullimi dhe ri qarkullimi i leksivateve
2.5 Filtrimi/përpunimi i leksivateve
3. MASAT E STABILIZIMIT DHE MBROJTJES
3.1 Ndërtimi i argjinaturave për stabilizimin e mbetjeve,
3.2 Ndërtimi i barrierave për mbrojtjen/stabilizimin e vend-depozitimit
4. MENAXHIMI I GAZIT
4.1 Zbatimi i sistemit për evakuimin e gazit
5. MASAT E MBYLLJES
5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbyllja e vend-depozitimit

Përkufizime:

- **Rehabilitim:** Ndërhyrje për të rritur kohën e përdorimit të vend-depozitimit duke siguruar njëkohësisht zbutjen e riskut mjedisor.
- **Mbyllje:** Mbulim i mbetjeve me 2 shtresa (zhavorr + argjilë) dhe vendosje e sistemit për çlirimin e gazit.
- **Largim:** Zhvendosje e mbetjeve në lëndfill sanitar apo në vend-depozitim më të afërt që do rehabilitohet.

Për të konkretizuar sa u tha më sipër, në vijim jepen masat për secilën ndërhyrje:

Tabela 2-5 Specifikimi i masave për secilën ndërhyrje

Rehabilitim	Mbyllje	Largim
1. MASAT SPECIFIKE	1. MASAT SPECIFIKE	1. MASAT SPECIFIKE
1.1 Largimi i mbetjeve	1.1 Largimi i mbetjeve	1.1 Largimi i mbetjeve
1.2 Sistemimi i mbetjeve	1.2 Sistemimi i mbetjeve	1.2 Sistemimi i mbetjeve
1.3 Ngritja e rrethimit	1.3 Ngritja e rrethimit	1.3 Ngritja e rrethimit
1.4 Prerje e pyjeve dhe shkurreve, si siguri kundrejt zjarreve	1.4 Prerje e pyjeve dhe shkurreve, si siguri kundrejt zjarreve	1.4 Prerje e pyjeve dhe shkurreve, si siguri kundrejt zjarreve
2. MASAT E MENAXHIMIT TË UJIT	2. MASAT E MENAXHIMIT TË UJIT	2. MASAT E MENAXHIMIT TË UJIT
2.1 Mbledhja e ujit të shiut me drenim periferik	2.1 Mbledhja e ujit të shiut me drenim periferik	2.1 Mbledhja e ujit të shiut me drenim periferik
2.2 Drenimi dhe grumbullimi i	2.2 Drenimi dhe grumbullimi i	2.2 Drenimi dhe grumbullimi i
2.3 Menaxhimi i ujërave	2.3 Menaxhimi i ujërave	2.3 Menaxhimi i ujërave
2.4 Grumbullimi dhe ri qarkullimi i leksivateve	2.4 Grumbullimi dhe ri qarkullimi i leksivateve	2.4 Grumbullimi dhe ri qarkullimi i leksivateve
2.5 Filtrimi/përpunimi i leksivateve	2.5 Filtrimi/përpunimi i leksivateve	2.5 Filtrimi/përpunimi i leksivateve
3. MASAT E STABILIZIMIT DHE MBROJTJE	3. MASAT E STABILIZIMIT DHE MBROJTJE	3. MASAT E STABILIZIMIT DHE MBROJTJE
3.1 Ndërtimi i argjinaturave për stabilizimin e mbetjeve	3.1 Ndërtimi i argjinaturave për stabilizimin e mbetjeve	3.1 Ndërtimi i argjinaturave për stabilizimin e mbetjeve
3.2 Ndërtimi i barrierave për mbrojtjen/stabilizimin e vend depozitimit	3.2 Ndërtimi i barrierave për mbrojtjen/stabilizimin e vend depozitimit	3.2 Ndërtimi i barrierave për mbrojtjen/stabilizimin e vend depozitimit
4. MENAXHIMI I GAZIT	4. MENAXHIMI I GAZIT	4. MENAXHIMI I GAZIT
4.1 Sistemit për evakuimin e gazit	4.1 Sistemit për evakuimin e gazit	4.1 Sistemit për evakuimin e gazit
5. MASAT E MBYLLJES	5. MASAT E MBYLLJES	5. MASAT E MBYLLJES
5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbyllja e vend-depozitimit	5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbyllja e vend-depozitimit	5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbyllja e vend-depozitimit

Për përcaktimin e vlerës së ndërhyrjeve u rekomanduan Manualët e çmimeve dhe analizat teknike, miratuar me: VKM Nr. 629, dt. 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Për thjeshtësi, manualët e çmimeve dhe një preventiv i gatshëm² u shpërndanë gjithë grupeve të punës në format elektronik. Gjithashtu gjatë trajnimeve të ekspertëve lokal, si shembull konkret ndërhyrje, u referua projekti teknik i Rehabilitimit të Vend depozitimit Pukë mbështetur së fundmi nga dldp. Masat e parashikuara në këtë projekt trajtonin thuajse të gjitha ato të parashikuara në katalogun e masave të përcaktuara në Metodologji.

² Preventiv i gatshëm është ai i hartuar për rehabilitim të vend depozitimit të Pukës

a. Mos kuptim i Metodologjisë

Në disa raste ekspertët lokal kanë parashikuar një masë të vetme ndërhyrëse, duke mënjeluar të tjerat. P.sh. ka patur disa Raporte Rekomandimesh për vend depozitime që rehabilitoheshin ose mbylleshin ku parashikohet vetëm masa: 1.3 Rrethim i mbetjeve, duke shmangur apo nën vlerësuar gjithë masat e tjera po aq të rëndësishme për t'u ndërmarrë.

Në disa raste është ngatërruar terminologjia, kryesisht për ndërhyrjet *Rehabilitim* dhe *Mbyllje* të vend depozitimeve. Më konkretisht, disa ekspert lokal kanë referuar Mbylljen dhe sistemimin e zonës/terrenit pas mbylljes (me mbjellje pemësh apo gjelbërim) si Rehabilitim të vend depozitimit, duke prodhuar kështu keqkuptime në grupet e punës në nivel qendror që grumbullonin gjithë informacionin në nivel kombëtar.

b. Largimi i mbetjeve

Në rastet kur është parashikuar Largimi i Mbetjeve, nuk është parashikuar qartë destinacioni ku do dërgohen. Në shumicën e rasteve nënkuptohet që mbetjet dërgohen në vend depozitimin më të afërt të rehabilituar. Dërgimi i mbetjeve në landfillet sanitare apo Impiante Trajtimi Mbetjesh (rasti Elbasan) është parashikuar vetëm nga ato bashki që ndodhen pranë këtyre infrastruktura. Sqarojmë që, edhe në këto raste, në kostimin e ndërhyrjes nuk është parashikuar kosto për depozitim (gate fee).

c) Projektet e gatshme

Bashkitë kryesore të vendit, në disa raste kanë projekte të gatshme të hartuara kryesisht për mbylljen e vend depozitimeve ekzistuese. Këto projekte të hartuara nga ekspertiza të huaja ose vendase të specializuara parashikojnë mbylljen sipas standardeve maksimale duke studiuar në detaj problematikën dhe si rrjedhim duke parashikuar mënjanimin e gjithë risqeve. Kuptohet që këto projekte janë të shoqëruara me preventivat përkatës ku vlera e tyre është shumëfishi i vlerës që rezulton nga ndërhyrjet që parashikohen bazuar në Metodologjinë për Zbutjen e Riskut në vend depozitime. Si rrjedhim, Grupet e Punës lokale, në këto raste kanë insistuar në konsiderimin e projekteve tashmë të hartuara dhe jo sipas Metodologjisë.

d) Parashikimi i masave dhe preventivimi (kostimi)

Përgatitja e Raportit të Rekomandimeve për Përmirësimin e vend depozitimeve, duke qenë dhe faza më teknike e gjithë procesit, reflektoj problematikën më të mëdha. Vlen të theksohet që GP lokale janë përballur me vështirësi reale në këtë proces. Realisht ushtrimi për llogaritjen e koston, edhe përafërsisht, është mjaft sfidues duke konsideruar afatet e ngushta kohore të cilat nuk kanë mjaftuar për të bërë matjet e nevojshme, të paktën në nivelin e një projekt-ideje. P.sh. madhësia/gjatësia e sistemit të trajtimit të ujërave me parametra dhe të dhëna të ndryshme që nuk janë vlerësuar më nivelin e duhur. Në aspektin inxhinierik është

e qartë që madhësia e ndërhyrjes (volumet respektive) kanë një ndikim direkt kostimin e saj.

Disa grupe pune, në mungesë të ekspertizës së nevojshme, nuk morën përsipër plotësimin e këtij Raporti me masat e nevojshme dhe hartimin e preventivave. Në këto kushte, raportet së bashku me preventivat u hartuan nga ekspertiza e angazhuar nga dldp (kompania konsulente) për këtë qëllim.

2.2. Limitet (Kufizimet) e Metodologjisë

Duke i nisur nga mënyra e grumbullimit të informacionit Metodologjia për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime përveç aspekteve teknike parashtron në mënyrë indirekte dhe disa kërkesa të karakterit organizativ, ndër të cilat më kryesoret janë:

- Informacioni duhet të grumbullohet, përpunohet dhe vleftësohet sipas një shkalle hierarkike duke filluar nga niveli lokal dhe duke përfunduar në nivel qendror;
- Grupi i punës pranë Prefekturës, duke qenë i lidhur direkt me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit do jetë si aktor ndërmjetës në proces, me rol kryesisht koordinator;
- Në të gjitha rastet, Grupi i Punës pranë prefekturës duhet të ketë përfaqësues të bashkive për informacion në territorin që ato mbulojnë administrativisht;
- Bashkëpunimi ndër-institucional duhet të jetë maksimal gjatë angazhimit

Në përmbledhje, duke konsideruar kushtet reale të punës në terren dhe faktor të tjerë teknik dhe organizativ në lidhje me:

1. Nivelin e ekspertizës së përfshirë (GP lokal);
2. Informacionin e mbledhur për çdo vend depozitim;
3. Limitet kohore të vënë në dispozicion për gjithë procesin

Dalim në përfundimin që produkti final i kësaj Nisme:

- Vlerëson dhe parashikon vetëm masa emergjente për zbutjen e risqeve kryesore të evidentuara, pa hyrë analiza të thelluara teknike;
- Për zgjidhjen e menaxhimit të integruar të mbetjeve, plani i ndërhyrjeve në bashki/rajon nuk parashikon hapjen e vend depozitimeve të reja;
- Planet e Rekomandimeve nuk janë grup projektsh teknike për mbyllje apo rehabilitim vend depozitimesh;
- Hartimi i Projekteve të zbatimit ka nevojë për angazhim teknik shtesë.
- MTM duhet të konsiderojë faktin që, vlera financiare e llogaritur me mangësitë e mësipërme, ka një marzh gabimi;

3. Organizimi i punës në nivel qendror dhe lokal

3.1. Ngritja e Grupit të Punës në nivel qendror

Grupi i Punës në nivel qendror u ngrit bazuar në Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr. 35, dt. 02 Shkurt 2018 “Për ngritjen e Grupit të Punës për verifikimin e vend-depozitimeve ekzistuese dhe përcaktimin e kushteve për përmirësim/rehabilitim të tyre” (Shiko Aneks 2).

Fillimisht ekspertët e MTM u njohën me Metodologjinë për Zbutjen e Riskut në Vend-depozitime dhe gjithë formatet e gatshme që do shpërndareshin, në bazë të të cilave do raportonin Grupet e Punës në nivel lokal. Në një bashkëpunim të ngushtë me Prefektët u hartua Programi i Punës për organizimin e trajnimeve të ekspertëve lokal në lidhje me aspektet teknike që do ndiqeshin gjatë procesit. Trajnimet u organizuan në dy faza të veçanta, fillimisht duke trajtuar ekspertizën e nevojshme që duhej të përfshihej në Grupet e Punës në nivel lokal e disa nga elementët bazë të Metodologjisë dhe pastaj sqarimin e aspekteve të mirëfillta teknike-inxhinierike në lidhje me Masat e Propozuara për përmirësimin e vend-depozitimeve dhe kostimin e tyre³.

Për lehtësi komunikimi dhe përditësimi të të dhënave që vinin nga ekspertët lokal, koordinatorët e MTM ngritën një hapësirë elektronike (në google drive⁴) të strukturuar në bazë të raporteve dhe informacioneve që duheshin përgatitur. Ky instrument ndihmoi shumë procesin pasi të gjithë kontrollonin në kohë reale proceset e punës, cilësinë e plotësimit të raporteve etj. Në të njëjtën kohë, duke promovuar “shembujt e mirë” ekspertët lokal ndihmuan reciprokisht njëri-tjetrin për aspekte teknike të ndryshme.




Fig. 3.1 Pamje e hapësirës elektronike (Google Drive) për raportim

³ Për informacion më të detajuar në lidhje me trajnimet e organizuar shiko Aneks 3 të këtij Raporti

⁴ Link: https://drive.google.com/drive/folders/1bKp_KVW2S4UjM0l1an26yHkrdcFa8RU-?usp=sharing

3.2. Ngritja e Grupeve të Punës në nivel lokal

Bazuar në komunikimin zyrtar të MTM me 12 Prefektët, u ngritën Grupet Punës në secilën prefekturë. Duke konsideruar Metodologjinë e punës që do ndiqej, dldp hartoj disa kërkesa minimale për përbërjen e grupeve dhe ekspertizën e nevojshme që duhet të kishin. Këto terma reference për Grupet e Punës në nivel lokal ishin objekt i trajnimit të parë të bërë nga MTM dhe ekspertët e dldp, në secilën Prefekturë. Në këto trajnime fillimisht u prezantua Metodologjia dhe pastaj u trajtuan kapacitet reale në funksion të kërkesave që kishte ky proces.




Fig. 3.2 Paraqitje skematike e organizimit të punës në nivel qendror dhe lokal

Kërkesat kryesore për përbërjen dhe ekspertizën e grupeve lokale ishin:

1. Ekspertët e grupit të punës në nivel prefekturë të ishin:

- **Inxhinier mjedisor / Gjeograf:** Roli i inxhinierit mjedisor / gjeografit është që të sjellë një vizion të përgjithshëm të kufizimeve mjedisore në vlerësim. Ai/ajo do të vlerësojë strukturën e përgjithshme dhe kontekstin e vend-depozitimit nga një këndvështrim mjedisor, duke identifikuar burimet kryesore të riskut potencial
- **Hidro-gjeolog / Gjeolog:** Roli i gjeologut / hidro-gjeologut është të sjellë ekspertizën e vet në vlerësimin e kushteve gjeologjike, qëndrueshmërinë e terrenit dhe ndikimin vend depozitimeve në ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor. Ai/ajo do të vlerësojë

strukturën e përgjithshme dhe kontekstin e vend-depozitimit nga këndvështrimi gjeologjik dhe hidrogeologjik duke identifikuar burimet kryesore të riskut potencial

- **Topograf:** Roli i topografit është të sjellë ekspertizën e vet për sa i përket kufizimeve që lidhen me terrenin, aksesin dhe me strukturën e vend-depozitimit në gjendjen aktuale; Të vlerësojë përmasat dhe volumin e vend-depozitimit dhe gjithashtu të vlerësojë volumin e mbetjeve të depozituara aktualisht; Të vlerësojë gjendjen ekzistuese, duke përfshirë distancën nga zonat e banuara. Të marrë informacion në lidhje me pronësinë e vend-depozitimit (mundësisht dhe të pronave kufizuese me vend-depozitimin).
- **Inxhinier ndërtimi:** Roli i inxhinierit ndërtimit është të sjellë ekspertizën e vet për sa i përket kufizimeve që lidhen me funksionimin e vend-depozitimit të mbetjeve. Të vlerësojë strukturën e përgjithshme, praninë e infrastrukturave inxhinierike të cilat mund të ndikojnë në përdorimin e vend-depozitimit dhe të japi mendime në lidhje me mundshmërinë e zbatimit të masave teknike me qëllim përmirësimin e kushteve të vend-depozitimit. Pas përcaktimit të masave ndërhyrëse, në bashkëpunim me gjithë ekspertët e grupit të punës, inxhinieri ka detyrë të hartojë preventivin e ndërhyrjeve bazuar në standardet shqiptare.

2. Çdo grup pune duhet të kishte në përbërjen e vet të paktën një ekspert të sektorit të menaxhimit të mbetjeve nga bashkitë që ishin pjesë e prefekturës. Duke qenë një nga funksionet e bashkive⁵ është mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane dhe duke konsideruar njohjen e territorit administrativ që stafet teknike të bashkive kanë, prezenca e ekspertit të bashkive në Grupet e Punës u kërkua në formë detyruese.

3. Bashkitë mund të formonin vetë grupet e punës me përbërjen e mësipërme, por gjithsesi koordinimi me MTM duhet të ishte përmes grupit të punës/ekspertit të caktuar nga Prefekti.

Nga mungesa e ekspertizës të nevojshme, në strukturat e Prefekturave, në shumicën e rasteve, ishin grupet e punës të ngritura pranë bashkive ato që bënë vlerësimin e vend depozitimeve dhe roli i Prefekturave rezultoi më shumë koordinues mes bashkive dhe MTM. Gjithashtu ato, duke grumbulluar informacionin që vinte nga secila bashki hartuan dhe Raportin e Kategorizimit dhe atë të Rekomandimeve e Masave Ndërhyrëse në nivel Qarku.

Nisma “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”, nisur në fillim të muajit Shkurt dhe i përmbyllur në një afat 3 mujor, përfshiu punën në terren dhe zyrë të mbi 250 ekspertëve vendorë, të cilët në mënyrë të vazhdueshme pasuruan platformën e të dhënave me gjithë të dhënat teknike të nevojshme. Vlen të theksohet që, vlera e shtuar e këtij procesi ishte bashkërendimi i ngushtë i punës së strukturave të qeverisjes qendrore dhe atyre vendore.

⁵ Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

3.3. Trajnimet

Me qëllim njohjen e Metodologjisë dhe hapave që do ndiqeshin për vlerësimin e vend depozitimeve, MTM me mbështetjen e dldp zhvilluan një fazë përgatitore trajnimesh me gjithë grupet e punës në nivel lokal. Këto trajnime u zhvilluan në secilin rajon, ku të ftuar ishin jo vetëm ekspertët kyç të Prefekturave dhe Bashkive, por edhe ata që do ndihmonin procesin.

Këto trajnime u organizuan 2 faza kryesore:

Faza e parë: Trajnimi i parë konsistoi në sqarimin e hapave që do ndiqeshin për vlerësimin e vend depozitimeve dhe kërkesat minimale në lidhje me ekspertizën e nevojshme që duhej të kishin Grupet e Punës në nivel lokal.

Për këtë fazë, u bënë trajnimet në nivel rajonal, të cilat zgjatën thuajse 1 javë. Në vijim jepen detaje të takimeve në Prefektura në ndryshme:

- 01 Shkurt 2018 Prefektura Durrës
- 02 Shkurt 2018 Prefektura Berat, Fier dhe Gjirokastrë
- 03 Shkurt 2018 Prefektura Vlorë
- 05 Shkurt 2018 Prefektura Tiranë
- 06 Shkurt 2018 Prefektura Elbasan, Korçë, Dibër dhe Kukës
- 07 Shkurt 2018 Prefektura Lezhë dhe Shkodër

Vetëm pas përfundimit të këtyre trajnimeve u bë e mundur fillimi i punës për evidentimin, pikëzimin dhe kategorizimin e vend depozitimeve në nivel Qarku (Prefekturë) bazuar në Metodologjinë dhe formularët e gatshëm të vënë në dispozicion për këtë qëllim.

Faza e dytë: Fokusi i trajnimeve në fazën e dytë, ishin inxhinierët mjedisorë, të ndërtimit dhe topografët të cilët konkretisht do hartonin:

- Planin e masave për përmirësimin e kushteve / zbutjen e riskut në vend depozitime;
- llogaritjen e volumeve të punimeve, dhe;
- hartimin e preventivave bazuar në standardet kombëtare.

Për këtë qëllim u organizuan trajnimet në nivel rajonal, si më poshtë:

- 14 Shkurt 2018 Prefekturat Vlorë, Berat, Fier dhe Gjirokastrë (trajnimi u bë në ambientet e Prefekturës Vlorë)
- 15 Shkurt 2018 Prefekturat Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Korçë (trajnimi u bë në ambientet e Prefekturës Tiranë)
- 19 Shkurt 2018 Prefekturat Shkodër, Lezhë, Dibër dhe Kukës (në ambientet e Bibliotekës së qytetit Lezhë)

Në Aneks 3, pjesë e këtij Raporti, referohen momente gjatë trajnimeve të të dyja fazave.

4. Vleftësimi i procesit (validimi)

Duke u konsideruar afatet e ngushta kohore me të cilën u organizua kjo Nismë në nivel kombëtar dhe problematikat e hasura gjatë procesit (të sqaruara në kapituj para-ardhës), ishte e domosdoshme që rezultatet finale të kalonin një proces vleftësimi (validimi) teknik. Për këtë qëllim MTM përmes një bashkëpunimi ndër institucional kërkoi angazhimin e disa Agjencive Shtetërore ku ndër më kryesoret përmendim:

- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Hapësinor (ASIG⁶)
- Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM⁷)
- Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT⁸).

Nga ana tjetër, programi dldp që dha mbështetje gjatë gjithë këtij procesi angazhoi një kompani konsulente (UTS-01.sh.p.k.⁹) që do merrej konkretisht me plotësimin e gjithë problematikave të hasura nga Grupet e Punës në nivel lokal. Kjo kompani konsulente në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë të dldp, u kthye në qendrën fokale të koordinimit të të gjithë procesit të vleftësimit duke reflektuar dhe sugjerimet që vinin nga institucionet qendrore.




Fig. 4.1 Procesi i vleftësimit

⁶ <https://geoportal.asig.gov.al/>

⁷ www.akzm.gov.al/

⁸ <http://planifikimi.gov.al/>

⁹ <http://uts-01.com>

Pas korrigjimeve të bëra, raportet u përgatiten edhe njëherë në nivel bashkie dhe u shpërndanë përmes Prefektëve për miratim final nga Kryetarët e Bashkive. I gjithë ky proces paraqitet skematikisht në figurën më sipër.

Procesi i vleftësimit të informacionit dhe ndarja e konkluzioneve të kësaj Nisme përfshiu dhe disa aktor të tjerë institucional dhe akademik që i dhanë një kontribut mjaft të vlerë këtij procesi. Ndër takimet (workshop) më të rëndësishme mund të përmendim ato me:

- Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës
- Zyrën Rajonale Eptisa, Tiranë
- GIZ Albania
- Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit, Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit (UPT)
- Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Vleftësimi i të dhënave të grumbulluara dhe analizave teknike, me aktorët kryesorë të angazhuar aktualisht në sektorin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, rrit ndjeshëm qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura dhe siguron një platformë të sigurtë për kalimin në fazën e zbatimit të nismës “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”.

Në paragrafët në vijim jepet një përshkrim i angazhimit për secilin nga aktorët e mësipërm duke treguar në formë të përmbledhur kontributin e tyre në Nismën për Zbutjen e Riskut në vend depozitime.

4.1. Përfshirja e ASIG

Ekspertët e ASIG ishin të parët që u ftuan në vleftësimin e të dhënave të ardhura nga grupet e punës në nivel lokal. Pjesë e informacionit që do referohej për çdo vend depozitim është dhe pozicioni gjeografik i tyre¹⁰ dhe duke u bazuar mbi këtë të dhënë, në vijim, do hartohej dhe platforma webgis për këtë qëllim.

Në raportet që vinin nga grupet e punës u konstatua që koordinatat gjeografike referoheshin në formate dhe projeksione të ndryshme dhe pozicionimi gjeografik i tyre në mjaft raste rezultonte i pa saktë. Kjo vinte nga eksperiencia të ndryshme që topografët e përdornin në lidhje me formatin dhe projeksionin gjeografik. Në vijim disa nga formatet e koordinatave që u sollën nga grupet e punës për vend depozitime brenda të njëjtit qark:

- Vend depozitimi xxxx: 34T 0409837, UTM 4509331
- Vend depozitimi yyyy: E 400243, N4514256
- Vend depozitimi zzzz: X: 394813 Y: 4492893

Sa më sipër, përfshirja e ekspertizës së ASIG ishte me qëllim unifikimin e formatit dhe projeksionit që do përdorej për referencat gjeografike të vend depozitimeve. Në bashkëpunim me ekspertët e MTM dhe dldp, gjithë grupeve të punës iu shpërnda një material informativ dhe sqarues, ku tregohej se si duhej duheshin paraqitur koordinatat gjeografike duke u bazuar në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare 2010¹¹

Në vijim jepet një material grafik, pjesë e materialit informativ, ku qartësisht tregohej se si duhej përdorur marrja e koordinatave gjeografike nga faja zyrtare e ASIG.



Fig. 4.2 Pamje nga faja zyrtare Gjeoportali (ASIG)

¹⁰ Në Raportin e Kategorizimit, për çdo vend depozitim duhet të përcaktohen koordinatat gjeografike

¹¹ Miratuar me VKM Nr. 669, dt. 7.8.2013, "Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH-2010), si metadatë"

4.2. Përfshirja e AKPT

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) është autoritet me përgjegjësi planifikimi, në varësi të ministrisë përgjegjëse që mbulon çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në këtë kuadër, AKPT harton plane në nivel kombëtar, dhe njëkohësisht bashkërendon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit, si atë horizontal (mes institucioneve të pushtetit qendror), ashtu edhe atë vertikal (mes institucioneve vendore e qendrore).

Përveç tjerash, AKPT që në vitin 2014, pas miratimit të Reformës Administrative Territoriale dhe ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”¹², ka udhëhequr dhe koordinuar teknikisht procesin e hartimit të PPV në mbarë vendin.

Bazuar në referencat e kuadrit ligjor për planifikimin e territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor është dokumenti që përcakton kuadrin referues të detyrueshëm për mbrojtjen dhe përdorimin e territorit administrativ të njësisë së qeverisjes vendore (bashkisë).


Duke qenë se i gjithë informacioni i territorial që përmbajnë PPV është i gjeo-referencuar (në sistemin GIS) dhe aktualisht 44 bashki kanë miratuar Planet e Përgjithshme Vendore, MTM iu drejtua AKPT për të bërë një vleftësim të të dhënave që vinin nga grupet e punës në nivel lokal. Si bazë verifikuese do përdorej informacioni që përmbanin PPV, për këto infrastruktura.

Nga të dhënat zyrtare rezulton që 44 bashkitë me PPV të miratuar janë ato me përqendrimin më të madh të urbanizimit dhe përbëjnë mbi 70% të sipërfaqes së territorit të vendit. Sa më sipër, kjo bazë të dhënash u gjykua e mjaftueshme për një verifikim të pozicionimit gjeografik të vend depozitimeve në shkallë kombëtare. Në Fig. 4.3, në vijim, është paraqitur harta e Shqipërisë ku tregohen bashkitë që kanë PPV të miratuar.

Duhet të kemi parasysh që AKPT merr të mirëqenë informacionin nga terreni, që stafet teknike të bashkive dhe kompanitë konsulentë përfshijnë në raportet e PPV. Përsa i përket vend depozitimeve ekzistuese si bazë vleftësimi u përdor informacioni në kapitujt që trajtojnë problematikën mjedisore në raportin e Analizës së Thelluar Territoriale të çdo PPV-je duke përfshirë dhe të dhënat e hartës së ish-MZHU-së.

Nga verifikimi i bërë (shiko Fig. 4.4) rezultoi që shumica e vend depozitimeve të ardhura nga grupet e punës përputhej me ato që referoheshin në PPV. Në disa raste mos përputhesh, lehtësisht konstatohej që bëhej fjalë për të njëjtët vend depozitime por referencat gjeografike (të përdorura nga burime të ndryshme) shkaktonin shmangie të vogla në pozicionimin e tyre. Në këtë hartë janë përfshirë edhe landfillet e planifikuara për të cilat platforma e MTM nuk kishte informacion.

¹² Ligj Nr. 115/2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive Të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” janë miratuar në të njëjtën datë, me 31 Korrik 2014




Harta e unifikuar e vend-depozitimeve



AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT



1:500,000



BURIMI I TE DHENAVE

Harta është një ekstrakt i gjenëruar nga AKPT, që përmban informacione mbi venddepozitimet ekzistuese nga burimet e MTM dhe MZHU, plotësuar me informacione mbi gjendjen ekzistuese dhe gjendjen e propozuar të venddepozitimeve, landfili-eva dhe incineratorëve nga planet e përgjithshme vendore të 44 bashkive.

LEGJENDA

Gjendja Ekzistuese

- Vend-Depozitimet e MTM-se(Grupet Lokale)
- Vend-Depozitimet e MZHU-se
- Bashki_Pa_PPV
- databasa_akpt.sde.Ndarja_Re_Administrative
- Venddep_ekz_PPV

Gjendja e Propozuar

- ▲ PPV_Pike_Transferimi_prop
- PPV_Landfill_prop
- PPV_Incinerator_prop
- PPV_venddep_prop
- Bashki_Pa_PPV
- databasa_akpt.sde.Ndarja_Re_Administrative

Fig. 4.4 Harta e AKPT për vend depozitimet

4.3. Përfshirja e kompanisë konsulente

Kompania konsulente UTS-01 u përfshi në proces, përmes programit dldp, për disa objektiva kryesore :

1. Të siguronte mbështetje teknike në procesin e bashkërendimit të punës me aktorët e tjerë të përfshirë në Nismën “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”;
2. Të siguronte mbështetjen e nevojshme teknike për vleftësimin e të dhënave të grumbulluara;
3. Të rakordonte rezultatet teknike të ekspertizave të GIZ Albania dhe Eptisa për bashkitë që ato mbulojnë me asistencë, si dhe përfshirjen e tyre në platformën e të dhënave dhe rekomandimeve të Nismës “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”;
4. Të ngrinte një platformë Web GIS me gjithë informacionin e grumbulluar;
5. Të hartonte Raportin e rezultateve të nismës në nivel kombëtar

Në vijim, për secilin nga objektivat, jepet një përshkrim i shkurtër i angazhimit dhe kontributit konkret të kompanisë.

4.3.1. Bashkërendimi me aktorët e tjerë

Kompania konsulentë , në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e dldp, dha një kontribut me vlerë në bashkërendimin e punës me gjithë aktorët e përfshirë në proces. Kjo mbështetje konsistoi kryesisht në:

- Njohjen me dokumentet strategjike kombëtare, në proces hartimi, dhe përdorimin e koncepteve të propozuara nga këto instrumente me qëllim harmonizimin e rezultateve me qasjet strategjike. P.sh. Hartim i analizave dhe rezultate bazuar në hartën e re të Zonave të Mbetjeve që këto dokumente referojnë;
- Hartimin e raporteve paraprake dhe prezantimeve me tematika të ndryshme që ishin në fokus të takimeve me institucione publike, ente private apo grupe ekspertësh;
- Përfshirjen dhe reflektimin e komenteve të tyre në lidhje me vleftësimin e të dhënave e mbledhura nga grupet lokale

4.3.2. Harta e vend depozitimeve të ish MZHU

Harta dixhitale e vend depozitimeve të mbetjeve urbane të ish –MZHU¹³ (që aktualisht administrohet nga MEI) ishte një nga të dhënat bazë që u konsiderua dhe u përdor për vleftësimin e të dhënave që vinin nga grupet lokale. Nga të dhënat zyrtare, rezulton që në hartën e ish-MZHU paraqiten:

- 89 vend depozitime jo sanitare të mbetjeve urbane
- 3 lëndfille me kushte sanitare

¹³ Në vijim kjo referohet thjesht harta e ish-MZHU

Nga gjeo-referencimi i informacionit të sjellë nga grupet lokale, pas saktësimeve të bëra¹⁴, rezultonin 199 vend depozitime në gjithë territorin e vendit. Bazuar në këtë informacion u realizua dhe harta në Web GIS që përmban gjithë informacionin e Nismës “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”¹⁵. Përshkrim më i detajuar i hartës së MTM jepet në vijim.




Fig. 4.5 Pamje nga faqja zyrtare e hartës së vend depozitimeve të ish-MZHU

Përveç diferencës me në numër të vend depozitimeve që përmban secila platformë, nga mbivendosja e këtyre harta, rezultoi që ka mjaft pika (vend depozitime) që nuk

¹⁴ Fillimisht nga grupet e punës u soll informacion për 234 vend depozitime, por 35 prej tyre nuk u përfshinë pasi nuk mund të quheshin si të tilla pasi rezultonin të ishin pika grumbullimi të përkohshme (fly tips)

¹⁵ Në vijim kjo referohet thjesht harta e MTM

përputheshin. Nga një analizë e thelluar, për çdo vend depozitim të hartës së ish MZHU-së, rezultuan rastet e mëposhtme:

Rasti 1: Vend-depozitimi i hartës së ish-MZHU nuk referohet fare në informacionin e sjellë nga grupi i punës në nivel lokal (Prefektura / Bashkia);

Rasti 2: Vend-depozitimi në hartën e ish-MZHU rezulton në një pozicion tjetër nga ai që referohet nga grupet e punës, pavarësisht se referohet me të njëjtin emër (pra i njëjti vend depozitim përputhët me referenca por jo në hartë - janë të zhvendosur nga njeri-tjetri) dhe si rrjedhim duheshin unifikuar;

Rasti 3: Vend-depozitime në hartën e ish-MZHU jepet në formë dhe pozicion tjetër krahasuar me atë që referojnë grupet e punës. Rast tipik është ky më poshtë, në bashkinë e Selenicës, ku harta e ish MZHU referon vend depozitim poshtë rrugës ndërsa grupi i punës referon atë sipër rrugës. Nga ortofoto shihet qarte që në të dy pozicionet ka mbetje të depozituara.



Fig. 4.6 Vend depozitime në bashkinë Selenicë

Rasti 4: Vend depozitime që referohen në hartën e ish-MZHU por që për arsye të ndryshme ishin zhvendosur ose që në fillim ishin vendosur jo saktësisht në hartë. Ndër këto mund të përmendim rastin e vend depozitimit në Gramsh.

Ndërtimi i hidrocentralit të Banjës në kaskadën e Devollit kishte bërë të domosdoshme zhvendosjen e vend depozitimit ekzistues pasi përmytej nga liqeni që krijohet. Në këto

kushte bashkia kishte miratuar¹⁶ zhvendosjen e këtij vend depozitimi në fshatin Mashan të Gramshit.



Fig. 4.7 Pamje e pozicionit të vend depozitimit të zhvendosur në Gramsh

Rast tjetër ishte edhe në bashkinë Skrapar, ku përmes komunikimit zyrtar pretendohet që vend depozitimi i hartës ish MZHU ishte vendosur gabim dhe duhej korrigjuar sipas informacionit nga grupi i punës.

E gjithë puna e bërë në krahasimin e të dhënave me hartën e ish MZHU u pasqyrua edhe në korrigjimin apo hartimin nga e para të formularëve dhe raporteve vlerësuese për secilin vend depozitim. Ky proces do trajtohet në vijim tek paragrafi 4.3.3, ku përshkruhet angazhimi i kompanisë konsulentë për vleftësimin e të dhënave.

¹⁶ Vendim Këshillit Bashkiak Nr.10, dt. 10.02.2016 “Për mbylljen e vend depozitimit aktual të mbetjeve urbane dhe miratimin e vend depozitimit të ri të bashkisë Gramsh”

4.3.3. Vleftësimi i të dhënave

Pjesë e angazhimit të kompanisë konsulente ishte dhe vleftësimi i të dhënave që grumbulloheshin dhe raportoheshin nga grupet e punës. Ky proces konsistonte në vlerësimin teknik, korrigjimin dhe plotësimin e:

- formularëve të pikëzimit të çdo vend depozitimi;
- raportet e kategorizimit të vend-depozitimeve në nivel Qarku/ Bashkie;
- raportet e rekomandimeve (masat ndërhyrëse dhe preventivimin) në nivel Qarku/ Bashkie;

Më konkretisht, ekspertët e profileve të ndryshme të kompanisë konsulente bënë vlerësimin e tyre profesional në lidhje me gjithë problematikat e hasura nga grupet e lokale, të sqaruara në paragrafin 2.1, për të gjitha fazat e procesit, duke filluar me evidentimin e vend depozitimeve e duke mbaruar me rekomandimet për masat ndërhyrëse e preventivimin e tyre.

Gjatë procesit të vleftësimit u konsideruan edhe të informacionet e marra nga AKPT dhe përmbajtja e hartës së ish-MZHU. Paketa e plotë e të dhënave që kërkonte Metodologjia (Formular pikëzimi dhe Raporte) u hartuan nga e para, për të gjitha vend depozitimet që ishin tek harta e ish-MZHU por që nuk referoheshin nga grupet e punës në nivel lokal (Paragrafi 4.3.2, Rasti 1). Këto, u bënë pjesë e raporteve në nivel bashkie, të cilat u ridërguan për aprovim final.

Duhet të kemi parasysh që angazhimi i kompanisë nuk parashikonte vizita në terren me qëllim verifikimin e kritereve teknike apo matjeve direkte.

Në vijim jepen ndërhyrjet kryesore për secilën fazë të procesit:

1. Formulari i Pikëzimit të vend depozitimeve

Sic u trajtua dhe më sipër, për 34 vend depozitimet të cilat figuronin në hartën e ish-MZHU por nuk referoheshin nga grupet lokale, Formularët e Pikëzimit u hartuan nga e para.

Gjithashtu u korrigjuan 64 Formularë, kryesisht për kriteret ku grupet e punës në nivel lokal kishin hasur problematika në vlerësim (të trajtuara në paragrafin 2.1.2). Në fund të gjithë formularëve të korrigjuar është vënë edhe shënimi përkatës për ndryshimet e bëra duke dhënë dhe arsyen e ndryshimit.

Duke konsideruar nivelin e lartë të informalitetit, kryesisht në ultësirën përendimore të vendit, kriteri për afërsinë e vend depozitimit me zonat e banuara (kriteri nr.8) u plotësua/korrigjua duke konsideruar distancën nga kufiri i zonës së urbanizuar të përcaktuar sipas vendim të KKT Nr. 5 dt. 29.12.2014¹⁷.

¹⁷ Vendim të KKT Nr. 5 dt. 29.12.2014 "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban".

Për verifikim hartës së Vendimit KKT Nr.5 iu mbivendos hartat e dendësisë së popullsisë me qeliza 1km², të INSTAT.




Fig. 4.8 Përcaktimi i distancës nga zonat e banuara

2. Raporti i Kategorizimit

Fillimisht tek Raportet e Kategorizimit (në nivel Bashkie/Qarku) u përfshinë 34 skedat e vend depozitimeve të cilat rezultonin vetëm në hartën e ish-MZHU.

Gjithashtu të gjitha korrigjimet e Formularëve të Pikëzimit u reflektuan edhe në raportet e Kategorizimit.

3. Raporti i Rekomandimeve dhe Preventivimi i Masave Ndërhyrëse

Siç u trajtua dhe më sipër (paragrafi 2.1.5), zgjedhja e masave adekuate për zbutjen e risqeve kryesore të evidentuara nga Metodologjia dhe preventivimi i tyre ka qenë ndër procesit që ka hasur më shumë probleme. Reagimet e grupeve lokale në këtë aspekt janë grupuar sipas rasteve të mëposhtme:

- Grupi i Punës në nivel lokal ka hartuar Raportin e Rekomandimeve dhe ka bërë preventivimin e masave ndërhyrëse duke marrë në konsideratë të gjithë masat e referuara sipas Metodologjisë dhe sugjerimet në lidhje me standardet e kostimit. Në këto raste konsulenti nuk ka ndërhyrë. (Rasti kur Grupet e Punës kanë patur ekspertizën dhe kanë kuptuar plotësisht Metodologjinë për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime);
- Grupi i Punës në nivel lokal nuk ka hartuar plan masash ose ka parashikuar vetëm disa masa teknike (p.sh. vetëm rrethim të vend-depozitimit) kur qartësisht janë të nevojshme dhe masa të tjera. Në këto raste konsulenti ka ndërhyrë duke hartuar ose plotësuar planin e masave dhe preventin përkatës;
- Për rastet kur vend depozitimi jepet vetëm në hartën e ish-MZHU, Plani i masave dhe preventivimi i tyre është hartuar nga e para Konsulenti;
- Ekspertiza teknike të mbështetura nga donatorë të huaj (GIZ, Eptisa) kanë parashikuar plane specifike për vend depozitime të caktuara për zonat që ato mbulojnë. Në këto raste, duke verifikuar vlerësimet dhe projektet teknike të hartuara është rakorduar për të patur një përputhje me masat që propozon Metodologjia dhe verifikim i preventivave në lidhje me standardet kombëtare.

Me qëllim unifikimin masave ndërhyrëse dhe përllogaritjen respektive të kostove sipas Metodologjisë së pranuar, MTM ka udhëhequr një proces koordinimi me gjithë aktorët e përfshirë në proces. Si material teknik bazë për llogaritjet u referua Manuali i Çmimeve 2015¹⁸, i cili përdoret zyrtarisht në përllogaritjen e kostove për punimet publike. Për ato zëra punimesh që Manuali nuk i përcaktonte saktësisht, grupi i ekspertëve duhej të bënte analizat përkatëse bazuar në kriteret e përcaktuara në këto manuale.

Ndër problematikat kryesore të preventivimit të masave ndërhyrëse ngelet saktësia e kostove e cila varet direkt nga saktësia e volumeve të punimeve të nevojshme për t'u bërë, rast pas

¹⁸Miraturar me VKM Nr. 629, dt. 15.7.2015 «Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre»

rasti, në çdo vend depozitim. Siç u trajtua dhe më sipër (paragrafi 2.2, Limitet (kufizimet) e Metodologjisë), duke konsideruar një sërë faktorësh që ndikojnë në saktësinë e vlerësimit, duhet të pranojmë që rezultatet e kësaj Nisme përfshijnë një marzh gabimi. Si rrjedhim, kostot e referuara ngelen orientuese me një saktësi të pranueshme për nivelin e studimit të bërë në këtë fazë. Zbatimi konkretisht i propozimeve të bëra në lidhje me ndërhyrjet në vend depozitime kërkon punë të specializuar shtesë për përgatitjen e Projekteve Teknike dhe preventivave përkatës për çdo vend depozitim.

Konsulenti i përfshirë në vleftësimin e të dhënave ka bërë vlerësimet e nevojshme për secilin nga rastet e cituara më sipër (kur ka qenë e nevojshme). Në paragrafët në vijim përshkruhen në formë të përmbledhur konsiderata teknike për llogaritjen e volumeve dhe kostove të transportit të mbetjeve.

4.3.4. Llogaritja e volumeve të punimeve dhe transportit të mbetjeve

Në rastet kur nuk ka patur të dhëna të qarta në lidhje me sipërfaqen dhe volumin e mbetjeve në vend depozitime, ekspertët e kompanisë konsulente kanë përdorur dy koeficiente ks dhe kv që tregohen skematikisht më poshtë.

Duhet të kemi parasysh që në shumicën e rasteve, vend depozitimet janë thjesht prona publike të vëna në dispozicion për këtë shërbim dhe nuk kanë asnjë punim të mirëfilltë për t' i kategorizuar ato si infrastruktura për grumbullimin e mbetjeve. Operimi pa asnjë lloj kriteri bën që mbetjet të jenë në shpërndara në formë të çrregullt në sipërfaqe të mëdha toke.

Për këtë qëllim, ekspertët e kompanisë konsulente përdorën koeficiente ks dhe kv të cilët paraqesin përafërsisht:

ks – është raporti i sipërfaqes së pronës (parcelës publike) që përdoret si vend depozitim me sipërfaqen e zënë nga mbetjet. Vlerat e këtij koeficienti variojnë nga 0.1 - 1

kv – është koeficient që duke u shumëzuar me sipërfaqen e vend depozitimit (të përcaktuar si më sipër), jep volumin e mbetjeve në vend depozitim. Më konkretisht, ky koeficient shpreh lartësinë e trupit të mbetjeve (të shprehur në m).



Këto koeficiente janë përcaktuar duke u bazuar në:

- Ortofoto (ASIG) dhe platforma te tjera;
- Foto nga Grupi i Punës lokal;
- Kohëzgjatja e përdorimit të vend-depozitimit (e referuar në Raportet e Kategorizimit);
- Mënyra e operimit (e referuar në Raportet e Kategorizimit);
- Komunikimet direkte me ekspertët lokal të grupeve të punës;
- Vlerësimin inxhinierik të eksperteve të kompanisë konsulente.

Problematike ngelet rasti i vend depozitimeve pranë lumenjve, ku mbetjet zhvendosen, kryesisht gjatë stinëve të shirave dhe si rrjedhim materialet fotografike nuk mund të konsiderohen.

$$\text{Sip. VD} = k_s \times \text{Sip.Pronës}$$

$$\text{Vol.mbetjeve} = k_v \times \text{Sip.VD}$$



*) konturi i pronës është kufiri i parcelës të vënë në dispozicion nga bashkia për depozitimin e mbetjeve.

Fig. 4.9 Përcaktimi i koeficienteve k_s dhe k_v

Kostot e transportit (Largimi i mbetjeve)

Kosto e transportit është bazuar ne Analizën e hartuar për këtë qëllim duke konsideruar Manualin e çmimeve të vitit 2015. Për të llogaritur çmimin e transportit për m^3 mbetje, janë analizuar dy faktorë kryesorë:

1. Çmimi për ton x km në varësi të distancës së transportit;
2. Pesha vëllimore e mbetjeve
 - Mbetje inerte (të ngurta) 1.7 ton/m^3
 - Mbetje urbane 0.7 ton/m^3

Pesha vëllimore	Distanca	Produkti	Çmim/ njësi peshe	Çmim/ njësi vëllimi	Vëllim	Vlera
Ton/ m^3	km	Tonxkm/ m^3	Lek/Tonxkm	Lek/ m^3	m^3	Lek
0.7	1	0.7	50	35	10	350
0.7	5	3.5	30	105	10	1,050
0.7	10	7	22	154	10	1,540
0.7	20	14	21	294	10	2,940
0.7	50	35	21	735	10	7,350




Fig. 4.10 Grafik i ndryshimit të koston së transportit

Kosto e mësipërme konsideron transportin duke përdorur kamionë të zakonshëm ngarkim-shkarkim, duke përfshirë gjithë zërat që parashikojnë analizat teknike të Manualit të çmimeve për të tilla punime.

Në rastet kur, konsultenti ka përllogaritur koston e Largimit të Mbetjeve ka parashikuar që destinacioni të jetë vend depozitimi më i afërt i rehabilituar.

Dërgimi në landfille sanitare apo ITM Elbasan, sipas qasjes së Metodologjisë, është parashikuar vetëm në rastet kur vend depozitimet që do largohen ndodhen deri në 40km pranë këtyre infrastrukturave.

Vlen të theksohet që në të gjitha rastet konsultenti ka bazuar analizat tekniko-ekonomike në distancën më të shkurtër.

Në të gjitha rastet, në kostimin e ndërhyrjes (Largim i mbetjeve) nuk janë parashikuar:

- kosto për depozitim (gate fee),
- kostot e nevojshme për përmirësimin e terrenit pas largimit të mbetjeve.

Largimi i plotë apo i pjesshëm i mbetjeve duhet verifikuar rast pas rasti.

4.3.5. Platforma Web GIS

Një nga detyrat kryesore të kompanisë konsulente ishte dhe hartëzimi i gjithë informacionit në platformën GIS. Ky instrument bën të mundur evidentimin/raportimin e të dhënave, në nivele dhe për tematika të ndryshme, në bazë të nevojave të përdoruesit.

Në faqen e platformës WebGis, të ngritur për këtë qëllim, shfaqet fillimisht harta fizike e Shqipërisë e ndarë sipas kufijve të bashkive përcaktuar nga RAT¹⁹. Në këtë hartë jepen të shënuar me pika (me ngjyra të ndryshme) dhe gjithë vend depozitimet e konsideruara në këtë platformë. Aty tregohen edhe vend depozitimet sanitare, përfshi inceneratorët, e ndërtuar dhe ato të planifikuar, pavarësisht se nuk kanë qenë objekt i studimi.

I gjithë informacioni aktualisht i hostuar në server të kompanisë konsulente²⁰, pas miratimit të raportit do transferohet në faqen zyrtare të MTM.




Fig. 4.11 Pamje nga platforma dixhitale e MTM

¹⁹ Ligj Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

²⁰ <http://uts-01.com/WebGis/venddepozitime/>

Në pjesën e poshtme, në të majtë janë vendosur dy menu që nëse aktivizohen shfaqin informacion më të detajuar për vend depozitimet bazuar në interesin e përdoruesit.

Nëse aktivizohet (klikohet) Menuja layer (shtresat) , në pjesën e majtë të ekranit shfaqen disa të dhëna në formë tabelare, ku sipas kërkesës filtrohet informacioni i kërkuar. Filtrimi mund të bëhet për të marrë informacion:

- Në nivel bashkie
- Në nivel qarku
- Në nivel Zonë Mbetjesh²¹




Fig. 4.12 Aktivizimi i menisë Shtresat

I aktivizuar, fillimisht shfaqet opsioni me bashki (dhe gjithë lista e bashkive), pasi është ajo hartë që shohim konkretisht në ekran, pra me kufijtë territorial admirativ të bashkive. Nëse klikojmë një nga bashkitë, atëherë platforma të fokuson vetëm tek bashkia e kërkuar (shiko figurën në vijim ku është aktivizuar bashkia Mirditë).

²¹ Kufinj të Zonave të Mbetjeve referohen Draft-MasterPlan që po hartohet nga MIE.




Fig. 4.13 Pamje e vend depozitimeve në bashkinë Mirditë, në platformën WebGIS

Nëse aktivizojmë “Ndarja sipas Qarqeve”, tek menuja shfaqen gjithë emrat qarqeve dhe njëkohësisht në ekran shfaqet harta e Shqipërisë ku evidentohen kufijtë e Qarqeve. Nëse aktivizohet/zgjidhet një prej tyre, atëherë platforma në mënyrë të ngjashme me bashkitë, të fokuson tek Qarku i kërkuar.

E njëjta situatë, përsëritet nëse aktivizojmë “Ndarja sipas Zonave të Mbetjeve”, ku direkt shfaqet lista me 10 zonat e mbetjeve dhe njëkohësisht në ekran shfaqet harta e Shqipërisë ku evidentohen kufijtë e Zonave të Mbetjeve.

Nëse aktivizojmë “Ndarja sipas baseneve të lumenjve” në ekran shfaqet harta e Shqipërisë e ndarë sipas 6 baseneve të lumenjve kryesorë :

- Drini – Buna
- Mati
- Ishmi – Erzeni
- Vjosa
- Shkumbini
- Semani

Tasti “Reset” në pjesën e poshtme të menisë, ç’aktivizon gjithçka dhe kthen pamjen “default” të platformës në momentin që hapet. Në vijim imazhe për secilin rast të sqaruar më sipër.




Fig. 4.14 Platforma tregon “Ndarja sipas Qarqeve”




Fig. 4.15 Platforma tregon “Ndarja sipas Baseneve”

Një mundësi tjetër për të filtruar informacion është edhe të selektosh: “VD sipas distancës nga lumi/rrjedha ujore”. Në këtë rast, grafikisht të gjitha pikat e vend depozitimeve ngjyrosen me jeshile dhe të kuqe, që tregojnë:

- Vend depozitim në distancë më larg se 300m nga bregu lumit, dhe;
- Vend depozitim në distancë më afër se 300m nga bregu lumit.




Fig. 4.16 Platforma tregon vend depozitimet sipas kriterit të afërsisë me lumenjtë

4.4. Prezantimi në Simpozium Shkencor Ndërkombëtar “Trajtimi i mbetjeve dhe sfidat drejt të ardhmes”

Gjetjet kryesore të Nismës “Për zbutjen e riskut në vend depozitime” u prezantuan dhe në Simpoziumit Shkencor Ndërkombëtar “Trajtimi i mbetjeve dhe sfidat drejt të ardhmes” organizuar në Tiranë dhe Korçë, në datat 17 -18 Maj 2018. Ky simpozium u organizua nga Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit pranë FIN dhe u mbështet nga GIZ Albania, dldp dhe Ambasada Hollandeze në Tiranë.

Të ftuar në këtë simpozium ishin dhe dy kërkues shkencor ndërkombëtar,

- Prof. Dr. Martin Wittmaier, Drejtor i Institutit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Rinovimin e Energjisë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara, Bremen, Gjermani
- Dr. Ljiljana Rodic – Eksperte e vlerësimit pranë Programit Horizon 2020 të Komisionit Europian, Universiteti i Leiden, Hollandë

të cilët kishin rolin e vlerësuesve teknik për të gjithë prezantimet e bëra.

Në ditën e parë të simpozium, Z. Arben Kopliku (zv.menaxher programi, dldp) prezantoi eksperiencën disa vjeçare të dldp në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Për këtë qëllim, me ndihmën e disa studentëve të Departamenti të Inxhinierisë së Mjedisit u përgatit dhe një poster me temë “Ekspertiza inxhinierike përmes qeverisjes”, që përmbante të dhëna përfaqësuese për angazhimin e dldp në nivel qendror dhe lokal, në këtë sektor

Në ditën e dytë të Simpoziumit, Z. Rikard Luka, ekspert i dldp, referoi gjetjet kryesore të Nismës “Për zbutjen e Riskut në Vend depozitime”. Prezantimi konsistoi në katër aspekte kryesore:

- përshkrim të shkurtër metodologjik dhe punën e bërë nga grupet e ekspertëve në nivel lokal;
- harmonizimin e të dhënave dhe rezultateve me platforma dhe instrumente strategjike kombëtare në proces hartimi,
- procesin e vleftësimit përmes ekspertizave në nivel qendror dhe;
- rezultatet paraprake të arritura dhe skenarë të ndërtuar për prioritete të ndryshme.

Prezantimi u shoqërua me një sesion diskutimesh nga të pranishmit ku mori dhe vlerësime të konsiderueshme si për procesin e ndjekur ashtu dhe për qëndrueshmërinë e rezultateve të paraqitura.

Në Aneks 4, pjesë integrale e këtij Raporti, do gjeni Vlerësimin e Komitetit Shkencor të Simpoziumit në versionin origjinal (të skanuar).

5. Mbështetja ligjore për Nismën “Zbutja e riskut në vend depozitime”

Së fundmi, MTM me mbështetjen e GIZ Albania, ka amenduar VKM Nr. 452, dt. 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”. Këto ndryshime ligjore kanë ardhur kryesisht si nevojë e përshtatjes së kontekstit zhvillimor të vendit tonë krahasuar me nivelin e lartë të kërkesave të kuadrit rregullator ligjor. Disa nga problematikat kryesore mund të përmendim:

- Ligji “Për menaxhim e integruar të mbetjeve” dhe VKM Nr. 452, dt. 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve” parashikojnë një proces rrënjësor transformimi të vend-depozitimeve ekzistuese të mbetjeve për t’i sjellë ato në standardet e një lëndfilli, apo mbylljen e tyre në rastet e pamundësisë së këtij transformimi;
- Njësitë e vetë-qeverisjes vendore të gjendura në trysinë kohore dhe standardet e larta të kërkuara për të realizuar këtë transformim kanë abstenuar në marrjen e iniciativeve duke prezumuar të pamundur këtë proces;
- Qasja e kuadrit ligjor në fuqi për t’i sjellë vend-depozitimet në standardet e lëndfillit për një periudhë më të shkurtër se ajo e parashikuar për vendet anëtare të BE-së, ka sjellë një situatë ku thuajse nuk ka asnjë ndërhyrje.

Me qëllim adoptimin plotësisht të Direktivës 1999/31/EC “Për lëndfillet e mbetjeve” dhe për të garantuar zbatimin e detyrimeve (të munguara), ndryshimet e propozuara parashikojnë zgjatjen e periudhave tranzitore si dhe futjen e një hallke të ndërmjetme të kriterëve të arritshme për vend-depozitimet ekzistuese.

Në këtë kontekst është kryer një vlerësim mbi periudhën tranzitore të nevojshme, si dhe kriteret teknike minimale për t’u plotësuar nga vend-depozitimet ekzistuese.

Vlen të theksohet që, pjesë e ndryshimeve të VKM Nr.452 janë edhe masat e ndërhyrjes të parashikuara për përmirësimin e gjendjes ekzistuese dhe disa nga kriteret bazë të operimit në vend depozitime. Këto janë në përputhje të plotë me ato të propozuara nga Metodologjia “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”, që ka qenë dokumenti udhëzues (guide line) i gjithë procesit teknik.

Në këtë mënyrë, në përputhje të plotë me Nismën e MTM “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”, bëhet e mundur që bashkitë sot të arrijnë disa standarde për vend depozitimet e mbetjeve për një periudhë tranzitore, deri në ndërtimin e lëndfilleve dhe inceneratorëve sipas masterplanit që po përgatitet.

6. Rezultate dhe skenarë

Në këtë kapitull paraqiten rezultatet përfundimtare të Nismës “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”. Këto, bazohen në gjithë të dhënat e grumbulluara nga grupet lokale dhe procesin e vleftësimit nga institucionet e përfshira në nivel qendrorë dhe kompania konsulente. Siç u trajtua dhe më sipër, procesi i vleftësimit u përmbyll me ridërgimin e raporteve edhe një herë pranë bashkive për të marrë konfirmimin dhe dakordësinë e tyre për korrigjimet apo ndryshimet e bëra.

Sa më sipër, rezultatet e paraqitura janë të analizuara teknikisht nga ekspertiza të ndryshme por njëkohësisht kanë marrë dhe miratimin e bashkive.

6.1. Skenari bazë (rezultatet e Nismës)

Në skenarin bazë është marrë në konsideratë vendimmarrja e bashkive sa i takon tipit të ndërhyrjes së propozuar për çdo vend depozitim (Rehabilitim, Largim ose Mbyllje). Tabela në vijim jep rezultatet në nivel kombëtar në lidhje me numrin e vend depozitimeve sipas secilës ndërhyrje, kostot respektive dhe kosto mesatare që del nga raporti i kostos totale me numrin e vend depozitimeve.

Tabela 6-1 Rezultatet e skenarit bazë

Tipi i ndërhyrjes	Nr. Vend depozitim	Vlera ndërhyrjes (milion lekë)	Vlera mes. (milion lekë)
Rehabilitim	44	345	7.85
Mbyllje	62	355	5.73
Largim	93	170	1.83
Total	199	870	4.38

Numri i lartë i vend depozitimeve që propozohen të largohen (gati 50% e numrit total) lidhet me faktin e vend ndodhjes së tyre kryesisht në afërsi të brigjeve ujore (lumenj, liqene)

Nga kjo analizë rezulton që ndërhyrja në nivel kombëtar, për zbutjen e riskut në vend depozitime, kushton 870 milion lekë ($\approx 7\,000\,000$ €)

Tek kjo vlerë përfshihet vetëm zbatimi i punimeve për ndërhyrjet e propozuara. Duke bërë një vlerësim të përafërt të kostove të projekteve teknike që duhen hartuar, mbikëqyrjes dhe kolaudit sipas standardeve kombëtare²² rezulton që për zbatimin e ndërhyrjeve duhet konsideruar dhe një vlerë 61 milion lekë (ose 500 000€). Kjo vlerë përkon me 7% kostos totale të zbatimit.

²² VKM Nr.354, dt. 15.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudit”

Duhet të kemi parasysh që kostimi i largimit të mbetjeve konsideron dërgimin e tyre në vend depozitimin më të afërt në rehabilituar, kryesisht brenda territorit administrativ të bashkive. Vendim marrja e bashkive sugjeron dërgim të mbetjeve në landfille / impiante sanitare vetëm në rastet kur ato janë pranë vend depozitimeve që do largohen. Theksojmë që, në të gjitha rastet, në koston e kësaj ndërhyrje nuk parashikohet tarifa e depozitimit.

Çështje që kërkojnë vendim marrje

1. Duke analizuar kërkesat e bashkive për të rehabilituar vend depozitime na rezulton që kemi 3 grupe kryesore:

- 25 Bashki që nuk kërkojnë rehabilitim të asnjë vend depozitimi (bashkitë që ndodhen pranë landfilleve sanitare apo inceneratorit të Elbasanit)
- 29 bashki që kërkojnë rehabilitim të një vend depozitimi
- 7 Bashki që kërkojnë rehabilitim të më shumë se një vend depozitimi

Duke konsideruar sugjerimet e MTM, për rehabilitim të vetëm një vend depozitimi në nivel bashkiak, duhet që përpara nisjes së procesit të zbatimit të bëhet një negociim final me grupin e bashkive që propozojnë më shumë se një rehabilitim. Rast i veçantë është bashkia Pukë, që pavarësisht rehabilitimit të vend depozitimit në Fushë Qarri, kanë kërkuar rehabilitim edhe atë në Nj.A. Gjegjan.

2. Analizë e thelluar nga ana e MTM duhet bërë edhe në rastin e kërkesave për rehabilitim të vend depozitimeve në afërsi në zonave të mbrojtura mjedisore dhe atyre me ndikim në zhvillimin e turizmit (kryesisht zona bregdetare). Duhet të merret në konsideratë që në këto raste, edhe pse një zgjidhje jo ekonomike, mund të jetë më e përshtatshme të mbyllen këto vend-depozitime dhe të hapen të reja në vende më të përshtatshme.

3. Vlerësim, rast pas rasti, duhet bërë edhe në rastet kur MEI apo bashkitë disponojnë projekte zbatimi të gatshme për mbylljen e vend depozitimeve, të hartuar këto nga kompani të licencuara që përpara nisjes së këtij procesi. Diferenca e kostos të Planit të Ndërhyrjeve Emergjente të hartuar sipas kësaj Nisme, me vlerën e preventivave të projekteve të zbatimit ka bërë që në disa raste bashkitë nuk konfirmojnë vendim marrjen e propozuar.

4. Duke përfshirë edhe rastin e mësipërm, MTM duhet të konfirmojë vendim marrjen me ato pak bashki që nuk janë shprehur qartësisht për dakordësinë e propozimeve sipas kësaj platforme.

Në vijim harta e vend depozitimeve sipas ndërhyrjes së propozuar nga bashkitë.




Fig. 6.1 Harta e ndërhyrjeve për skenarin bazë

6.2. Skenarë të ndryshëm

Skenarët e ndërhyrjeve të hartuar në kuadër të kësaj platforme, bazohen kryesisht në prioritetet e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit por njëkohësisht edhe në problematikat kryesore që shfaqin vend depozitimet në lidhje me:

- Riskun ndaj mjedisit duke u fokusuar në zonat e mbrojtura,;
- Mbrojtja e lumenjve;
- Ndikimin në zonat turistike duke u fokusuar në zonën bregdetare

Shihet qartë që prioritetet e caktuara janë komplementarë me njëri tjetrin dhe ndikojnë në tërësi në përmirësimin e cilësisë së jetës për popullatën dhe zhvillimin ekonomik të vendit, duke vlerësuar këtu rolin që ka zhvillimi i turizmit në ekonominë kombëtare.

Për të qenë sa më afër realitetit, në vlerësimet e bëra, për të ndërtuar skenarët e ndërhyrjeve prioritare janë përdorur një seri të dhënash në lidhje me:

- Rrjetin rrugor ekzistues²³;
- Rrjetin hekurudhor²⁴ duke konsideruar itineraret aktive për lëvizjen e trenave të mallrave dhe stacionet e shpërndara në gjithë territorin e vendit;
- Zonën bregdetare me prioritet zhvillimin e turizmit të përcaktuar nga PINS Bregdetit²⁵;
- Hartën e Zonave të Mbrojtura²⁶ të shpallura si të tilla me VKM.

Duke konsideruar këto zona me rëndësi kombëtare, në skenarët e hartuar, gjithmonë masat e ndërhyrjeve në vend depozitime janë parashikuar si: Mbyllje ose Largim i mbetjeve. Pra, konkretisht në asnjë rast nuk është parashikuar Rehabilitim i vend depozitimeve në zonat e përcaktuara me prioritet kombëtar për përmirësim të gjendjes mjedisore.

Sa i përket llogaritjes së vlerës së kostove të punimeve, për ndërhyrjet e citura më sipër, çmimet dhe analizat janë bazuar në Manualin e çmimeve, viti 2015.

Në raport, rezultatet e secilit prej skenarëve janë paraqitur në nivel kombëtar, duke dhënë edhe disa elementë kryesore që janë konsideruar në llogaritjen e kostos dhe problematikat kryesore që mund të hasen në fazën e zbatimit.

Këto skenarë dhe analiza janë të hartuar nga kompania konsulente në bashkëpunim të ngushtë me stafin teknik të MTM. Përveç Skenarit 1, të tjerët nuk marrin në konsideratë vendim marrjen e bashkive përta i takon ndërhyrjes në vend depozitime.

²³ Burimi i të dhënave është ASIG dhe Google MAP.

²⁴ Burimi i të dhënave është ASIG dhe Raporti Vjetor 2017 i Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor në varësi të MEI (<http://dih.gov.al/>).

²⁵ Sipas përcaktimeve të Vendim KKT Nr.02, dt.14.06.2016 "Për miratimin e Planit të Integruar Ndër Sektorial për Brezin Bregdetar".

²⁶ Burimi i të dhënave është faqja Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura: (<http://akzm.gov.al/harta-digitale>).

6.2.1. Skenar 1 – Largimi i mbetjeve me hekurudhë në ITM Elbasan

Në këtë skenar është llogaritur largimi i mbetjeve duke përdorur rrjetin hekurudhor për gjithë vend depozitimet që bashkitë kanë vendosur si masë ndërhyrëse: Largim të mbetjeve. Kuptohet që numri i vend depozitimeve që konsiderohen në këtë rast përputhet me atë të skenarit bazë, pra sipas vendim marrjes së bashkive (93 vend depozitime).

Skenari 1
93 Vend depozitime që largohen drejt ITM Elbasan
Kosto: 220 500 000 Lek

Në vijim, disa pranime të bëra në llogaritjen e koston së kësaj ndërhyrje në nivel kombëtar dhe disa problematika që mund të shfaqen në fazën e zbatimit të këtij skenari.

Pranime:

- Rrjeti hekurudhor është i gjithi funksional. Nga komunikimi zyrtar është referuar që për transportin e mallrave janë funksionale të gjitha itineraret;
- Në llogaritjen e vlerës së kësaj ndërhyrje në nivel kombëtare nuk është konsideruar kosto e transportit hekurudhor;
- Nuk është konsideruar tarifa e depozitimit në ITM-Elbasan;
- Në rastet kur distanca rrugore nga vend depozitimi tek ITM Elbasan është më e shkurtër se deri tek stacioni më i afërt i trenit atëherë është konsideruar përdorimi i rrugës automobilistike (rasti i vend depozitimeve brenda territorit të bashkisë Elbasan apo bashkive fqinje në disa raste).

Problematika:

- Skenari bazohet në transport të kombinuar rrugor e hekurudhor dhe shoqërohet me disa procese ngarkim-shkarkimi të mbetjeve që sjellin rrezik për punëtorinë e angazhuar dhe ndotje të mëtejshme të zonave ku kryhen këto procese. Për të shmangur pjesërisht këtë problematikë mund të jetë e nevojshme ndërhyrja në stacionet e trenit duke ndërtuar platforma të përkohshme nga ku mund të shkarkohet direkt nga kamioni në vagon;
- Për rentabilitet të procesit kërkohen minimalisht 200 ton mbetje, që treni i mallrave të vihet në lëvizje;
- Gjatë realizimit të këtij skenari rrezikohet që stacionet e trenit të kthehen përkohësisht në «stacione transferimi» mbetjesh;
- Afërsia e stacioneve të trenit me qendrat e banuara mund të sjellë bezdisje të popullatës në lagjet periferike pranë këtyre stacione dhe ndotje të tyre;
- Nuk ka një vlerësim të qartë të përshtatshmërisë së mbetjeve që dërgohen për incenerim. Mbetjet organike kanë përqindje të lartë uji dhe nuk vlen të dërgohen.
- Disa nga vend depozitimet kanë distancë më shumë se 50km nga stacioni më i afërt.




Fig. 6.2 Harta skematike për Skenarin 1

6.2.2. Mbrojtja e lumenjve

Të përgjithshme

Territori i vendit tonë përshkohet nga një rrjet i dendur lumenjsh, të cilët në rrjedhjet e sipërme kanë karakter malor me rrjedhje të shpejtë dhe forcë të madhe erozive, kurse në rrjedhjet e poshtme kanë karakter fushor. Përveç lumit Bistrica që derdhet në detin Jon, të gjithë lumenjtë e tjerë derdhen në detin Adriatik.

Ky rrjet hidrografik përbëhet nga 11 lumenj kryesorë (shiko Tabela 6-2) të cilët kalojnë pranë dhe në disa raste përshkojnë qendrat kryesore urbane të vendit.




Fig. 6.3 Harta e baseneve ujëmbledhëse të lumenjve kryesor të Shqipërisë

Tabela 6-2 Lista e lumenjve të Shqipërisë

Lumi	Gjatësia (km)	Buron	Derdhet
Bistrica	25	Mali i Gjerë	Deti Jon
Buna	44	Liqeni i Shkodrës	Deti Adriatik
Cemi	63	Burimi i Berizhdolit	Moraça
Drini	285	formohet nga Drini i Bardhë dhe Drini i Zi	Deti Adriatik
Drini i	175	malet e Zhlebit, Radavc (Pejë, Kosove)	Drini
Drini i Zi		Shën Naumi (Liqeni i Ohrit)	Drini
Kiri	52	maja e Elbunit	Drini
Shala	35	Okol	Drini
Valbona	51	Bjeshkët e Nemuna	Drini
Erzeni	108	Afër Shëngjergjit	Deti Adriatik
Ishmi	74	bashkimi i Lumit të Tiranës, përrenjve Tërkuza dhe Zeza.	Deti Adriatik
Lana	29	Qafë Priskë, ana perëndimore të Dajtit (degë e lumit Tirana)	Ishmi
Tirana	10.2	Në malin e Dajtit	Ishmi
Mati	115	mali i Kaptinës, afër Krastës	Deti Adriatik
Fani	94	formohet nga Fan i Vogël dhe Fan i Madh	Mati
Semani	85		Deti Adriatik
Devolli	196	pjesa shqiptare e Gramozit	Semani
Osumi	161	afër Vithkuqit	Semani
Shkumbini	181	në jug të Pogradecit	Deti Adriatik
Vermoshi	220	Kufi Shqipëri-Mali i Zi	Liqeni i Plavës
Vjosa	272	malet e Pindit (Greqi)	Deti Adriatik
Drino	84.6	në veri të Janinës	Lumi Vjosa

Bazuar në Raportin e Gjendjes në Mjedis (viti 2016)²⁷, thuajse të gjithë lumenjtë e Shqipërisë paraqesin norma të larta ndotjeje. Duhet patur parasysh që në analizën e saj, AKM i klasifikon ujërat e lumenjve në 5 kategori, duke u bazuar në disa parametra kontrolli specifik ku ndikon jo vetëm prezenca e vend depozitimeve ilegale por edhe faktor të tjerë (si shkarkimet e ujërave të ndotura që ndodhin pranë lumenjve ,etj). Në hartën në vijim jepen niveli i ndotjes së lumenjve bazuar në stacionet e monitorimit të vendosura për këtë qëllim.

²⁷ Publikuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit




Fig. 6.4 Harta e monitorimit të lumenjve, viti 2016 (burimi AKM)

6.2.3. Skenar 2 - Ndërhyrja në lumenj

Në këtë skenar është llogaritur largimi i mbetjeve për të gjithë vend depozitimet që janë në një distancë 0-300 m nga shtretërit e lumenjve duke përfshirë edhe ato që vetë bashkitë kanë rekomanduar si ndërhyrje: Largim të mbetjeve. Duhet të kemi parasysh që grupet e punës lokale kanë rekomanduar këtë ndërhyrje kryesisht për vend depozitimet pranë lumenjve dhe prandaj përfshirja e tyre (93 VD) në këtë skenar është në përputhje të plotë me qasjen e kësaj ndërhyrje prioritare. Përfshirja e tyre gjithashtu rrit mbështetjen e skenarit në propozimet që vijnë nga grupet lokale pranë bashkive.

Nga analiza e bërë, rast pas rasti, rezulton që kemi 130 vend depozitime të tilla. Diferenca prej 37 vend depozitime shtesë vjen nga përfshirja në këtë skenar të:

- 12 vend depozitimeve që bashkitë kanë vendosur Rehabilitim dhe sipas skenarit duhet të largohen;
- 25 vend depozitime që bashkitë kanë vendosur Mbyllje dhe sipas skenarit duhet të largohen.

Në vijim jepet lista e vend depozitimeve që sipas grupeve të punës në nivel lokal është rekomanduar Rehabilitim, por që janë përfshirë në këtë skenar meqë janë në një distancë (0-300 m) nga lumi.

Nr.	Bashkia	Emërtimi i vend depozitimit
1.	Gramsh	Mashan
2.	Ura Vajgurore	5-Lagjia 28 Nentori
3.	Kuçovë	Ish Ferma Partizani
4.	Polican	3- Lagjia Plirez
5.	Tepelenë	Majkosh
6.	Memaliaj	Cepi i Janinave
7.	Këlcyrë	Variboh
8.	Përmet	Varrezat Publike
9.	Fier	Teodor II Muzaka
10.	Fushë Arrës	Kthesa e Krrabit
11.	Rrogozhinë	VD-MZHU1
12.	Skrapar	Çorovodë 1

Pavarësisht nëse ky skenarë do zbatohet ose jo, vlen të theksohet që ndërhyrja finale në këto 37 vend depozitime kërkon një vlerësim të thellë teknik përpara implementimit.

Bazuar në këtë analizë janë ndërtuar dy nën-skenarë, në varësi të destinacionit të mbetjeve:

- Skenari 2.1 – Mbetjet dërgohen në ITM Elbasan duke përdorur hekurudhën;
- Skenari 2.2 – Mbetjet dërgohen në landfillin sanitar më të afërt (përfshi këtu edhe ITM Elbasan) duke përdorur infrastrukturën rrugore. Si landfille sanitare janë pranuar: Bushat (Shkodër), Sharrë (Tiranë), Maliq (Korçë) dhe Bajkaj (Delvinë)

Skenari 2.1

Siç u citua dhe më sipër, në këtë skenar parashikohet largimi i mbetjeve nga 130 vend depozitimet dhe dërgimi i tyre me hekurudhë në ITM.

Skenari 2.1
130 Vend depozitime që largohen drejt ITM Elbasan, me hekurudhë
Kosto: 323 000 000 Lek

Në ngjashmëri me skenarin 1, në vijim jepen disa pranime të bëra në llogaritjen e kostos së kësaj ndërhyrje në nivel kombëtar dhe disa problematika që mund të shfaqen në fazën e zbatimit të këtij skenari. Vlen të theksohet që vend depozitimet e treguara në tabelën e mësipërme janë ato kryesore të bashkive dhe kanë prezent volum të madh mbetjesh. Si rrjedhim, procesi i largimit të tyre kërkon vlerësim të kujdesshëm teknik, pasi ndikimi mjedisor dhe risqet që dalin gjatë procesit janë të mëdha.

Pranime:

- Rrjeti hekurudhor është i gjithi funksional. Nga komunikimi zyrtar është referuar që për transportin e mallrave janë funksionale të gjitha itineraret;
- Në llogaritjen e vlerës së kësaj ndërhyrje në nivel kombëtare nuk është konsideruar kosto e transportit hekurudhor;
- Nuk është konsideruar tarifa e depozitimit në ITM-Elbasan;
- Në rastet kur distanca rrugore nga vend depozitimi tek ITM Elbasan është më e shkurtër se deri tek stacioni më i afërt i trenit atëherë është konsideruar përdorimi i rrugës automobilistike (rasti i vend depozitimeve brenda territorit të bashkisë Elbasan apo bashkive fqinje në disa raste).

Problematika:

- Skenari bazohet në transport të kombinuar rrugor e hekurudhor dhe shoqërohet me disa procese ngarkim-shkarkimi të mbetjeve që sjellin rrezik për punëtorinë e angazhuar dhe ndotje të mëtejshme të zonave ku kryhen këto procese. Për të shmangur pjesërisht këtë problematikë mund të jetë e nevojshme ndërhyrja në stacionet e trenit duke ndërtuar platforma të përkohshme nga ku mund të shkarkohet direkt nga kamioni në vagon;
- Për rentabilitet të procesit kërkohen minimalisht 200 ton mbetje, që treni i mallrave të vihet në lëvizje;
- Gjatë realizimit të këtij skenari rrezikohet që stacionet e trenit të kthehen përkohësisht në «stacione transferimi» mbetjesh;
- Afërsia e stacioneve të trenit me qendrat e banuara mund të sjellë bezdisje të popullatës në lagjet periferike pranë këtyre stacione dhe ndotje të tyre;
- Nuk ka një vlerësim të qartë të përshtatshmërisë së mbetjeve që dërgohen për incenerim. Mbetjet organike kanë përqindje të lartë uji dhe nuk vlen të dërgohen.
- Disa nga vend depozitimet në distancë më shumë se 50km nga stacioni më i afërt.

Skenari 2.2

Në këtë skenar parashikohet largimi i mbetjeve nga 130 vend depozitimet dhe dërgimi i tyre në landfillin sanitar më të afërt duke përdorur infrastrukturën rrugore. Si landfille sanitare janë pranuar: Bushat (Shkodër), Sharrë (Tiranë), Maliq (Korçë) dhe Bajkaj (Delvinë). Gjithashtu në analizë është përfshirë dhe dërgimi në ITM Elbasan

Skenari 2.2
130 Vend depozitime që largohen drejt landfilleve sanitare, me infrastrukturë rrugore
Kosto: `400 200 000 Lek

Në vijim jepen disa pranime të bëra në llogaritjen e kostos së kësaj ndërhyrje në nivel kombëtar dhe disa problematika që mund të shfaqen në fazën e zbatimit të këtij skenari. Vlen të theksohet që vend depozitimet e treguara në tabelën e mësipërme janë ato kryesore të bashkive dhe kanë prezent volum të madh mbetjesh. Si rrjedhim, procesi i largimit të tyre kërkon vlerësim të kujdesshëm teknik, pasi ndikimi mjedisor dhe risqet që dalin gjatë procesit janë të mëdha.

Për realizimin e këtij skenari u bë një analizë vlerësimi krahasimorë për të përcaktuar landfillin më të afërt sanitar në lidhje me çdo vend depozitim duke konsideruar infrastrukturën rrugore ekzistuese.

Përparësi e këtij skenari është se kemi vetëm një proces ngarkim-shkarkimi

Pranime:

- Transporti i mbetjeve me kamionë të zakonshëm që përdoren për ngarkim-shkarkim dhe llogaritja e kostos në përputhje me paragrafin 4.3.4;
- Nuk është konsideruar tarifa e depozitimit në landfillet sanitare dhe ITM-Elbasan.

Problematika:

- Nuk ka një vlerësim të qartë të përshtatshmërisë së mbetjeve që dërgohen për incenerim. Mbetjet organike kanë përqindje të lartë uji dhe nuk vlen të dërgohen;
- Sasia e mbetjeve që dërgohen është e konsiderueshme dhe mund të ezaurojë pjesë të madhe të kapacitetit të landfilleve sanitare;
- Landfilli i Sharrës (Tiranë) ka hyrë në fazën e mbylljes dhe pritet të ndërtohet Inceneratori i ri.

Në vijim jepet harta skematike për këtë skenar.




Fig. 6.5 Harta skematike për Skenarin 2.2

6.2.4. Skenar 3 - Ndërhyrja në Zonat e Mbrojtura dhe Bregdetare

Bazuar në Draft-Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2018-2022, turizmi shihet si sektor strategjik përmes të cilit Shqipëria mund të arrijë rritje të qëndrueshme afatgjatë dhe konkurrueshmëri, duke siguruar mbrojtje efektive të mjedisit.

Skenari 3, bazohet pikërisht në këtë lidhje të ndërsjelltë që ka mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i turizmit në vendin tonë, dhe jo vetëm.

Në këtë skenar trajtohen vend depozitimet që ndodhen në Zonat e Mbrojtura Mjedisore (të përcaktuara me VKM) sipas hartës zyrtare të AKZM dhe ato në brendësi të brezit bregdetar me përparësi zhvillimin e turizmit të përcaktuar në PINS Bregdet. Nga analiza e bërë rezulton që brenda këtyre zona më rëndësi kombëtare kemi 35 vend depozitime që kërkojnë një vëmendje të veçantë.

Duke konsideruar si ndërhyrje emergjente ato në zonat prioritare, është pranuar rekomandimi i bashkisë dhe kosto e ndërhyrjes është llogaritur duke bërë shumatoren e vlerave të preventivave të hartuar në bashkëpunim me Grupet e Punës lokale.

Skenari 3
35 Vend depozitime që rehabilitohen, mbyllen ose largohen sipas propozimit të bashkive
Kosto: 205 000 000 Lek

Pranime:

- Pranohet propozimi i bashkive për ndërhyrjen në vend depozitime

Problematika:

- Problematikë e veçantë e këtij skenari janë rastet kur bashkitë, në pamundësi tjetër, kanë kërkuar Rehabilitim të vend depozitimeve brenda zonave të mbrojtura apo brezit bregdetar. Pra, vazhdim të përdorimit të këtyre infrastrukture edhe për një afat 3-5 vjeçar, deri në një zgjidhje adekuate në përputhje me Planet Kombëtare të Menaxhimit Mbetjeve.

Në vijim jepet harta skematike për këtë skenar.




Fig. 6.6 Harta skematike për Skenarin 3

7. Vend-depozitimet në nivel Qarku

7.1. Hyrje

Bazuar në Ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”²⁸, njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë Bashkitë dhe Qarqet. Sipas dispozitave të këtij ligji, Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore dhe përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh. Ndërsa Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore dhe përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut/bashkisë, shtrirja territoriale dhe emri dhe përcaktohen me ligj²⁹.




Fig. 7.1 Harta e qarqeve të Shqipërisë (sipas Ligjit Nr. 115/2014)

²⁸ Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, miratuar


²⁹ Ligj Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

Bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT, nga përlogaritjet e popullsisë në 1 Janar 2018 rezulton se vetëm tri qarqe të vendit shënuan një rritje të popullsisë krahasuar me një vit më parë, ndërsa nëntë prej tyre shënuan një rënie të saj. Rritja më e madhe u vu re në Tiranë (+25,1 për 1000 banorë), duke u pasuar nga Durrësi (+16,9 për 1000 banorë) dhe Vlora (+2,15 për 1000 banorë).

Uljet më të mëdha të popullsisë u vunë re në Gjirokastrë (– 45,3 për 1000 banorë), Dibër (–36,6 për 1000 banorë) dhe Berat (– 34,2 për 1000 banorë).

Tabela 7-1 Popullsia sipas Qarqeve (burimi INSTAT 2018)

Nr.	Qarku	Popullsia
1	Berat	127431
2	Dibër	120978
3	Durrës	289628
4	Elbasan	278547
5	Fier	298144
6	Gjirokastrë	62952
7	Korçë	210178
8	Kukës	77394
9	Lezhë	126800
10	Shkodër	204994
11	Tiranë	883996
12	Vlorë	189282
TOTAL		2870324



Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (2011)³⁰, territori i vendit është ndarë në 12 Zona Mbetjesh bazuar në kufijtë gjeografikë të qarqeve ekzistuese. Sqarojmë që pavarësisht miratimit të RAT në korrik 2014 kufijtë e qarqeve nuk kanë ndryshuar dhe si rrjedhim dhe Zonat e Mbetjeve bazohen në hartën e qarqeve. Bazuar në këto Zona Mbetjesh dhe duke pranuar nevojën për të marrë plotësisht në konsideratë kushtet dhe rrethanat lokale, duhej praktikisht të identifikoheshin zgjidhjet më të mira për menaxhimin e mbetjeve në të gjithë vendin.

7.2. Gjendja e vend-depozitimeve për secilin Qark

Në këtë kapitull, në vijim, jepet një përshkrim i përgjithshëm i sistemit të menaxhimit të mbetjeve për secilin Qark. Informacioni i paraqitur është një sintezë e të dhënave të grumbulluara nga Grupet e Punës në nivel lokal të plotësuara këto edhe me komentet,

³⁰ Miratuar me VKM Nr.175, datë 19.1.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"

korrigjimet dhe kostimin e masave për zbutjen e riskut mjedisor nga kompania konsulente e angazhuar për validimin e procesit.

Për të dhënë një kuadër sa më të qartë të situatës ekzistuese në secilin Qark, këtu jepet informacion edhe për impiantet sanitare të trajtimit të mbetjeve, të ndërtuara vitet e fundit. Sqarojmë që këto infrastruktura të menaxhimit të mbetjeve nuk kanë qenë subjekt i të dhënave të grumbulluara nga grupet lokale, pasi pavarësisht problematikave që shfaqin në disa raste ato mbeten vend-depozitime legale të ndërtuara sipas standardeve që parashikon kuadri ligjor në fuqi.

Në tabelat përmbledhëse për secilin Qark, jepen 4 të dhëna kryesore

- Bashkia ku ndodhet vend-depozitimi;
- Emërtimi i vend-depozitimit;
- Ndërhyrja e propozuar;
- Kosto e ndërhyrjes.

Sa i takon, *emërtimit të vend-depozitimit* është ruajtur ai që kanë referuar Grupet e Punës në nivel lokal me qëllim shmangien e keqkuptimeve duke konsideruar këtu grupet e ndryshme të ekspertizës të përfshirë në proces (koordinatorët e Prefekturave, koordinatorët e MTM, ekspertiza e dldp, etj.).

Gjithashtu, *ndërhyrja e propozuar* (rehabilitim, largim apo mbyllje vend-depozitimi), është konsideruar ajo e propozuar nga bashkia.

Në lidhje me *Koston e ndërhyrjes* sqarojmë sa më poshtë vijon:

- Në rastet kur Grupi i Punës në nivel lokal ka hartuar plan ndërhyrje dhe ka marrë në konsideratë të gjithë masat e referuara sipas Metodologjisë, vlera e referuar është ajo që kanë sjellë Grupet e Punës (rasti kur Grupet e Punës kanë patur ekspertizën dhe kanë kuptuar plotësisht Metodologjinë për Zbutjen e Riskut në Vend-depozitime).
- Në rastet kur Grupi i Punës në nivel lokal nuk ka hartuar plan masash apo ka parashikuar vetëm disa masa teknike (p.sh. vetëm rrethim të vend-depozitimit), atëherë vlera e referuar është bazuar në Preventivin e hartuar nga grupi i ekspertëve të angazhuar nga dldp.
- Në rastet kur ekspertiza të ndryshme të mbështetura nga donatorë të huaj (GIZ, Eptisa) kanë parashikuar plane specifike për vend-depozitime të caktuara, referuar në tabelat përmbledhëse janë vlerat e parashikuara nga preventivat e hartuara nga këto ekspertë. Me qëllim unifikimin masave ndërhyrëse dhe përlllogaritjen respektive të kostove sipas Metodologjisë së pranuar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka udhëhequr një proces koordinimi me gjithë aktorët e përfshirë në proces.

Gjithashtu sa i takon procesit të kostimit të masave ndërhyrëse për zbutjen e riskut duhet patur parasysh që:

- Kostimi është bërë duke u bazuar në manualët e çmimeve (viti 2015), të miratuara me VKM Nr. 629, dt. 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
- Çmimet e referuara në tabelat përmbledhëse për secilin Qark kanë të përfshirë edhe TVSH pasi modeli standard i hartimit të preventivave e parashikon këtë.
- Sa i takon llogaritjes së volumeve dhe pastaj kostimit të tyre, kompania konsulentë e angazhuar nga dldp nuk ka ndryshuar asgjë në rastet kur Grupi i Punës në nivel lokal ka bërë matje dhe mbi bazën e tyre ka hartuar preventivin e saktë.
- Në rastet kur Plani i Masave dhe kostimi kanë qenë të pjesshëm apo kanë munguar fare, kompania konsulentë e angazhuar nga dldp i ka hartuar ato duke u bazuar dokumente bashkëlidhur raportit që jepnin përafërsisht sipërfaqen apo volumen e mbetjeve në vend-depozitim (certifikata pronësie, skica shoqëruese të vendimeve të Këshillave Bashkia apo Këshillave të Qarkut, etj.). Me qëllim përcaktimin e një koeficienti që konsideron gjendjen sa më afër faktikes në llogaritjen e volumeve, në të gjitha rastet ky proces është verifikuar përmes fotove ajrore të disponueshme në GeoPortal të ASIG³¹ apo në platforma të tjera me ortofoto të fundit.
- Rastet më problematike në saktësinë e llogaritjes së volumeve ngelen vend-depozitimet në afërsi të lumenjve pasi shpesh herë rezulton që volumi i mbetjeve zvogëlohet ndjeshëm gjatë stinës së dimrit, kur prurjet janë të furishme dhe rriten në stinët e thata kur disa niveli i lumenjve bie. Në disa raste kjo shihet qartësisht edhe përmes ortofotove në kohë të ndryshme.

Në tabelat përmbledhëse në nivel Qarku janë përfshirë edhe vend-depozitimet e referuara në platformën e hartuar nga ish-MZHU (aktualisht administrohet nga MIE), por që nuk referohen nga Grupet e Punës në nivel lokal.

³¹ <https://geoportal.asig.gov.al/>

7.3. Qarku Shkodër

Në Qarkun Shkodër ndodhet landfilli sanitar i Bushatit i miratuar me Vendim të KRRTRSH Nr. 3, dt. 22.05.2007 “Për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit për objektin “Vend depozitimi rajonal të mbetjeve urbane, në komunën Bushat, Shkodër””. Bazuar në parametrat teknik të projektit, ky landfill:

- Shërben për një popullsi rreth 200.000 banorë (duke mbuluar nevojat e Qarqeve Shkodër dhe Lezhë).
- Periudha e shërbimit të landfillit është 20 vjet.
- Sasia mesatare e mbeturinave që depozitohen në këtë landfillit është 130 ton/ditë.



Fig. 7.2 Pamje e landfillit të Bushatit

Ndonëse impianti i trajtimit të mbetjeve në Bushatit ka infrastrukturën për ndarjen e mbetjeve të riciklueshme, në fakt në landfill ndodh vetëm procesi i depozitimit dhe ngjeshjes së mbetjeve. Sistemi i kullimit të ujërave të shiut mbledh ujërat sipërfaqësorë dhe i devijon ato nga vend-depozitimi, por impianti i pastrimit të tyre nuk funksionon. Si pasojë leksiviatet derdhen herë pas here në sistemin e gropave septike duke krijuar një rrezik potencial për mjedisin. Landfilli aktualisht ka hyrë në zonën e maturimit të sasisë të gazit të metanit (CH_4), i cili ka filluar të kapet nga dy puse dhe më pas realizohet djegia në natyrë.

Aktualisht, në landfillin rajonal të Bushatit depozitojnë mbetjet urbane vetëm bashkia Shkodër dhe Vau-Dejës, ndërsa bashkitë e tjera: Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë Arrës, vazhdojnë të përdorin vend-depozitime ilegale.

Problematika kryesore që shfaqin organet drejtuese të bashkive që nuk depozitojnë mbetjet në landfillin e Bushatit është mbulimi i kostos së transportit. Duke konsideruar rrjetin aktual të infrastrukturës rrugore rezulton që distanca e qyteteve qendër të bashkive Malësi e Madhe, Pukë dhe Fushë Arrës nga landfilli janë:

Tabela 7-2 Distanca nga landfill i Bushatit

Bashkia	Qyteti qendër	Distanca nga Landfill Bushat	Distanca nga Vend-depozitimi që përdorin
Malësi e Madhe	Koplik	35.4 km	2.5 km
Pukë	Pukë	52.5 km	4.0 km
Fushë Arrës	Fushë Arrës	74.2 km	5.0 km

Në vijim jepet një përshkrim i përgjithshëm i menaxhimit të mbetjeve për secilën nga bashkitë e Qarkut Shkodër.

Bashkia Shkodër: grumbullon përafërsisht 32 018 ton/vit³² mbetje urbane të cilat depozitohen në landfillin e Bushatit. Nga kjo sasi mbetjesh, rreth 28000 ton mbledhen vetëm në qytetin e Shkodrës që është edhe qendra kryesore urbane e bashkisë (rreth 60% e popullsisë të bashkisë është e përqendruar në qytet). Bazuar në të dhënat e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, Bashkia Shkodër, 2017-2022 (hartuar me asistencën e dldp) rezulton që performancën më të mirë në mbulimin me shërbim e kemi në qytetin e Shkodrës, duke mbuluar 90% të zonës me shërbim Ndërsa njësitë e tjera administrative kanë një mbulim mesatar të territorit me shërbim që varion nga 50-70%. Problemi kryesor ngelen Njësitë Administrative Shalë, Pult dhe Shosh ku si rezultat i distancave të mëdha dhe i kushteve të infrastrukturës rrugore nuk mbulohen me shërbim.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës:

Fusha e vjetër e mbetjeve të qytetit të Shkodrës, pranë Varrezave të Dëshmorëve, ka disa vite që nuk përdoret më, por kushtet e saja mjedisore nuk janë aspak të mira. Afërsia me zonën e banuar të qytetit por njëkohësisht edhe lumin Kir përbëjnë një rrezik të lartë mjedisor. Që në vitin 2009, Bashkia Shkodër e asistuar nga një konsulencë e huaj ka hartuar Projektin për bonifikimin dhe mbylljen e këtij vend-depozitimi por akoma ky projekt mbetet i pa financuar. Sipas preventivit të dorëzuar së bashku me projektin e zbatimit vlera e punimeve rezulton 227 075 285 ALL. Kjo vlerë rritet kryesisht nga masat speciale inxhinerike të parashikuara për parandalimin e ndotjes të lumit Kir.

Vlera e referuar në Tabela 7-3, për këtë vend-depozitim është disa herë më e vogël pasi janë parashikuar vetëm masat e Metodologjisë për Zbutjen e Riskut në Vend-depozitime.

Të gjitha vend-depozitimet e tjera të referuara janë kryesisht pika të vogla hedhje mbeturinash që kanë shërbyer për komunitete të caktuara, kryesisht periferike të qytetit Shkodër.

³² Sasia e mbetjeve referohet të dhënave për vitin 2016




Fig. 7.3 Vend-depozitimet e referuara nga Grupi i Punës për bashkinë Shkodër

Bashkia Malësi e Madhe: Mbetjet urbane që gjenerohen në bashkinë Malësi e Madhe transferohen në vend-depozitim të improvizuar në Badër të Mehajve, i cili ka një sipërfaqe përafërsisht 4 ha. Përveç Njesisë Administrative Kelmend, të gjitha Nj.A. të tjera (Koplik, Kastrat, Gruemirë, Qendër dhe Shkrel) depozitojnë mbetje në këtë vend-depozitim.

Mbetjet aty hidhen në mënyrë të çrregullt dhe pa asnjë kriter operimi për mirëmbajtjen e këtij vend-depozitimit. Mungesa e rrethimit bën që kafshë shtëpiake apo në disa raste edhe persona të pa-autorizuar aksesojnë mbetjet. Konstatohet prezenca e zjarreve sporadike dhe shpesh herë mbetjet të zhvendosen nga erërat.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës:

Siç konstatohet edhe në Tabela 7-3, për bashkinë Malësi e Madhe janë referuar 5 vend-depozitime, nga të cilat, vetëm për atë të Badër të Mehaj (që përdoret aktualisht nga bashkia) kërkohet rehabilitim. Vend-depozitimet e tjera (4 pika grumbullimi) janë aktualisht të

braktisura pavarësisht se aty mund të ketë hedhje sporadike të mbetjeve. Për këto pika, bashkia Malësi e Madhe kërkon të mbyllet sipas standardit të përcaktuar në Metodologjinë për Zbutjen e Riskut në Vend-depozitime.

Kostimi i ndërhyrjeve është bërë nga konsulenca (stafi i ekspertëve) të angazhuar nga dldp për këtë qëllim.

Bashkia Pukë: Mbetjet që gjenerohen në territorin e bashkisë depozitohen në vend-depozitim në Fushë Qarrit. Ky vend-depozitim është rehabilituar në vitin 2017 me mbështetjen teknike dhe financiare të dldp. Ndërhyrja ka konsistuar në disa masa rehabilituese që përputhen plotësisht me Metodologjinë për Zbutjen e Riskut në Vend-depozitime.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës:

Për bashkinë Pukë është referuar vetëm një vend-depozitim në Rras, Nj.A. Gjegan. Ky vend-depozitim i shërben kryesisht Nj.A. Gjegan dhe fshatrave përreth. Rehabilitimi, është gjykuar nga bashkia, si masa e nevojshme që duhet ndërmarrë pasi mbetjet në këtë vend-depozitim hidhen pa kriter dhe distanca me vend depozitim në Fushë-Qarrit është mjaft e largët.

Bashkia Fushë Arrës: Mbetjet që gjenerohen në territorin e bashkisë depozitohen në vend-depozitim tek Kthesa e Krrabit ndodhet në largësi 5 km nga qyteti i Fushe Arrësit, në të majte të segmentit rrugor Fushë-Arrëz- Krrab. Ky vend-depozitim përdoret që nga viti 2005 dhe aty depozitohen kryesisht qyteti Fushë Arrës dhe Njësia Administrative e Qaf-Malit

Qyteti Fushë Arrës ka një distance afërsisht 75 km nga landfilli i Bushatit, faktor ky që ndikon në koston mjaft të lartë (të papërbalueshme) për depozitim në mbetjeve atje.

Vend-depozitimi tek Kthesa e Krrabit aktualisht është jashtë standardeve minimale të kërkuara (teknike dhe ligjore) dhe nevoja për ndërhyrje është emergjente. Për të kuptuar situatën ekzistuese në këtë vend-depozitim përveç të tjerave mungon edhe rrethimi, duke e bërë të aksesueshëm si për kalimtarë të rastit ashtu edhe për kafshët që kalojnë aty. Aktualisht mungon çdo infrastrukturë për trajtimin e ujërave sipërfaqësor dhe leksiviateve dhe mungesa e tyre ka ndikim të lartë në ujërat e lumit Fan i Madh. Parashikuar nga grupi i punës është edhe prerja e shkurreve në afërsi të vend-depozitimit pasi shpesh herë gjatë stinës së verës zjarret sporadike rrezikojnë pyllin që rrethon vend-depozitim.

Sqarojmë që ky vend-depozitim është trajtuar edhe në studimin e hartuar nga Eptisa pasi bashkia Fushë Arrës është brenda zonës së studiuar. Sipas këtij studimi vend-depozitimi tek Kthesa e Krrabit është parashikuar që të mbyllet duke konsideruar kushtet në të cilat operohet aty por njëkohësisht edhe pozicionimin thuajse mes të pyllit.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës:

Duke konsideruar kriteret e Metodologjisë, bashkia Fushë Arrës kërkon rehabilitimin e këtij vend-depozitimi për t'u përdorur për 3-5 vitet e ardhshme, deri në ndërtimin e një infrastrukture të re që zgjidh problemet e bashkisë sa i përket depozitimit të mbetjeve.

Bashkia Vau Dejës: aktualisht depoziton mbetjet në landfillin e Bushatit. Mbulimi me shërbim realizohet kryesisht në Nj.A. Vau Dejës dhe Bushat dhe pjesërisht në NJ.A. Vig-Mnelë dhe Hajmel. Pavarësisht numrit të vogël të banorëve në Nj.A. Shllak dhe Temal dhe sasisë së mbetjeve që gjenerohen në këto njësi administrative, mbulimi me shërbim është thuajse i pamundur si rezultat i infrastrukurës rrugore mjaft të papërshtatshme. (Rruga që lidh Vau-Dejës me këto Njësi Administrative kalon nga bashkia Shkodër).

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës:

Nuk referohet asnjë vend-depozitim ilegal nga Grupi i Punës në nivel lokal për t'u marrë në konsideratë nga Nisma për Zbutjen e Riskut në Vend-depozitime..

Tabela 7-3 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Shkodër

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	FUSHË ARRËS	Kthesa e Krrabit	Rehabilitim	3,816,908
2	MALËSI E MADHE	Vend-depozitimi Nr.2 Koplik	Largim	4,728,880
3		Vend-depozitimi Nr.3 Koplik	Largim	1,161,472
4		Badër të Mehajve	Rehabilitim	15,075,641
5		VD Ish Komuna Shkrel	Largim	1,024,758
6		Mbetje Inerte Omaraj,Vrake	Largim	57,317
7	PUKË	Fushë Qarri	I Rehabilituar	
8		Rras Gjegjan	Rehabilitim	1,132,348
9	SHKODËR	Hyrja e rrugës Alibegaj	Largim	333,005
10		Fusha anës Urës së vjetër të Bunës	Largim	650,026
11		Oblikë	Largim	128,849
12		Ura e telit	Largim	465,402
13		Ura e Mesit	Largim	632,623
14		Ish-VD tek varrezat e dëshmoreve	Mbyllje	16,269,852
15		Bregu i lumit Kir	Largim	186,412
16		Ish fusha e aviacionit	Largim	598,044
17		Ura e Bardhajve	Largim	188,755
18		Hidrovorit Vilu	Largim	567,680
19		Suka Pulaj	Mbyllje	4,519,856
20	VAU DEJËS	Landfill i Bushatit		
Total kosto për Qarkun Shkodër				51,537,828




Fig. 7.4 Vend-depozitimet në Qarkun Shkodër

7.4. Qarku Kukës

Qarku Kukës përbëhet nga 3 bashki (Kukës, Tropojë dhe Has) dhe shtrihet në pjesën malore veri-lindore të Shqipërisë. Pavarësisht ndërtimit të Rrugës së Kombit që lidh Kukësin dhe zonat përreth me pjesën qendrore të vendit, mobiliteti brenda qarkut mbetet i vështirë pavarësisht disa investimeve të bëra në infrastrukturën rrugore vitet e fundit. Kjo lidhet kryesisht me terrenin e thyer malor që dikton rrugë të gjata dhe plot serpentina.

Aktualisht në qarkun Kukës nuk kemi asnjë landfill sanitar të kontrolluar apo impiant trajtimi të mbetjeve. Depozitimi i mbetjeve në qendrat kryesore urbane, si Kukësi, Tropoja apo Hasi, bëhet në vend-depozitime të karakterit lokal, në një distancë 2-5 km nga qendra e qytetit. Përsa i përket zonave rurale, nuk ka të dhëna të qarta. Në disa fshatra vazhdon të përdoret metoda tradicionale e kompostimit dhe groposjes së mbetjeve në gropa familjare apo grup familjesh. Mangësitë në këtë shërbim kanë efekte negative shumë dimensionale. Nga një anë, këto efekte cenojnë shëndetin e banorëve dhe cilësinë e jetës dhe, nga ana tjetër, kanë një efekt negativ edhe në zhvillimin ekonomik të këtij territori, që gjenerator kryesor të rimëkëmbjes ekonomike ka turizmin.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës në nivel lokal:

Të dhënat nga Grupet e Punës në nivel lokal përputhen me propozimet e Projektit “Asistencë Teknike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në dy Bashki të Shqipërisë”³³, si dhe në mbështetje të hartimit të Planit Rajonal dhe Studimit të Fizibilitetit për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Rajonin Verilindor të vendit. Bazuar në këtë vlerësim të detajuar të gjendjes ekzistuese të vend-depozitimeve në rajonin veri-lindor të vendit, janë përgatitur dhe Planet e Masave (projektet) dhe preventivat respektiv.

Vendim-marrja dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve për mbylljen, rehabilitimin apo largimin e mbetjeve nga vend-depozitimet është një proces i rëndësishëm që lidhet ngushtësisht me ndjeshmërinë dhe ndikimin në mjedis, si dhe kushtet e sigurisë shëndetësore për popullsinë dhe aspekte të tjera të rëndësishme jetësore.

Bashkia Kukës aktualisht ka dy vend-depozitime kryesore:.

- Vend-depozitimi për mbetjet urbane në Myç-Mamëz të Komunës Kolsh, Kukës
- Vend-depozitimi për mbetjet inerte në Kukës (Bregu mbi Bozhë)

Mbetjet në vend-depozitim në Myç-Mamëz hidhen në mjedis të hapur dhe aty mungon një trajtim të specializuar. Ato në mënyrë periodike mbulohen me dhë, dhe braktisen, duke sjellë dekompozimin anaerobik të mbetjeve, gjë që sjell gjenerimin e gazit metan, dhe elementëve të tjerë ndotës të mjedisit.

³³ TA for Integrated Solid Waste Management System for two Selected Municipalities of Albania - EuropeAid/138181/DH/SER/AL, hartuar nga Eptisa.

Sheshi i këtij Vend-depozitimi është i vendosur në një pllajë, ka një sipërfaqe prej 1.1 ha si dhe një thellësi mesatare prej 5m dhe volumi teorik është afro 50 000m³. Fusha është shfrytëzuar prej afro 9 vitesh ku janë depozituar një volum rreth 30 000 m³ mbetje urbane.

Vend depozitimi i mbetjeve inerte i Bregut mbi Bozhë përdoret nga viti 2009 dhe ndodhet rreth 1.2 km larg nga qendra e qytetit të Kukësit dhe në një largësi rreth 6 km nga vend depozitimi i mbetjeve urbane të Myç Mamëzit. Vend-depozitimi ndodhet në një distancë, në vijë ajrore, prej 300 nga monumenti natyror “Kodër Lume” dhe rreth 150m nga Liqeni i Fierzës, bregu i të cilit është shpallur zone me përparësi zhvillimin e turizmit sipas me VKM nr. 88 datë 01/03/1993 “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”, i ndryshuar.

Siç konstatohet edhe tek Tabela 7-4 në vijim, Vend-depozitimi Myç Mamëz parashikohet të rehabilitohet ndërsa ai tek Bregu mbi Bozhë të mbyllet. Këto propozime vijnë në përputhje edhe me Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, 2016 – 2020, për bashkinë Kukës³⁴.



Fig. 7.5 Pamje nga vend-depozitimi Bregu mbi Bozhë për mbetjet inerte në Kukës

Bashkia Tropojë referon 2 pikë-grumbullime kryesore që mund të trajtohen përmes nismës “Për zbutjen e Riskut në Vend-depozitime”. Ato janë:

- Vend-depozitimi në Koj
- Vend-depozitimi në Fierzë

³⁴ “PMIM 2016-2020, për bashkinë Kukës” u financua në kuadër të projektit IPA Cross Border Cooperation Shqipëri – Kosove “Mbrojtja Mjedisore dhe Menaxhimi i Mbetjeve”.

Vend-depozitimi i mbetjeve urbane në Koj ndodhet në pjesën lindore të qytetit të Bajram Currit, në vendin e quajtur Përroi i Kojës, në një distancë rreth 2 km nga qendra e qytetit. Ky vend-depozitim ndodhet në një distancë rreth 300m nga zona e banuar dhe po aq nga rruga nacionale. Pranë tij ndodhet një ish gurore (tashmë e braktisur) si dhe një fushë për ruajtjen dhe shitjen e drurëve.

Pavarësisht se ky vend-depozitim është ndërtuar bazuar në Vendim të KRRTRSH Nr.6, dt. 17.01.2008 “Për miratimin e studimit urbanistik pjesor, sheshit dhe lejes se ndërtimit për objektin: “Vend hedhje e mbetjeve urbane te qytetit Bajram Curri””, gjendja e tij aktualisht është mjaft e rënduar. Rrethimi është i dëmtuar dhe njëkohësisht mungesa totale e operimit sipas standardeve dhe hedhja e mbeturinave krejtësisht e pa kontrolluar shfaq risk jo vetëm për mjedisin por dhe për popullatën.

Vend- depozitimi në Fierzë është një pikë-grumbullim mbetjesh e përcaktuar me Vendim të Këshillit të ish-komunës Fierzë dhe është ndërtuar pa projekt dhe në mungesë të plotë të kushte minimale teknike.

Bashkia Has referon vetëm një vend-depozitim mbetjesh urbane që ndodhet ne vendin e quajtur Qafë Bajrak, rreth 500 m larg nga rruga Kukës- Krumë. Zona ku ndodhet VD është në formën e një pllaje që dikur ka qenë repart ushtarak. Zona përreth është e veshur me bimësi dhe shkurre.

Sipërfaqja e këtij vend-depozitimi është afro 6 000 m² ndërsa perimetri rreth 400m. Thellësia e trupit te mbetjeve gjykohet të jetë është afro 3-5m. Tabani formohet nga shkëmbinj ultra-bazikë të cilët nuk paraqesin ndonjë problem gjeoteknik për shkak te fortësisë, por kullimet nga dekompozimi i mbetjeve infiltrojnë direkt drejt thellësisë së tokës përmes sistemit te zhvilluar te çarjeve. Struktura e mbetjeve urbane është e përzier dhe në vend-depozitim mungon një menaxhim ditor dhe periodik. Volumi i vlerësuar i mbetjeve ekzistuese është afro 12 000-15 000 m³. Në afërsi të vend-depozitimit nuk ka trupa ujqor sipërfaqësor dhe nuk evidentohet ndonjë aktivitet bujqësor apo blegtoral në një distancë të paktën rreth 1 km.

Tabela 7-4 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Kukës

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	HAS	1-Has	Rehabilitim	8 813 543
2	KUKËS	Myç, Mamëz	Rehabilitim	8 832 788
3		Bregu mbi Bozhë	Mbyllje	10 668 262
4	TROPOJË	1-Koj	Rehabilitim	12 383 396
5		2-Fierzë	Largim	1 004 331
6		Lekbibaj	Largim	285 926
Total kosto për Qarkun Kukës				41 988 246

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN KUKËS




Fig. 7.6 Vend-depozitimet në Qarkun Kukës

7.5. Qarku Lezhë

Menaxhimi i mbetjeve në 3 Njësitë Vendore të qarkut Lezhë është në nivel të pranueshëm duke patur parasysh që bashkia Lezhë depoziton në Landfillin e Bushatit ndërsa bashkia Mirditë ka përfituar nga ndërtimi i HEC në Ulëz për zhvendosjen e vend-depozitimit ekzistues dhe ndërtimin e një landfilli sanitar jashtë zonës së përmytjes. Ky vend-depozitim, i referuar si Ndërfushas i Ri, ka mbaruar së ndërtuari në vitin 2017 dhe aktualisht aty depozitohen mbetjet për gjithë bashkinë Mirditë (ato që grumbullohen). Në të' janë zhvendosur (depozituar) edhe mbetjet nga vend-depozitimi i Cekajve, i cili është mbyllur dhe rehabilituar si zonë.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës në nivel lokal:

Bashkia Lezhë aktualisht depoziton mbetjet në Landfillin e Bushatit sipas një skeme të organizuar në 3 Zona Shërbimi të cilat janë të miratuara nga bashkia dhe njëkohësisht referohen edhe në Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia Lezhë 2017-2021³⁵.




Fig. 7.7 Zonat e shërbimit në bashkinë Lezhë (sipas PMIM 2017-2021)

I vetmi vend-depozitim që referohet për Rehabilitim është ai në Lagjen Nënë Tereza i cili parashikohet për një përdorim 3-5 vjeçar.

Në Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia Lezhë 2017-2021, vend-depozitimi në Lagjen Nënë Tereza shfaqet si një nga pikat kryesore të grumbullimit gjatë sezonit turistik.

³⁵ PMIM bashkia Lezhë 2017-2021, është mbështetur nga programi dldp dhe hartuar nga URI

Bashkia Mirditë referon 3 vend-depozitime të cilët paraqesin risk të lartë mjedisor dhe ku duhet ndërhyrë sa më shpejt. Risku kryesor është afërsia e këtyre vend-depozitime me trupat ujqor sipërfaqësor (Lumi Zmeja, Lumi Fan) por njëkohësisht edhe afërsia me zonat e banuara rrisin nivelin shqetësimit. Këto 3 vend-depozitime janë:

- VD Ndërfushas Ilegal: Ndodhet në afërsi të rrugës nacionale. Gjithashtu është i aksesueshëm lehtësisht banorët dhe kafshët shtëpiake. Ndodhet rreth 140 metra larg qendrave të banuara.
- VD Lumi Zmeja: Ky vend depozitim ndodhet pranë zonave të banuara dhe përgjatë bregut të lumit të Zmesë. Gjithashtu është i aksesueshëm lehtësisht nga syri i vizitorit. Ky vend-depozitim është kryesisht për mbetje inerte.
- VD Lumi Fan: Ky vend depozitim ndodhet pranë zonave të banuara dhe përgjatë bregut të lumit Fan. Gjithashtu është i aksesueshëm lehtësisht.

Sa i përket këtyre vend-depozitime, Grupi i Punës në nivel lokal arrin në përfundimin se opsioni më i mirë është largimi i mbetjeve përgjatë kësaj zone. Në Tabela 7-5, këto ndërhyrje janë paraqitur me vlerë të barabartë pasi Grupi i Punës ka përgatitur një preventiv të vetëm për largimin e mbetjeve nga këto 3 vend-depozitime. Vlera totale është shpërndarë në mënyrë uniforme për secilën ndërhyrje.

Bashkia Kurbin është shprehur vetëm për një vend-depozitim që ndodhet në Kodër Kolç. Sipas paraqitjes që vetë ekspertët e Grupit të Punës në nivel lokal bëjnë, ky vend depozitim has disa kritere përjashtuese ligjore të cilat të çojnë në konkluzionin e mbylljes, pavarësisht se nga pamundësia e depozitimit në një vend tjetër ato kërkojnë Rehabilitim vend-depozitimi për t'a shfrytëzuar edhe për një periudhë 3-5 vjeçare.

Pozicioni gjeografik i këtij vend-depozitimi, i vendosur në kodër, paraqet risk të konsiderueshëm si për ndotjen e ujërave sipërfaqësor ashtu edhe nën-tokësor. Gjithashtu bimësia e dendur që rrethon vend-depozitimin paraqet risk të lartë zjarresh kryesisht në stinën e verës.

Tabela 7-5 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Lezhë

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	KURBIN	Kodër Kolç	Rehabilitim	5 741 931
2	LEZHË	Lagja Nënë Tereza	Rehabilitim	889 924
3	MIRDITË	Vend-depozitim ilegal Ndërfushas	Largim	369 520
4		Lumi Zenja	Largim	369 520
5		Lumi Fan	Largim	369 520
6		Ndërfushas legal i vjetër	I mbyllur	
7		Ndërfushas legal i ri		
Total kosto për Qarkun Lezhë				7 740 415

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN LEZHË




Fig. 7.8 Vend-depozitimet në Qarkun Lezhë

7.6. Qarku Dibër

Në katër bashkitë (Dibër, Mat, Klos dhe Bulqizë) e Qarkut Dibër janë evidentuar disa vend-depozitime të cilat janë ndarë në dy kategori kryesore:

- Vend-depozitime që janë vendosur bazuar në akte administrative (leje etj.), pavarësisht gjendjes dhe operimit jashtë standardeve;
- Vend-depozitime krejtësisht ilegale

Vend-depozitime me vendime të miratuara:

1. Vend-depozitimi i qytetit Burrel, miratuar me Vendim të Këshillit të Rrethit Mat nr.6 datë 15.08.1997.
2. Bashkia Bulqizë me një vend-depozitim (Qafa e Buallit) dhe tre pika grumbullimi (Trebisht, Ostren dhe Krast). Miratuar me VKB Nr. 36, datë 07.07.2016 “Vend depozitimet e mbetjeve urbane”
3. Bashkia Dibër ka një vend-depozitim në Llasen, Peshkopi të miratuar me Vendim KRRTRSH nr.1, datë 21.05.2001 “Për sheshin e ndërtimit të fushës së depozitimit dhe përpunimit të mbeturinave urbane për qytetin e Peshkopisë”.
Rehabilitimi i këtij vend-depozitimi është bërë në vitin 2017 me mbështetjen e dldp. Ndërhyrjet janë bërë sipas një projekti teknik dhe preventivi të hartuar për këtë qëllim ku janë parashikuar disa nga masat më emergjente për zbutjen riskut mjedisor. Aktualisht vend-depozitimi i bashkisë Dibër mund të konsiderohet i kontrolluar dhe me operim aktiv. Ky VD i shërben një popullsie 30 000 banor, kryesisht të qytetit të Peshkopisë që duke përfshirë dhe zonën e Maqellarës (16 km). Ky vend-depozitim është në funksionim që nga viti 2003 dhe zë një sipërfaqe afro 8000 m². Sasia ditore e depozituar vlerësohet rreth 15 ton, sasia vjetore vlerësohet rreth 5400 ton. Struktura e mbetjeve të depozituara është mikse: bashkiake dhe pjesërisht mbetje inerte. Nuk bëhet seleksionim apo ndarje e llojit të mbetjeve në burim.

Të gjithë vend-depozitimet e mësipërme nuk janë pajisura me leje mjedisore.

Nga konstatimet në terren janë evidentuar edhe disa vend hedhje të paligjshme të cilat janë radhitur në vijim:

1. Vend depozitim jo funksional në Urën e Ulzës – Pikë turistike. Liqeni i Ulzës është në kategorinë: Rezervat Natyror i Menaxhuar Park Natyror. Vendimi me të cilën është shpallur është: V.K.Q Nr. 16, datë 03.04.2013.
2. Cërruj , vend-depozitim jofunksional por mjedis i përshtatshëm për vend hedhje.
3. Maqellarë, vend-depozitim në urrën e Pesjakës i paligjshëm dhe shumë me risk për popullatën.
4. Muhurr, vend-depozitim jo legal.
5. Rabdisht, vend depozitim jo legal.
6. Kastriot (Kuke + Gjeogjosh), vend depozitime jo legale me risqe për popullatën.




Fig. 7.9 Vendim i KRRTRSH Nr.1, datë 21.05.2001 për vend-depozitim të Peshkopisë

Sipas vendim-marrjes që vetë Grupet e Punës në nivel lokal kanë paraqitur, disa nga vend-depozitimet duhet të largohen pasi janë shumë afër zonës së banimit (Ura e Pesjakës) apo (Ulza) që është në zonë të mbrojtur dhe ka ndikim negativ në turizëm.

Për disa nga ndërhyrjet e propozuara është konsideruar dhe raporti i Eptisës pasi përfshin bashkitë e Qarkut Dibër, pavarësisht se vlen të theksohet që ka kontradikta mes vendim-marrjes së bashkive dhe këtij Raporti.

Në vijim, disa nga veçoritë e konstatuara për bashkitë e qarkut Dibër:

Bashkia Bulqizë është e vetmja në gjithë Shqipërinë që kërkon Rehabilitim të 3 vend-depozitimeve. Nga vlerësimi i Raportit të hartuar nga Grupi i Punës në nivel lokal por duke u bazuar edhe në diskutime teknike të drejtpërdrejta, konstatohet që ky propozim vjen duke marrë në konsideratë infrastrukturën rrugore mjaft të rënduar dhe distancat e zonave të banuara. Gjithashtu bazuar edhe në VKB të bashkisë Bulqizë Nr. 36, datë 07.07.2016 "Vend-depozitimet e mbetjeve urbane", mund të konkludojmë që kjo bashki i vlerëson 3 vend-

depozitimet si një infrastrukturë e vetme, por të ndara në territor, për menaxhimin e mbetjeve.

Bashkia Dibër kërkon largim të mbetjeve në 4 vend-depozitime të evidentuara duke nënkuptuar përdorimin e atij të rehabilituar së fundmi, në Llasen, pranë qytetit të Peshkopisë.

Bashkia Klos referon për Rehabilitim një vend-depozitim që aktualisht është i braktisur. Kjo pasi ka disa vite që kjo bashki, bazuar në një kontratë ndër-vendore, dërgon mbetjet në vend-depozitim të Burrelit (bashkisë Mat). Qëllimi i kërkesës për rehabilitim, është afërsia që ka ky vend-depozitim me qytetin e Klosit dhe kosto relativisht e lartë që bashkia paguan aktualisht për transportin e mbetjeve. Kujtojmë këtu që sipas Raportit të Eptisë, ky vend-depozitim referohet për mbyllje finale (kapsulim) dhe rregullim të terrenit ku ndodhet.

Bashkia Mat ka referuar 2 vend-depozitime në këtë platformë, nga të cilët njëri është për Rehabilitim (Fusha e grumbullimit e qytetit Burrel) ndërsa tjetri është për mbyllje (Ura e Ulzës).

Gjendja e vend-depozitimit pranë qytetit të Burrelit është në kushte relativisht të përshtatshme dhe nuk paraqet riske për popullatën. Atje aktualisht depozitohen mbetje urbane dhe inerte. Ky vend-depozitim është miratuar me Vendim të Këshillit të Rrethit Mat nr.6 datë 15.08.1997, por nuk është i pajisur me leje mjedisore.

Vend-depozitimi tek Ura e Ulzës referohet për duke konsideruar afërsinë që ka me bregun e liqenit dhe ndikimin negativ mjedisor dhe turistik që mbart.

Tabela 7-6 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Dibër

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	BULQIZË	Qafa e Buallit	Rehabilitim	9 008 431
2		Ostren	Rehabilitim	1 409 684
3		Krastë	Rehabilitim	5 122 142
4	DIBËR	Ura Pesjakës, Maqellarë	Largim	9 939 134
5		Llasen, Peshkopi	I Rehabilituar	
6		Muhurr	Largim	136 368
7		Rabdisht	Largim	675 382
8		Përroi Gjelagjosh, Kastriot	Largim	191 276
9		Kastriot, Kukë	Largim	459 382
10	KLOS	Cërruj (Kthesa e Patinës)	Rehabilitim	2 492 434
11	MAT	Fusha e grumbullimit e qytetit Burrel	Rehabilitim	4 350 804
12		Ura e Ulzës	Mbyllje	1 092 828
Total kosto për Qarkun Dibër				34 877 865

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN DIBËR




Fig. 7.10 Vend-depozitimet në Qarkun Dibër

7.7. Qarku Durrës

Qarku i Durrësit, duke konsideruar densitetin e lartë të popullsisë dhe aspekte të tjera si vlerat turistike dhe rolin e nyjës infrastrukturore kombëtare, paraqitet si një nga zonat më problematike mjedisore në gjithë Shqipërinë. Të gjithë vend-depozitimet që përdoren aktualisht janë jashtë standardeve dhe sasia e mbetjeve shpesh herë kalon kapacitetet për të cilat janë parashikuar.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës në nivel lokal:

Bashkia Durrës referon katër vend-depozitime kryesore brenda territorit administrativ, në të cilat depozitohet e gjithë sasia e mbetjeve bashkiake të pa ndara. Në disa raste aty depozitohen dhe mbetje të rrezikshme, mbetje spitalore dhe mbetje industriale së bashku me mbetjet inerte, duke mos ndjekur asnjë standard mjedisor. Në vijim jepen disa të dhëna kryesore për këto vend-depozitime:

Vend-depozitimi në Porto Romano është miratuar me vendim të Këshillit të Qarkut Durrës me nr. 1, datë 14. 09. 1998 duke përcaktuar për sheshin e vend depozitimit një sipërfaqe 5000m². Duke qenë se sipërfaqja totale (e parcelës) e disponueshme është 222 000 m², aktualisht rreth 80 000 m² janë të zëna nga mbetjet urbane. Ky vend-depozitim operohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës që ka të angazhuar 5 punëtorë aty. Ato kryesisht merren me sistemin e mbetjeve me një buldozer dhe kompaktor për ngjeshjen e tyre. Në hyrje mungon ura peshore, si rrjedhim operatori (NSHKD) mund vetëm të përlllogarisë saktësisht sasinë e mbetjeve të depozituara. Sipas të dhënave të ofruara nga NSHK Durrës, në vitin 2017, janë depozituar ose 110 000m³ mbetje që i korrespondojnë rreth 300 ton/ditë. Mbetjet që depozitohen aty grumbullohen nga Qyteti i Durrësit, zona e Plazhit në Durrës, Shkozeti dhe disa fshatra përreth.



Fig. 7.11 Pamje nga rruga hyrëse dhe gjendja e vend-depozitimit në Porto Romano

Pavarësisht se gjendja e vend-depozitimit në Porto Romano është jashtë çdo standardi mjedisor, bashkia Durrës ka konfirmuar nevojën për Rehabilitim të tij deri në gjetjen sa më të shpejtë të një zgjidhje afat-gjatë për menaxhimin e mbetjeve në nivel rajonal.

VD në Vadardhë, Sukth, është miratuar me vendim të Këshillit të ish- bashkia Sukth me nr. 32 datë 13. 12. 2013. Ky vend-depozitim funksionon si e tillë që nga viti 2015 dhe aty për afërsisht depozitohen rreth 15 000 m³ mbetje urbane ose 41 m³ për çdo ditë. VD nuk është e organizuar në parcela dhe mbetjet të llojeve të ndryshme, depozitohen në mjedis të hapur. Ajo pozicionohet në një zonë mjedisore sensitive dhe shumë pranë zonave të banuara. Vlerësimet gjeologjike tregojnë që terreni përbëhet nga argjila dhe balta, që kanë një përshkueshmëri të ulët. Mbetjet janë hedhur në një lartësi për afërsisht rreth 2-3 m. Ky VD është jashtë çdo standardi funksionimi dhe operimi.

VD në Grykë-Minierë, Manëz është vendi ku depozitohen mbetjet e kësaj njësie administrative. Miratuar nga ish Këshilli Bashkiak Manzës vend-depozitimi ka një sipërfaqe rreth 2778 m². Ky VD ka filluar të funksionojë si i tillë që nga viti 2001 dhe aktualisht depozitohen rreth 2310 m³ mbetje urbane në vit ose 6.5 m³ për çdo ditë. . Vend-hedhja nuk është e organizuar në parcela dhe mbetjet të llojeve të ndryshme, depozitohen në mënyrë të çrregullt. Nuk ka afërsi të zonave të banuara por shqetësimi kryesor është distanca rreth 150m larg Përroit të Shehut. Si rrjedhim, kërkohet një monitorim i herë pas hershëm nga institucionet përkatëse, për përcaktimin e shkallës së ndotjes.

VD në Fushë Biz, Ishëm është vendi ku depozitohen mbetjet e kësaj njësie administrative (Ishëm). Ky vend-depozitim është miratuar me Vendim Nr. 29 datë 22.09.2014 të ish Këshillit Bashkiak të Ishmit dhe ka një sipërfaqe rreth 2320 m². Në këtë VD depozitohen rreth 5 900 m³ mbetje urbane në vit ose 16 m³ për çdo ditë. VD është distant 400 m nga Liqeni Topanasë. Rrjeti i tubacionit të ujësjellës kanalizimeve UKD ndodhet në një distancë më të madhe se 800m. Duke qenë se zona është kodrinore, nuk ka rrezik për mbytje. Afërsia me zonat e banuara është 550 (konkretisht larg fshatit Biz).

Bashkia Krujë . Në një përmbledhje të shkurtër nga inspektimet e kryera në tre vend-depozitimet aktuale në territorin e Bashkisë Kruje gjendja e përgjithshme e tyre është si më poshte:

Vend-depozitimi 1 Kameronas: është i pozicionuar në një zonë që paraqet disa kritere përjashtuese ligjore, të cilat të çojnë në konkluzionin e mbylljes së tij. Ndër më kryesoret përmendim:

- afërsia me përroin e Bardharit i përdorshëm dhe për vaditje në zonat bujqësore ku kalon dhe rrezikun e depërtimit në ujërat nëntokësore të zonës;
- Pozicioni gjeografik në një reliev mbi liqenin e Dollakës, pa rrethim dhe në mungesë totale të trajtimit të ujerave sipërfaqësorë dhe liksivate, ky vend-depozitim ndot dukshëm liqenin poshtë tij, duke afektuar drejtpërdrejtë në florë dhe faunë të zonës;
- degradim të peizazhit natyror, vetëm 500m nga aksi rrugor F. Krujë-Krujë;
- Bimësia rreth vend-depozitim paraqet rrezik nga zjarret e qëllimshme apo rastësore;
- Sa i përket ndikimit negativ në turizmin e zonës përmendim që ky vend-depozitim është 2 km nga qyteti antik i Albanopolis dhe 5 km nga qyteti turistik i Krujës.

Aktualisht sipërfaqja e vend depozitimit është më e madhe nga ajo e miratuar nga Këshilli Bashkiak i ish bashkisë Fushë Krujë. Duke konsideruar gjithë aspektet e mësipërme, opsioni optimal është zhvendosja e mbetjeve, pavarësisht rrezikut që mbart si proces.

Vend-depozitimi 2 Krastë, ndodhet brenda ekonomisë pyjore Krastë-Krujë dhe paraqet një gjendje shume kritike mjedisore. Sasia e madhe e mbetjeve, terreni shumë i thyer, rreziku evident i zjarreve, afërsia me zonat e banuar (200m larg ndodhet një biznes fason, 250m larg ndodhen varrezat e qytetit të Krujës), afërsia e rrugës nacionale F. Krujë-Krujë dhe impakti negativ për sytë e turistëve që vizitojnë zonën çojnë në konkluzionin e mbylljes së këtij vend-depozitimi. Ndërhyrje optimale vlerësohet largimi i mbetjeve.

Vend-depozitimi 3 Dukagjin, Thumanë, nga verifikimi i grupit të punës në terren nuk paraqet kriteret të dukshme përjashtuese të përcaktuara nga kuadri ligjor. Problemi kryesor është afërsia me një kanal parësor kullues i cili shkarkon në lumin Ishëm. Forma e vend-depozitimit është drejtkëndore me një sipërfaqe rreth 9800m². Nga konkluzionet e nxjerra nga grupi i punës në nivel lokal, arrihet në përfundimin se ky vend-depozitim paraqet impakte të lehta mjedisore pavarësisht se është totalisht ilegal dhe nuk disponohet asnjë akt miratimi nga Bashkia Krujë apo administrata të mëparshme që kanë mbuluar administrativisht këtë territor.

Propozimi optimal për masat që duhen marrë për këtë vend-depozitim është mbyllja dhe heqja e mbetjeve. Në rast të kundërt në një plan të dytë propozohet ngritja e një muri rrethues përreth zonës dhe taposja apo kapsulimi i mbetjeve urbane.

Bashkia Shijak nuk ka referuar asnjë vend-depozitim për t'u përfshirë në Nismën për Zbutjen e Riskut, kjo pasi aktualisht kjo bashki depoziton mbetjet në VD të Porto Romanos. Pavarësisht kësaj, në platformë është përfshirë vend-depozitimi i vjetër, i abandonuar, por që referohet në hartën e vend-depozitimeve të ish MZHU-së.

Tabela 7-7 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Durrës

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	DURRËS	04. Porto Romano	Rehabilitim	42,463,002
2		05. Vadardhë, Sukth	Mbyllje	29,787,960
3		06. Gryk – Minierë, Manzë	Mbyllje	5,014,592
4		07. Fushë Biz, Ishëm	Mbyllje	2,105,157
5		Ishëm - MZHU	Mbyllje	2,155,012
6	KRUJË	01. Kameron Njësia F. Krujë	Mbyllje	2,824,004
7		02. Kraste	Mbyllje	4,293,551
8		03. Dukagjin Njësia Thumanë	Rehabilitim	10,464,912
9	SHIJAK	Shijak MZHU	Largim	2,851,866
Total kosto për Qarkun Durrës				101 960 056

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN DURRËS




Fig. 7.12 Vend-depozitimet në Qarkun Durrës

7.8. Qarku Tiranë

Infrastruktura e vetme e menaxhimit të mbetjeve në Qarkun e Tiranës është landfilli i Sharrës, i pozicionuar në fshatin Sharrë, rreth 7 km larg qendrës së qytetit Tiranë. Sipas të dhënave nga zyrtare nga Bashkia Tiranë, totali i mbetjeve të depozituara në landfill për vitin 2017 është 224 864 Ton.

Deri në fund të vitit 2017, kosto e transportit të mbetjeve (1165 lekë/ton) duke përfshirë dhe depozitim në Landfill mbuloheshin nga buxheti i Bashkisë. Duke filluar nga 1 Janar 2018, ky shërbim është detyrim që mbulohet nga kontrata koncesionare lidhur ndërmjet Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit dhe operatorit “Integrated Energy BV SPV”, ku bashkia Tiranë është përfituese.

Bazuar në studimin e fizibilitetit për “Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë (ZTMT)” të hartuar nga vetë operatori “Integrated Energy BV” do ndërtohen 4 objekte kryesore:

- Impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane (IPMU) me rikuperim të energjisë (Waste to Energy Plant- WTE) duke prodhuar energji elektrike;
- Vend-depozitimit i mbetjeve urbane, vend-depozitimin e mbetjeve pas përpunimit në termovalorizator dhe atë të mbetjeve inerte;
- Impianti i riciklimit dhe stabilizimit të mbetjeve urbane;
- Impianti i përpunimit të ujërave të ndotur;




Fig. 7 13 Plani dhe organizimi i sheshit të ZTMT-së

- Lot A – Vend-depozitimi ekzistues i Sharrës
- Lot B – Vend-depozitimi i mbetjeve të ngurta urbane
- Lot C – Impianti i përpunimit të mbetjeve
- Lot D – Impianti i riciklimit dhe stabilizimit
- Lot E – Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur
- Lot F – Vend-depozitimi i hireve dhe mbetjeve industriale
- Lot G – Vend-depozitimi i mbetjeve inerte
- Lot H – Vend-depozitimi i mbetjeve inerte

Paralelisht me ndërtimin e objekteve të sipërpërmendura do të realizohet dhe kapsulimi final i landfillit ekzistues të Sharrës. I gjithë ky projekt është parashikuar për menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve për gjithë Qarkun e Tiranës.

Zona e propozuar për realizimin e implantit ka një sipërfaqe rreth 120 Ha dhe shtrihet në jug dhe lindje të zonës së landfillit ekzistues. Zona ka një pjerrësi të përgjithshme të ulët në drejtim të jug-perëndimit dhe është e ndërprerë nga prania e dy rezervuarëve të vegjël.

Sipas një vlerësimi paraprak, zhvilluesi pret për të trajtuar një volum prej 550-800 ton mbeturina në ditë, ekuivalente me një shumë maksimale prej 292 000 ton mbeturina/vit.

Investimi i planifikuar për ndërtimin e ZTMT është 128 248 330 Euro.

Tabela 7-8 Investimet e parashikuara në ZTMT

Objekti	Kosto (Euro)
Mbyllja e landfillit ekzistues	12 928 700
Termovalorizatorët	76 000 880
Vend-depozitimi i Mbetjeve urbane	11 292 500
Venddepozitimi i inerteve	5 668 500
Vend-depozitimi i hireve	11 292 500
Impianti i pastrimit të ujërave	1 990 250
Impianti i diferencimit	1 650 000
Nënstacioni elektrik	1 225 000
Sheshe, rrugë aksesit etj	5 450 000
Mjete Transporti	750 000
Total	128 248 330

Sipas studimit të fizibilitetit, bashkia do të paguajë 29,05 euro pa TVSH për ton/mbetje. Kjo vlerë arrin në 7 milionë euro për 246,800 ton mbeturina shtëpiake të prodhuara nga Tirana çdo vit dhe të përpunuara në ZTMT.

Në vijim informacioni i përfshirë në Nismën për Zbutjen e Riskut në Vend-depozitime.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës në nivel lokal:

Vlen të theksohet që në rastin e Qarkut Tiranë, bashkëpunimi me koordinаторët e bashkive ka qenë mjaft i dobët dhe thujse i gjithë angazhimi është mbuluar nga Grupi i Punës i ngritur pranë Prefekturës Tiranë.

Bashkia Tiranë ka referuar 19 vend-depozitime shumica e të cilave nuk plotësojnë kriteret (sasiore) për t'u trajtuar si të tillë. Gjithsesi çdo gjë që ka ardhur nga Grupi i Punës së Prefekturës është përfshirë në Planin e Masave dhe Kostimin respektiv të paraqitur në Tabela 7-9 në vijim.

Bashkia Vorë ka referuar vetëm vend-depozitim në Kuç. Nga verifikimi në terren i grupit të punës dhe komunikimi me stafin e bashkisë që mbulon këtë sektor konkludohet se ky vend depozitim paraqet disa problematika dhe bie ndesh me disa kriteret përjashtuese ligjore. Risqet kryesore që paraqet, kryesisht nga depozitimi i mbetjeve urbane:

- përshkueshmëria mesatare gjeologjike e terrenit ku është vendosur ky vend-depozitim mund të ndikojë në ndotjen e ujërave nën-tokësor;
- pozicionimi i këtij vend-depozitimi në zonën ujëmbledhëse të një rezervuari (rreth 926m larg), për qëllime bujqësore. Në kushte të tilla depozitimi i mbetjeve urbane në këtë vend-depozitim përbën rrezik për ndotjen e ujit të rezervuari dhe filtrime të mundshme.
- Risku kryesor mjedisor është prania e pyllit dhe rreziku i zjarreve, që e bën këtë vend-depozitim të papërshtatshëm për depozitim të mbetjeve urbane, ndërkohe që mbetjet e ngurta inerte nga ndërtimi, nuk e paraqesin këtë problem.

Si i tillë, ky vend-depozitim propozohet për Rehabilitim, por me kushtin e përdorimit vetëm për mbetje të ngurta inerte që vijnë nga ndërtimi.

Bashkia Rrogozhinë rezulton me 6 vend-depozitime, nga të cilët 2 janë shtuar nga platforma e ish-MZHU. Rezulton një nga bashkitë më problematike pasi gjithë pikat e referuara janë pranë lumit Shkumbin. Shpesh herë gjatë stinës së dimrit, kur lumi bëhet i rrëmbyeshëm si rrëshim i shtimit të prurjeve, dëmtohen shpatet e vend-depozitimit dhe merr mbetje me vete duke i zhvendosur ato drejt detit Adriatik. Duke qenë një nga bashkitë që asistohen nga GIZ, për sektorin e menaxhimit të mbetjeve, të gjitha masat e propozuara dhe kostimet janë rakorduar me ekspertizën e donatorit.

Bashkia Kamëz nuk ka referuar asnjë vend-depozitim. Nga ekspertiza e dldp që mbështet MTM është shtuar një vend-depozitim nga platforma e ish-MZHU.

Bashkia Kavajë. Nga grupi i punës së Prefekturës Tiranë është referuar një pikë grumbullimi, ndërsa nga ekspertiza e dldp që mbështet MTM janë shtuar dy vend-depozitime nga platforma e ish-MZHU.

Tabela 7-9 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Tiranë

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	KAMËZ	Vend-depozitim nga MZHU 1	Largim	11 391 932
2	KAVAJË	Vend-depozitim nga MZHU 1	Mbyllje	1 155 657
3		Vend-depozitim nga MZHU 2	Mbyllje	5 061 157
4		Kavaje	Largim	44 339
5	RROGOZHINË	Vend-depozitim nga MZHU 1	Rehabilitim	12 927 434
6		Vend-depozitim nga MZHU 2	Mbyllje	3 072 614
7		Ura Rrogozhinë	Largim	1 145 527
8		Në afërsi të bashkisë	Largim	43 325
9		Gosë	Largim	252 756
10		Sharrdushk	Mbyllje	35 816
11	TIRANË	Landfilli i Sharrës		
12		Kashar	Largim	38 311
13		Ura ne fshatin Damjan	Mbyllje	5 664 281
14		Ura ne Peze	Largim	62 426
15		Menik	Mbyllje	18 901 418
16		Ura e Beshirit,Ndroq	Mbyllje	3 792 590
17		Ura e Mezezit	Largim	4 494 104
18		Mezëz	Mbyllje	586 116
19		Arbane	Largim	76 616
20		Ferraj	Largim	23 998
21		Ura e Brarit	Mbyllje	966 604
22		Krrabe	Mbyllje	1 933 199
23		Baldushk	Mbyllje	1 147 623
24		Ibë	Largim	254 126
25		Mjull-bathore	Largim	69 306
26		Prush,Vaqarr	Largim	164 029
27		Picalle	Largim	63 848
28		Linzë	Largim	76 616
29		Bulticë	Largim	127 067
30		Vishaj	Mbyllje	9 469 163
31	VORË	Kuc	Rehabilitim	8 536 988
Total kosto për Qarkun Tiranë				91 578 986

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN TIRANË




Fig. 7.14 Vend-depozitimet në Qarkun Tiranë

7.9. Qarku Elbasan

Impianti i trajtimit të mbetjeve të Elbasanit është miratuar me Vendim të KKT Nr. 1, datë 27 01 2015 “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë”, me vendndodhje në Bashkinë Elbasan” Impianti është një investim me vlerë 22 milionë Euro ka filluar punë në Prill të vitit 2017. Ai është vendosur në vendgrumbullimin e mbetjeve në anë të ish kombinatit metalurgjik në Elbasan.




Fig. 7 15 Plani i sheshit të ndërtimit të Impiantit të trajtimit të mbetjeve të Elbasanit

Bazuar në raportin vlerësues dhe dokumentin e rregullores, projekti parashikon:

- Prona e bashkisë e venë në dispozicion ka sipërfaqe 431 720 m²;
- Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit të Impiantit të prodhimit të energjisë është 16 000m² nga të cilat 2000 m² i zë ndërtesa e Impiantit;
- Landfilli ku do depozitohen mbetjet urbane të papranueshme dhe hiri pas djegies ka një sipërfaqe 10 000 m²;
- Në fazën e shfrytëzimit është parashikuar të prodhohet rreth 17 250 MW/ vit;
- Ka kapacitet 120-140 ton përpunim mbetje të ngurta urbane;
- Nga përpunimi i mbetjeve parashikohet të sigurohen rreth 400 ton skrap dhe plastikë në vit, prej të cilave vlerësohet të gjenerohet një e ardhur vjetore prej 90 mijë euro;
- Avantazhe jo vetëm për Elbasanin, por edhe më gjerë Nga njëra anë, i jepet zgjidhje një problemi serioz në vend, mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve, por nga trajtimi teknologjik i tyre do të përfitohet edhe energji e gjelbër.

Po ashtu, projekti parashikon edhe krijimin e një brezi të gjelbëruar përreth digës dhe vlerësohet të sjellë ndikim edhe në ekonominë lokale.



Fig. 7 16 Pamje e landfillit Elbasan, pjesë e impiantit të trajtimit të Mbetjeve të Ngurta



Fig. 7 17 Pamje e impiantit të prodhimit të energjisë Elbasan

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës në nivel lokal:

Nga 7 bashkitë që janë pjesë përbërëse e Qarkut Elbasan, 4 prej tyre kërkojnë rehabilitim të një vend-depozitimi. Pavarësisht prezencës së Impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane (ITMU) në Elbasan, kjo kërkesë e bashkive bazohet kryesisht në gjendjen ekzistuese të infrastrukturës rrugore (distanca nga qytetet qendër deri në e ITMU) dhe si rrjedhim rritja e kostos së transportit për depozitimin e mbetjeve atje.

Bashkia Elbasan referon 5 vend-depozitime dhe nga ekspertiza e dldp që mbështet MTM është shtuar një vend-depozitim nga platforma e ish-MZHU. Si masa kryesore, në këto vend-depozitime parashikohen mbyllja ose largimi i mbetjeve në ITMU. Kryesisht largimi është propozuar për ato vend-depozitime që janë pranë trupave ujq sipërfaqësor.

Bashkia Cërrik aktualisht depoziton mbetjet në ITMU Elbasan dhe si rrjedhim për secilin nga 5 vend-depozitimet e evidentuara parashikon masën e largimit të mbetjeve. Bazuar në këtë skenar Grupi i Punës pranë bashkisë ka hartuar kostimin e zhvendosjes së mbetjeve duke llogaritur dhe distancat e sakta nga ITMU Elbasan. Në procesin e vleftësimit të informacionit, ka patur një komunikim direkt me bashkinë Cërrik për të rakorduar raportin e masave dhe kostot e ndërhyrjeve.

Bashkia Gramsh, referon për rehabilitim vetëm vend-depozitim në fshatin Mashan. Kujtojmë që vend-depozitimi i vjetër i bashkisë Gramsh, është përfshirë në listën e infrastrukturave që përmbyteshin nga ndërtimi i HEC Devoll (Devoll Hydro-Power). Në këto kushte, me Vendim të Këshillit të Bashkisë Nr.10, dt.10.02.2016 "Për mbylljen e vend-depozitimit aktual të mbetjeve urbane dhe miratimin e fushë-depozitimit të ri të mbetjeve urbane të bashkisë Gramsh" ka nisur të funksionojë dhe vend-depozitimi aktual në fshatin Mashan. Kërkesa për rehabilitim vjen pasi, me vendim-marrjen e mësipërme thjesht është përcaktuar pozicioni (parcela) ku do hidhen mbetjet duke respektuar kushtin që të jetë jashtë rezervuarit të formuar nga HEC Devoll, por nuk ka patur punime të mirëfillta për të ndërtuar një vend-depozitim të kontrolluar sanitar.

Bashkitë Belsh paraqet një vend-depozitim dhe duke konsideruar distancat dhe koston e transportit të mbetjeve në ITMU Elbasan, kërkon rehabilitimin e tij, me qëllim vazhdimin e përdorimit në terma afatmesëm, deri në mundësimin e zgjidhjes finale.

Vend-depozitimi ndodhet në parcelën publike me sipërfaqe 2000m², fshati Trojas, vendi i quajtur Shkëmbi i Zekthit. Relievi është një grope fundi i se cilës është sistemuar me argjile dhe është ngjeshur. Nga vëzhgimet e bëra në teren nuk rezulton të ketë burime ujërash nëntokësore në afërsi të vend-depozitimit dhe gjithashtu vlen të theksohet që mungon bimësia e dendur.

Bashkitë Peqin ka paraqitur një vend-depozitim dhe duke konsideruar distancat dhe koston e transportit të mbetjeve në ITMU Elbasan, kërkojnë rehabilitimin e tij me qëllim vazhdimin e përdorimit në terma afatmesëm, deri në mundësimin e zgjidhjes finale.

Sipas të dhënave të grupit të punës në nivel lokal, vend-depozitimi i Mbetjeve Urbane në Bashkinë Peqin është i miratuar me V.K.B dhe është në proces për miratimin e Lejes Mjedisore. Vend-depozitimi është 680m larg zonave të banuara dhe 1680m larg qendrës së qytetit. Distanca nga lumi Shkumbin është 2310 m, si rrjedhojë nuk kemi risk mjedisor të dukshëm në ndotjen e trupave ujqor sipërfaqësor. Vend-Depozitimi ndodhet në fshatin Proger dhe ka një sipërfaqe 7000m². Duke qenë një nga bashkitë që asistohen nga GIZ, për sektorin e menaxhimit të mbetjeve, masat e propozuara dhe kostimet janë rakorduar me ekspertizën e donatorit.

Bashkia Librazhd referon vetëm një vend-depozitim në Rrypzat e Lushit dhe masa që propozon është Largim i mbetjeve. Ky vend-depozitimi është në grykë të një përroi ku pjesët anësore janë skarpata të thella që bëjnë mjaft të vështirë aksesin. Në pjesën e poshtme është ndërtuar një pritë me gabiona që të mbajë mbetjet mos bien në përrua. Pjerrësia e këtyre shpateve nuk lejon ndërhyrje për marrjen e masave për sistemimin afatgjatë si rrjedhim propozohet largimi i mbetjeve.

Bashkia Përrenjas referon një vend-depozitim për mbyllje dhe një për rehabilitim. Vend depozitimi për mbyllje në Nj. A. Qukës është pozicionuar në vendin e quajtur ish-miniera e Bushtricsë. Prej 2 vitesh është jo-aktive dhe ka një distance prej 100 m larg lumit Bushtrice.

Tabela 7-10 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Elbasan

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	BELSH	Shkambi Zekthit	Rehabilitim	3 404 388
2	CËRRIK	Cerrik	Largim	8 541 711
3		Gostim	Largim	8 447 009
4		Mollas	Largim	1 975 993
5		Klos	Largim	2 306 190
6		Shales	Largim	1 758 148
7	ELBASAN	Impianti i Trajtimit të Mbetjeve Urbane (ITMU)		
8		Pisha, Lagja Çame	Largim	3 666 600
9		Muriqan	Mbyllje	1 298 137
10		Fshati Vidhas, Lapidar	Mbyllje	2 324 344
11		Kusha	Largim	5 836 194
12		Balez Rruga për Funar	Largim	64 239
13		VD nga MZHU 1 (mbetjet ish metalurgjia)	Largim	27 376 650
14	GRAMSH	Fshati Mashan	Rehabilitim	14 592 842
15	LIBRAZHD	Rrypzat e Lushit	Largim	3 556 040
16	PEQIN	Vend-depozitimi 1	Rehabilitim	3 245 282
17	PËRRENJAS	Qukës	Mbyllje	814 936
18		Krastë	Rehabilitim	8 250 898
Total kosto për Qarkun Elbasan				97 459 601

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN ELBASAN




Fig. 7 18 Vend-depozitimet në Qarkun Elbasan

7.10. Qarku Fier

Depozitimi i mbetjeve që gjenerohet nga bashkitë e Qarkut Fier bëhet kryesisht në vend-depozitime ilegale që në shumicën e rasteve janë tejet të mbushur dhe jashtë kapacitetit. Secila nga bashkitë ka minimalisht një vend-depozitim të improvizuar dhe jashtë kriterëve mjedisore e higjeno-sanitare. Pozicionimi i tyre pranë trupave ujore sipërfaqësor e rrit dhe më shumë problematikën mjedisore që ato shfaqin.

Impianti, i ri rajonal, i trajtimit të mbetjeve urbane për Qarkun e Fierit është miratuar me Vendim të KKT Nr. 15, datë 16.10.2017 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: “Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”, me vendndodhje në Bashkinë Fier”.

Subjekti fitues i kontratës konçensionare është shoqëria “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k. e cila do jetë edhe subjekti zhvillues i këtij projekti.

Projekti, propozon një zgjidhje të kombinuar për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane për qarkun e Fierit. Propozimi teknik përfshin ndërtimin e një impianti të përpunimit të mbetjeve urbane me rikuperim të energjisë dhe një landfilli, brenda një zone të vetme, e cila ndodhet në territorin e fshatit Verri, Nj. A. Mbrostar, të Bashkisë Fier.

Zgjidhja teknologjike e projektit përfaqëson një impiant që prodhon energji elektrike nga djegia e mbetjeve të ngurta urbane, si në gjendjen fillestare të tyre (siç vijnë në impiant) ashtu edhe të para-seleksionuara.

Fuqia e centralit parashikohet 3.85 MWe dhe do të hidhet në rrjetin kombëtar të energjisë elektrike. Lidhja me rrjetin kombëtar do të bëhet në linjën 35 kV “Linja 30-51 Jagodinë-Libofshë”, e cila kalon pranë zonës së impiantit, paralel me autostradën Fier-Lushnjë.

Sipërfaqja e zonës që do të përdoret për ndërtimin e impiantit është rreth 11.15 hektarë dhe në përzgjedhjen e saj janë marrë parasysh veçoritë e terrenit, nevoja për hapësira shtesë në ndonjë situatë të paparashikuar.

Terreni në afërsi të fshatit Verri, Njësia administrative Mbrostar, me destinacion përdorimi “tokë bujqësore (arë)”, është pronë publike bazuar në VKM nr. 951, datë 28.12.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private që preket nga realizimi i projektit “Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë” si dhe Landfill në ndihmë të këtij aktiviteti”.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës në nivel lokal:

Bashkia Divjakë ka raportuar katër vend depozitime (Gur, Gradisht, Grabian dhe Tërbuf) dhe një vend depozitim është shtuar nga harta/platforma e ish-MZHU. Asnjë nga këto vend depozitime nuk plotëson kriteret dhe standardet tekniko ligjore. Bashkia Divjake ka 5 njësi administrative dhe mbetjet e gjeneruara menaxhohen dhe transportohen nga ndërmarrja e

shërbimeve publike pranë kësaj bashkie. Në vitin 2014, bashkia Divjakë ka bërë kërkesë (pranë ish MZHU-së) për të hapur një vend depozitim të ri larg qendrave të banuara dhe jashtë zonës së mbrojtur, por nuk ka patur lëvizje konkrete në këtë drejtim. Në kushte të tilla Bashkia kërkon rehabilitimin e vend depozitimit Gur, për vazhdimin e operimit të tij deri në një zgjidhje përfundimtare. Vend depozitimi Gur është miratuar me Vendim të Komunës Remas Nr. 90, datë 10.03.2014. Për këtë vend depozitim me sipërfaqe 3500 m² është aplikuar për leje mjedisore dhe ky aplikim është refuzuar. Duhet konsideruar që vend depozitimi i fshatit Gur është brenda zonës së mbrojtur të shpallur me VKM nr. 687 date 19.10.2007 "Për shpalljen, me sipërfaqe të zgjeruar, të ekosistemit natyror Divjakë-Karavasta "Park kombëtar"". Si i tillë ky vend depozitim duhet të mbyllet dhe të rehabilitohet sepse pozicionohet midis dy kodrave atraktive për zhvillimin e turizmit. Mbetjet janë të sistemuara pranë një sipërfaqe pyjore, pozicion ky që shfaq riskun e zjarreve nga pakujdesia në këtë fushe mbetjesh. Ujërat e prodhuara nga dekompozimi i mbetjeve janë burim infeksioni pasi zbresin deri në lagunën e Karavastasë nëpërmjet kanaleve kullues.

Vend depozitimi Gradishtë ndodhet tek nënstacioni buzë emisarit të Myzeqesë. Është larg nga qendrat e banuara por leksiviatet përfundojnë në emisarën e Myzeqesë e përmes tij shkarkohen në det. Mbetjet janë të pa sistemuara në të gjithë gjatësinë e fushës. Ky vend-depozitim është miratuar me vendim të Këshillit të Komunës Nr. 50, dt. 27.10.2008. Për këtë vend depozitim është aplikuar për leje mjedisore dhe është refuzuar. Vend depozitimi ka një sipërfaqe 1000 m², është i pa rrethuar dhe pa sinjalistikën minimale. Grupi i punës gjykon që ky vend depozitim duhet të mbyllet pasi nuk plotëson kushtet minimale teknike.

Vend depozitimi Tërbuf ndodhet pranë fshatit Cerme Sektor ngjitur me kolektorin kullues të Tërbufit. Ka një sipërfaqe 3400 m² dhe është miratuar me Vendim Këshilli të Komunës Tërbuf Nr.4 dt. 30.03.2001. Për këtë vend-depozitim është aplikuar për leje mjedisore dhe është refuzuar pasi nuk plotëson kushtet. Mbetjet kanë arritur deri në rrugën lidhëse Cerme Sektor- Tre Ura pasi janë të pa sistemuara. Ujërat e prodhuara nga dekompozimi i mbetjeve shkojnë në kolektorin ngjitur që përdoret dhe për vaditje dhe që derdhet në det. Ky vend depozitim është i pa rrethuar dhe shfaq shqetësime dhe rrezik në periudhën e verës për zjarre spontane.

Vend depozitimi Grabian ndodhet në anë të rrugës Grabian-Ferras me një sipërfaqe 1375 m² i miratuar me Vendim të Këshillit të Komunës Grabian nr.17, datë 23.12.2012. Vend-depozitimi është i pa rrethuar dhe shumë pranë banesave. Mbetjet janë të pa sistemuara, dhe uji i ndotur shpërndahet në rrugë dhe përfundon në kanalin kullues ngjitur. Në vend-depozitim mungon sinjalistika e nevojshme. Vend depozitimi mund të jetë burim infeksioni dhe zjarresh. Grupi i punës gjykon që ky vend-depozitim duhet të mbyllet.

Për vend depozitim të evidentuar nga harta e ish-MZHU është rekomanduar largimi i mbetjeve dhe rehabilitimi i terrenit.

Bashkia Fier ka si vend depozitim kryesor atë në Lagjen Sheq i Madh, 4 km nga qendra e qytetit Fier, në krahun e majtë të rrugës “Teodor II Muzaka”. Vendndodhja e papërshtatshme, shumë pranë shtratit të Lumit Gjanica , kolektorit Roskovec-Hoxhar, vendbanimeve dhe linjës hekurudhore bën që ky vend depozitim të shfaq njëkohësisht disa risqe për mjedisin dhe komunitetin e zonës. Në vijim disa të dhëna teknike që ka sjell grupi i punës për këtë vend depozitim:

- Sipërfaqja është 6.2 ha.
- Sasia e mbetjeve që hidhen vend-depozitim 60311.72 ton/vit. Nga të cilat vetëm zona urbane e Qytetit të Fierit për vitin 2017 ka depozituar një sasi mbetjesh prej 49731 ton/vit
- Sasia e mbetjeve inerte 8833 m³/vit
- Nuk kryhet grumbullimi i diferencuar i mbetjeve.

Në territorin e bashkisë referohen edhe 9 vend depozitime të tjera që ndodhen në Njësitë Administrative që shërbejnë si pika tranzite për mbetjet të cilat pastaj grumbullohen tek vend depozitimi kryesor i përmendur më sipër. Grupi i Punës i bashkisë Fier, në raportet e sjella, thjesht përshkruan prezencën e tyre por nuk jep referenca të sakta gjeografike se ku ndodhen. Gjithashtu ato rekomandojnë që këto vend depozitime duhet të mbyllen pasi operimi në to’ nuk respekton kushtet minimale dhe në shumicën e rasteve ndodhen fare pranë kolektorëve, kanaleve të cilët përdoren për vaditje te tokave bujqësore.

Në platformën e ish MZHU referohen edhe 3 vend depozitime të tjera që janë shtuar në listën e vend depozitimeve të bashkisë Fier nga kompania konsulente. Nuk është e qartë nëse këto 3 përputhen me 9 vend depozitimet e referuar nga grupi i punës.

Bashkia Lushnjë referon 4 vend depozitime (Lushnje qytet, Dushk, Krutje, Bubullime-Gjonas).

Vend depozitimi Lushnjë qytet ndodhet ne kushte mjaft të rënduara teknike dhe mjedisore dhe gjithashtu pranë zonave te banuara. Ky vend depozitim është hapur me Vendim te Komitetit Ekzekutiv rrethit Lushnje nr.107, date 21.07.1983. Hyrja e vend depozitimit është ne kushte jo te mira infrastrukturore, mungojnë kriteret e operimit në lidhje me sistemimin e mbetjeve dhe nuk është i pajisur me rrjet kanalizimesh për disiplinimin e ujërave sipërfaqësore. Gjithashtu mungon rrethimi dhe sinjalistika e duhur. Për këtë vend depozitim është aplikuar për leje mjedisore dhe është refuzuar për arsye se gjate verifikimit janë konstatuar parregullsitë e sipërpërmendura. Grupi i punës rekomandon qe ky vend-depozitim te qëndrojë i hapur për shkak te kapacitetit te madh, infrastrukturë me te përshtatshme dhe ndërhyrje me te lehte nga vend-depozitimet e tjera.

Vend depozitimi Dushk me sipërfaqe 4000 m² është miratuar me vendim te këshillit te komunës Dushk nr. 04, datë. 31.01.2012. Ndodhet larg se zonës se banuar por shume afër autostradës dhe hekurudhës. Ndikimi në ujrat nëntokësorë e kthen burim ndotje të tokave

bujqësore që shfrytëzohen nga fermerët. Duke konsideruar kapacitetin e ezauruar tashmë ky vend depozitim është i papërshtatshëm për t'u rehabilituar.

Vend depozitimi Krutje me sipërfaqe 8500 m² është miratuar me vendim të këshillit të komunës nr.7 date 16.03.2007. Vend depozitimi ndodhet në zone fushore-kënetore, larg zonave të banuara. Duke qenë i vendosur në një terren nën nivelin e detit është shumë i rrezikuar nga përmbytjet. Është burim ndotje për ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Gjendja e mbetjeve të depozituara alarmante.

Vend depozitimi Bubullimë-Gjonas me sipërfaqe 2000 m² është miratuar me vendim të Këshillit të Komunës nr. 237/1 date 17.05.2012. Ndodhet në zone fushore larg zonave të banuara por ngjitur me tokat bujqësore që shfrytëzohen nga fermerët. Përgjithësisht ka një kapacitet shumë të vogël. Theksojmë se ngjitur me vend-depozitimin ndodhet një pus naftë aktiv por i ruajtur dhe i mbyllur nga institucionet përkatëse.

Bashkia Mallakastër ka referuar një vend depozitim në fshatin Kash. Ky vend depozitim është miratuar me vendim të këshillit të komunës Qendër Mallakastër Nr. 30 date 24/10/2012, ka një sipërfaqe rreth 5000 m² dhe kapacitet mbajtës rreth 10.000 m³. Vend depozitimi nuk është i rrethuar dhe në disa zona shfaq rrezik rrëshqitje dheu. Vend depozitimi është i pajisur me leje mjedisore të tipit C me Nr. 2123 Prot datë 12.08.2016. Për këtë vend depozitim rekomandohet rehabilitimi dhe vazhdimi i përdorimit të tij meqë është i vetmi në territorin e bashkisë. Gjithashtu duhet cituar se ky vend depozitim është në terren të pjerrët duke bërë shumë të vështirë sistemimin e mbeturinave dhe kërkon një mur mbajtës kundër rrëshqitjeve.

Bashkia Patos referon dy vend depozitime të mbetjeve urbane që janë: vend depozitimi kryesor në Mazarent dhe ai dytësor në Zharres. Aktualisht ato janë jashtë standardeve minimale që kërkojnë të tilla infrastruktura.

Bashkia Patos referon që ka studim fizibiliteti dhe është hartuar një projekt teknik për një pikë të re grumbullimi. Gjithsesi deri në realizimin e kësaj veprë rekomandohet rehabilitimi i dy vend depozitimeve në mënyrë funksionimin sa më të mirë të tyre për periudhën tranzitore.

Bashkia Roskovec referon vetëm një vend grumbullim, shumë pranë zonës së banuar që rëndon edhe më tej problematikën e ndotjes së ajrit në fshatin Marinëz. Vend depozitimi ekzistues në fshatin Marinëz është ndërtuar me vendim të këshillit të ish komunës Kuman që në vitin 2013, ka një sipërfaqe rreth 10.000 m² dhe kapacitet mbajtës rreth 10.000-15.000 m³. Për këtë vend depozitim është marrë leje mjedisore të tipit C me nr. 150 Prot datë 27.01.2017. Në pamundësi për të depozituar në vend tjetër Bashkia Roskovec rekomandon rehabilitimin e vend depozitimit aktual dhe shfrytëzimin e mëtejshëm të tij deri në zgjidhjen permanente të këtij problemi

Tabela 7-11 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Fier

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	DIVJAKË	1-Gur Remas	Rehabilitim	6 016 699
2		2-Gradisht	Mbyllje	2 663 769
3		3-Terbuf	Mbyllje	3 328 845
4		4-Grabian	Mbyllje	1 434 101
5		Vend-depozitimi nga MZHU 1	Largim	2 718 474
6	FIER	1-TEODORI 2 MUZAKA	Rehabilitim	27 454 798
7		Vend-depozitimi nga MZHU 1	Largim	717 289
8		Vend-depozitimi nga MZHU 2	Largim	5 604 229
9		Vend-depozitimi nga MZHU 3	Largim	3 434 197
10	LUSHNJE	1-Lushnje	Rehabilitim	26 859 511
11		2-Dushk	Mbyllje	4 218 087
12		3-Krutje	Mbyllje	6 568 966
13		4-Bubullime- Gjonas	Mbyllje	1 704 831
14	MALLAKASTËR	1-Kash Mallakastër	Rehabilitim	6 671 132
15	PATOS	2-Mazarent	Rehabilitim	7 054 921
16		1-Zharrez	Rehabilitim	8 150 784
17	ROSKOVEC	1-Fshati Marinëz	Rehabilitim	5 601 465
18		Gropa ekologjike Luar	E pa ndërtuar	
19		Vend depozitimi nga MZHU 1	Largim	1 679 170
Total kosto për Qarkun Fier				121 881 268

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN FIER




Fig. 7.19 Vend-depozitimet në Qarkun Fier

7.11. Qarku Berat

Bashkia Berat raporton ne territorin administrativ te kësaj bashkie 3 vend depozitime nga te cilat vetëm njëri është i miratuar nga institucionet vendore (funksionon si i tille qe ne vitin 1980) dhe dy te tjerat krejtësisht ilegale (kryesisht për mbetje inerte). Nga grupi i punës, rekomandohet që dy vend depozitimet ilegale të mbyllen.

Duke konsideruar afërsinë me lumin Osum dhe me zonën e banuar edhe vend depozitimi i mbetjeve urbane te Bashkisë Berat rekomandohet të mbyllet pavarësisht se është e paqartë zgjidhja për depozitim në një vend tjetër.

Bashkia Kuçovë referon një vend depozitim për mbetjet urbane dhe një për ato inerte. Vend depozitimi i mbetjeve urbane ka një sipërfaqe prej 27 000 m² dhe ndodhet 4 km larg qytetit të Kuçovës. Distanca minimale nga lumi Devoll është 25 m. Sasia e vlerësuar e mbetjeve të depozituara në këtë vend-depozitim është 200 160 ton (për rreth 30 vjet që funksionon si vend-depozitim). Për arsye se ndodhet në një zonë ku mund të ndodhin përmbetje, nevojitet ndërtimi i një argjinature mbrojtëse 400 ml. Gjithashtu, për të evituar risqe kryesore mjedisore si dhe risqe lidhur me popullatën nevojiten: drenimi dhe grumbullimi i ujërave dhe gazit që dalin nga kullimi. Ky vend depozitim nuk ka leje mjedisore, leje ndërtimi apo vendime të ndryshme tekniko-ligjore.

Vend depozitimi i mbetjeve inerte ka një sipërfaqe prej 17 200 m² dhe ndodhet 1,2 km larg Kuçovës. Përgjithësisht ky vend depozitim nuk paraqet risqe kryesore mjedisore apo të popullatës për arsye se hidhen vetëm mbetjet inerte. Grupi i punës rekomandon rehabilitim të pjesshëm që mund të ndërmerret edhe nga vetë bashkia në të ardhmen.

Bashkia Poliçan referon 8 vend depozitime nga të cilat 2 të aprovuara nga Këshillat Lokale dhe te tjerat krejtësisht ilegale. Vlen të theksohet se të gjitha vend depozitimet ilegale në territorin e kësaj bashkie janë vend depozitime mbetjesh inerte (hedhje mbetjesh nga subjektet e përpunimit te pllakave te gurit). Për të gjitha vend depozitimet ilegale bashkia propozon largimin e mbetjeve dhe rehabilitimin e terrenit. Për dy vend depozitimet në Lagjen Plirëz, njëra për mbetjet urbane dhe tjetra për inertet, përkatësisht 2 600m² dhe 2 000 m², grupi i punës rekomandon rehabilitimin e tyre.

Bashkia Skrapar. Çorovodë 1 dhe Çorovodë 2 janë dy vend depozitimet kryesore të bashkisë Skrapar që referohen nga grupet e punës. Në vend depozitimin Çorovodë 1 janë bërë disa punime rehabilituese në vitin 2014, por kapaciteti i llogaritur nuk ishte ai për të cilin bashkia kishte nevojë pas Reformës Administrative. Aktualisht ky vend depozitim përdoret për mbetjet inerte. Ndodhur në këto kushte ne vitin 2016 është hapur vend depozitimi Çorovodë 2 për mbetjet urbane dhe duke e lënë ekzistuesin vetëm për mbetjet inerte. Vend depozitimi Çorovodë 2 edhe pse i hapur në 2016 nuk plotëson kushtet minimale teknike pasi nuk është bazuar në vlerësimet teknike të nevojshme që duhen bërë në këto raste (nuk ka as studim as projekt teknik). Në pamundësi për një zgjidhje tjetër më

adekuate, grupi i punës rekomandon rehabilitimin e Çorovodë 2 për një periudhë tranzitore 3-5 vjet.

Ndërsa vend depozitimet e tjera (3 të tilla) në bashkinë Skrapar janë vend depozitime mbetjesh inerte të krijuara nga depozitimi i mbetjeve të subjekteve privatë për të cilat bashkia propozon largimin e mbetjeve dhe rehabilitimin e zonës. Një nga këto vend depozitime ndodhen në zonën e mbrojtur Rezervat i Menaxhuar i Bogovës Kategoria IV e mbrojtjes, ndërsa tjetri në kanionet e Osumit (të cilat nuk janë zonë e mbrojtur, por paraqesin atraksion turistik).

Bashkia Ura Vajgurore ka funksional një vend depozitim mbetjesh urbane dhe një mbetjesh inerte. Për vend depozitim të mbetjeve urbane ka studim gjeologo-inxhinierik, leje mjedisore dhe Vendim të Këshillit Bashkiak. Ky vend depozitim do të vazhdojë të përdoret si i tillë deri në hapjen e një landfilli sanitar rajonal. Për këtë vend depozitim Bashkia Ura Vajgurore shpreh nevojën e marrjes së masave rehabilituese të nevojshme. Vend depozitimi tjetër, i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, përdoret për mbetje inerte, dhe bashkia shpreh nevojën për rrethimin e tij dhe ndërmarrjen e disa masave minimale të nevojshme. Dy vend depozitimet të tjera të raportuara nga grupi i punës janë vend depozitime të krijuara nga hedhja e mbetjeve nga komuniteti i banorëve përreth në mënyrë permanente (respektivisht një për mbetje urbane dhe tjetri për mbetje inerte). Për këto vend depozitime rekomandohet të largohen mbetjet. Në këto vend depozitime ilegale të mbetjeve, Bashkia Ura Vajgurore kryen vazhdimisht punime pastrimi, por nevojitet edhe sensibilizimi për mos vazhdimin e hedhjeve në to’.

Gjithashtu grupi i punës referon dhe një vend depozitim të abandonuar, që referohet si i mbyllur, dhe për të kërkohet kryhen punime për pyllëzimin e zonës.

Tabela 7-12 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Berat

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	BERAT	Vend-depozitimi 1 Dushnik	Mbyllje	10 345 567
2		Vend-depozitimi 2 Lagja Çlirim	Mbyllje	2 277 878
3		Vend-depozitimi 3 Qendra Lira	Mbyllje	5 571 345
4	KUÇOVË	1-Ish Ferma Partizani	Rehabilitim	12 548 922
5		2-Gropat e bitumit, Ish UPN	Rehabilitim	12 953 420
6	POLIÇAN	Vend-depozitimi 1	Largim	596 178
7		2-LAGJIA PLIREZ	Rehabilitim	5 051 777
8		3-LAGJIA PLIREZ	Rehabilitim	4 974 570
9		Vend-depozitimi 4	Largim	1 982 431
10		Vend-depozitimi 5	Largim	605 866
11		Vend-depozitimi 6	Largim	2 085 239
12		Vend-depozitimi 7	Largim	2 160 602
13		Vend-depozitimi 8	Largim	3 438 175
14	SKRAPAR	Vend-depozitimi Bogovë 1	Mbyllje	3 809 648
15		Vend-depozitimi Bogovë 2	Mbyllje	1 040 118
16		Vend-depozitimi Çorovodë 1	Rehabilitim	3 339 123
17		Vend-depozitimi Çorovodë Mb. Urbane	Rehabilitim	4 772 557
18		Çerenishtë	Mbyllje	582 960
19	URA VAJGURE	1-Fshati Vokopole	Rehabilitim	3 648 608
20		2-Fshati Sqepur	Largim	152 309
21		3-Fshati Kuç	Largim	799 805
22		4-Ish Vend-depozitim	Mbjellje pemësh	964 585
23		5-Lagjia 28 Nëntori	Rehabilitim	1 285 586
Total kosto për Qarkun Berat				84 990 269

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN BERAT




Fig. 7.20 Vend-depozitimet në Qarkun Berat

7.12. Qarku Korçë

Në vitet 2003-2005, me nismën e Bashkisë Korçë fillon Studimi Fizibilitetit për një zgjidhje rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve, i mbështetur financiarisht nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim KfW.

Në korrik 2011 zyrtarizohet mbështetja financiare e Qeverisë Gjermane³⁶, përmes Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, për realizimin e projektit Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Shqipërinë Juglindore në vlerën 11.8 milion Euro. Kjo marrëveshje ratifikohet me ligj³⁷ në vitin 2013. Projekti konsiston në:

1. Ndërtimin e një lëndfilli sanitar rajonal në Maliq,
2. Ndërtimin e 3 stacioneve të transferimit (Pogradec, Devoll dhe Kolonjë) dhe pajisjet e nevojshme,
3. Mjete dhe pajisje për përmirësimin e shërbimit ekzistues të grumbullimit të mbetjeve dhe për aktivitete pilot për riciklimin/kompostimin.



Fig. 7 21 Pamje nga landfill i Maliqit

³⁶ VKM Nr.567, datë 3.8.2011 "Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004, 2008, 2010, për projektin "Heqja e mbeturinave në Shqipërinë juglindore""

³⁷ Ligj Nr. 102/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Shoqatës Rajonale për Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta Korçë (KRWM) dhe KfW Frankfurt am main për financimin e projektit "Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë juglindore""

Në vijim jepen disa të dhëna teknike të projektit të landfillit sanitar të Maliqit:

- Miratuar me Vendim KKT Nr.12, dt. 04.07.2013 "Për miratimin e lejes zhvillimore komplekse për ndërtimin e vend depozitimit të mbetjeve urbane në qytetin e Maliqit, Qarku Korçë"
- Ndërtimi i landfillit sanitar do t'u shërbejë bashkive të Qarkut Korçë për një periudhë rreth 20 vjet nga fillimi i përdorimit. Riciklimi dhe kompostimi mund të zgjasin akoma më shumë kohën e përdorimit
- Landfilli në total ka një sipërfaqe prej 19.5 ha nga të cilët 7.37 ha do të përdoren për depozitimin e mbetjeve. Kapaciteti i përgjithshëm i tij do të jetë 1,046,000 m³.
- Përveç zonës së depozitimit të mbetjeve të ndërtuar me shtresa izoluese për të mbrojtur tokën dhe ujërat, landfilli sanitar përfshin sisteme për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të kullimit dhe të gazeve të çliruara, si edhe godina për personelin, godina e peshores, garazhe, ofiçina, etj.
- Vend depozitimi sanitar është ndërtuar në përputhje me standardet e BE dhe menaxhohet nga KRWM Sh.A nën mbikqyrjen e specialistëve vendas e ndërkombëtarë.
- Organizimi i një sistemi rajonal do të mundësojë transportimin e mbetjeve nga të gjitha Bashkitë drejt këtij vend depozitimi. Bashkitë: Pogradec, Devoll dhe Kolonjë për shkak të distancës më të madhe do të përdorin stacione transferimi për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve.

Në hapat e parë të zbatimit të projektit, në të gjitha njësitë vendore të Qarkut Korçë filloj një proces rehabilitimi dhe në disa raste mbyllje (kapsulim) i vend depozitimeve ekzistuese. Mungesa e kushteve të operimit në vijim bëri që ky investim, në disa raste, të mos ketë impaktin e dëshiruar dhe në një periudhë të shkurtër gjendja u përkeqësua serish.

Theksojmë se e gjithë infrastruktura e ndërtuar (lëndfill sanitar, 3 stacionet e transferimit etj.) për menaxhimin e integruar të mbetjeve në këtë qark, është në hapat e fundit të pajisjes me lejet përkatëse dhe së shpejti do filloj funksionimi i tij.

Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë

Në qershor të vitit 2008, themelohet Shoqëria Aksionare "Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë" (KRWM Sh.A), duke përfshirë vullnetin e 28 njësite vendore (në atë kohë 5 bashki dhe 23 komuna) për ndërtimin e një sistemi të përbashkët për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Qarkun e Korçës. Aktualisht, pas hyrjes në fuqi të Reformës Administrative Territoriale në 2015, KRWM Sh.A. ka 6 aksionar kryesor që janë përkatësisht bashkitë: Korçë, Pogradec, Maliq, Kolonjë, Devoll dhe Pustec.

Për ushtrimin e veprimtarive të saj, Shoqëria KRWM SH.A ka ndërtuar një sistem për administrimin e mbetjeve, i cili do të jetë i përbalueshëm nga ana ekonomike, jo i dëmshëm për mjedisin duke zbatuar teknikat më të mira dhe duke vepruar në përputhje me rregulloret, strategjitë, planet kombëtare, lokale dhe vendore për administrimin e mbetjeve.

Të dhënat që referohen nga Grupi i Punës në nivel lokal:

Në këtë qark janë raportuar 19 vend depozitime.

Bashkia Korçë: Në lidhje me katër vend depozitimet që referohen nga Grupi i Punës, bashkia nuk administron asnjë dokumentacion, si: vendim Këshilli Bashkiak, lejë ndërtimi, studime teknike apo lejë mjedisore.

Menaxhimi i mbetjeve në Korçë mbetet i kufizuar dhe i pamjaftueshëm. Mbetjet bashkiake kanë një përqindje të lartë të mbetjeve organike dhe nuk përdoret ndonjë metodë riciklimi për të reduktuar sasinë e tyre të cilat grumbullohen në vend depozitime.

Vend depozitimi i mbetjeve Korçë ka filluar të funksionojë përpara 35 vjetësh. Në këtë vend depozitim grumbullohen mbetje të ndryshme, duke përfshirë mbeturinat shtëpiake. Aktualisht, ujërat sipërfaqësore grumbullohen në një pellg kullimi por nuk trajtohen fare. Në rastin e reshjeve të dendura, uji i ndotur shkon në drejtim të burimit të ujit të pijshëm që ndodhet aty pranë, disa qindra metra larg. Kërcënimi për shëndetin e popullsisë lokale është serioz.

Duke marrë parasysh ndikimet e mundshme të vend depozitimit të Korçës, mund të konkludohet se është e nevojshme që urgjentisht të ndërmerren masa për rehabilitimin e zonës së landfill-it. Përveç kësaj, pas mbylljes së vend depozitimit, është e nevojshme të rikultivohet plotësisht zona e tij dhe të monitorohet ndikimi në mjedis.

Vend depozitimi në Nj.A. Mollaj ndodhet pranë rrugës nacionale Korçë – Ersekë, në Floq, rreth 8 km nga njësia administrative. Aktualisht është e mbuluar me dhera por ka nevojë për rehabilitim duke qenë se sasia e mbuluar mund të përbëjë rrezik, pasi mbulimi është realizuar pa ndonjë studim të mirëfilltë.

Vend depozitimi në Nj.A. Voskopojë ndodhet përgjatë rrugës Voskopojë – Shpëskë, në distancë rreth 3 km nga njësia administrative Voskopojë. Ngjitur me vend depozitim kalon lumi. Voskopoja me VKM është zonë e mbrojtur nga Monumentet e Kulturës. Gjithashtu është dhe zonë turistike. Ka nevojë për mbyllje dhe rehabilitim.

Vend depozitimi në Nj.A. Bulgarec ndodhet në distancë rreth 800 m larg nga njësia administrative. Është vend depozitim me mbetje (mbetje nga prodhimet e ndryshme që nuk përdorim më fshatarët, teprica, dëmtime, prishje të prodhimeve bujqësore dhe mbetje të tjera). Ka nevojë për mbyllje dhe rehabilitim.

Bashkia Pogradec raporton dy vend depozitime. Të dy këto vend depozitime janë në gjendje shumë të keqe dhe kërkojnë ndërhyrje sa më të shpejtë. Ata janë pa rrethim dhe pa asnjë masë për grumbullimin dhe përpunimin e ujërave të ndotur. Mungesa e rrethimit bën më të thjeshtë shpërndarjen e mbetjeve nga era duke sjellë më shumë ndotje të zonës, si dhe aksesin e këtyre vend depozitimeve nga kafshë të ndryshme sjell rrezikun e përhapjes së sëmundjeve. Bashkia propozon mbylljen e të dy vend depozitimeve duke marrë masat e

përcaktuara në metodologji. Në Bashkinë Pogradec, për vend depozitimin “Luadhi i Çelos” administrohet vetëm leja mjedisore e tipi C “Stacion Transferimi për mbetje jo të rrezikshme”, e lëshuar në datën 29.10.2014 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes. Ndërsa vend depozitimi “Përroi i Shtogut” nuk ka asnjë dokumentacion.

Bashkia Maliq raporton tre vend depozitime (Sovjan, Zvezdë dhe Maliq). Bashkia Maliq shprehet për mbylljen e të tre vend depozitimeve për shkak të risqeve që paraqesin secili prej tyre në lidhje me popullatën dhe me mjedisin. Në lidhje me këto vend depozitime nuk referohet asnjë dokument teknik apo ligjor që administrohet nga bashkia.

Bashkia Pustec ka pesë vend depozitime në territorin e saj. Duhet cituar se kjo bashki përfshihet e gjitha në Parkun Kombëtar të Prespës i shpallur Park Kombëtar me VKM nr.80 datë 18.02.1999. Kjo bashki shprehet për Rehabilitimin për përdorim të mëtejshëm të vetëm një vend depozitimi (Vend depozitimit në Pustec). Për të katër vend depozitimet e tjera (Zrnosko, Tuminec, Dollna Gorica dhe Gorna Gorica) bashkia shprehet për largimin e mbetjeve, rehabilitimin e zonës dhe pyllëzimin saj si dhe ndërgjegjësimin e banorëve për mos hedhjen e mbeturinave në këto vende. Në Bashkinë Pustec, administrohet vetëm Vendimi i Këshillit të ish-Komunës Liqenas Nr. 25, datë 29.02.2012 për 5 (pesë) vend depozitimet. Nuk ka asnjë dokumentacion tjetër, si leje mjedisore apo studime teknike.

Bashkia Kolonjë referon dy vend depozitimeve (Leskovik dhe Ersekë). Kjo bashki shprehet për rehabilitimin e vend depozitimit Leskovik dhe shfrytëzimin e mëtejshëm të tij për një periudhë tranzitore deri në funksionimin dhe largimin total të mbetjeve në stacionin e transferimit të mbetjeve i cili do të shërbej si stacion tranzitor për ti dërguar më pas mbetjet në landfillin sanitar të Maliqit. Për të siguruar një funksionim normal të këtij vend depozitimi gjatë kësaj periudhe tranzitore kërkohen masa rehabilituese si rrethimi i vend depozitimit dhe masa drenazhuese për grumbullimin e ujërave sipërfaqësor. Ndërsa për vend depozitimin Ersekë kjo bashki shprehet për mbylljen e tij dhe rehabilitimin e zonës. Fakti që ky vend depozitim ndodhet në një zonë me atraksion turistik shton rëndësinë e rehabilitimit të sipërfaqes. Në Bashkinë Kolonjë, nuk administrohet asnjë dokumentacion si vendim këshilli, leje ndërtimi, studime teknike apo leje mjedisore për 2 (dy) vend depozitimet e referuara në këtë platformë.

Bashkia Devoll ka raportuar 3 vend depozitime (Bilisht, Miras dhe Baban-Stropan). Kjo bashki shprehet për mbylljen e vend depozitimit Bilisht, i cili zë një sipërfaqe prej 2 ha, por mbyllja e tij të realizohet pas vënies në funksion të stacionit të transferimit të mbetjeve. Ky vend depozitim ndodhet në distancë 850 metra nga aksi i rrugës Bilisht-Korçë.

Vend depozitimi pranë fshatit Miras, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 2 000 m², pranë lumit Devoll dhe ngjitur me aksin e rrugës vendore Miras – Vidohovë. Rekomandohet që zona pastrohet dhe të pyllëzohet si dhe të bëhet ndërgjegjësimi i komunitetit për të mos u përdorur më si vend grumbullimi mbetjesh.

Për vend depozitimin pranë fshatit Baban-Stropan, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 500 m² dhe distancë 300 ml nga Fshati Baban, ngjitur me aksin e rrugës vendore Baban - Stropan, rekomandohet të pastrohet dhe të pyllëzohet kjo sipërfaqe si dhe të bëhet ndërgjegjësimi i komunitetit për të mos u përdorur më si vend grumbullimi mbetjesh.

Në Bashkinë Devoll, nuk administrohet asnjë dokumentacion për 3 (tre) vend depozitimet e referuara.

Tabela 7-13 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Korçë

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	DEVOLL	Gurët e zinj	Mbyllje	3 893 558
2		Miras	Mbyllje	1 734 997
3		Baban stropan	Mbyllje	152 838
4	KOLONJË	Ersekë	Mbyllje	3 660 949
5		Leskovik	Rehabilitim	5 610 219
6	KORÇË	Korçë	Mbyllje	23 126 282
7		Bulgarec	Mbyllje	6 337 772
8		Mollaj	Mbyllje	784 140
9		Voskopoje	Mbyllje	698 251
10	MALIQ	Sovjan	Mbyllje	2 067 486
11		Maliq	Mbyllje	7 621 517
12		Zvezde	Mbyllje	6 862 766
13	POGRADEÇ	Luadhi i Çelos	Mbyllje	637 716
14		Përroi i Shtegut	Mbyllje	15 648 305
15	PUSTEC	Zrnosko	Largim	316 164
16		Dollna Gorica	Largim	117 228
17		Gorna Gorica	Largim	259 520
18		Tuminec	Largim	207 984
19		Pustec	Rehabilitim	4 261 711
Total kosto për Qarkun Korçë				83 999 403

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN KORÇË




Fig. 7.22 Vend-depozitimet në Qarkun Korçë

7.13. Qarku Vlorë

Duke konsideruar vlerat turistike dhe natyrore të bregdetit të Jugut mund të themi që Qarku Vlorë ka patur vëmendje të vazhdueshme dhe së fundmi dhe investimet konkrete po japin shenja të përmirësimit të ndjeshëm të sistemit të menaxhimit të mbetjeve Aktualisht, landfilli në Bajkaj ka filluar të operojë dhe mbulon kryesisht bashkitë Himarë, Delvinë, Sarandë, Finiq dhe Konispol. Në vijim disa të dhëna teknike për landfillin në Bajkaj:

Ky landfill është miratuar me Vendim KKT Nr. 37, dt. 10.05.2013 “Leje zhvillimore komplekse për vend-depozitimin e mbetjeve urbane në Bajkaj, Komuna Vergo, Qarku Vlorë”.



Fig. 7 23 Pamje nga landfilli i Bajkaj

Ky landfill rajonal do shërbejë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane për bregdetin e jugut Aktualisht ka përfunduar faza e parë e ndërtimit, një investim që shkon në total 5,6 milionë dollarë. Sipas parametrave të projektit teknik, ky landfill:

- ka sipërfaqe 58 150m², me mundësi zgjerimi për të shkuar në 64 000 m²;
- ka kapacitet depozitimi 365 000 m³;
- është llogaritur për depozitimin e 25 000 m³ mbetje/vit.

Landfilli rajonal i Bajkaj, me vlerë prej 7 milion euro, është pjesë e Projektit të financuar nga Banka Botërore për “Menaxhimin e integruar dhe pastrimin e zonave bregdetare” Infrastruktura dhe rehabilitimi i mjedisit të bregdetit të jugut është komponenti më i rëndësishëm i këtij projekti Nga ky projekt është financuar me sukses edhe ndërtimi i stacionit të transferimit të mbetjeve në Himarë, me vlerë 608 504 dollarë.

Me reformën e re territoriale do t’i shërbejë bashkive Himarë, Delvinë, Sarandë, Finiq dhe Konispol. Nga aktivizimi i këtij landfilli është bërë e mundur mbyllja e vend-depozitimeve

ilegale ekzistuese duke i shërbyer të gjithë zonës bregdetare të jugut I pajisur me impiantin e përpunimit të ujërave, do të reduktojë maksimalisht ndotjen e ujërave nëntokësore Landfilli i Bajkajt vlerësohet të sigurojë grumbullimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve për 20 vitet në vazhdim duke ndikuar ndjeshëm edhe në impaktin turistik të kësaj zone.

Bazuar në të dhëna zyrtare sasia e mbetjeve që gjenerohen nga bashkitë që depozitojnë mbetjet në këtë landfill janë:

Tabela 7-14 Mbetjet që gjenerohen nga bashkitë që depozitojnë në Landfill Bajkaj

Nr	Bashkia	Qyteti qendër	Sasia e mbetjeve (ton/vit)	Distanca nga Landfilli i qendrave të bashkive
1	Sarandë	Qyteti Sarandë	24 000	14 6 km
2	Himarë	Qyteti Himarë	10 500	62 0 km
3	Delvinë	Qyteti Delvinë	7 200	11 0 km
4	Finiq	Fshati Dermish	7 000	21 1 km
5	Konispol	Qyteti Konsipol	5 000	46 4 km
Total			53 700	

Duke konsideruar infrastrukturën rrugore ekzistuese (distancën nga Bajkaj), Bashkia Vlorë dhe Selenicë vazhdojnë të përdorin vend-depozitimet ilegale të cilat përveçse jashtë çdo kapaciteti në to’ mungojnë, totalisht standardet minimale të operimit dhe shfrytëzimit të tyre.

Për zgjidhjen përfundimisht të këtij problemi, për bashkitë Vlorë, Selenicë dhe ato përreth, KfW do mbështesë realizimin e një landfili që do ndërtohet në Sherrishtë të Vlorës.

Kostoja e projektit është parashikuar në vlerën prej 24 350 000 € (duke përfshirë masat shoqëruese), kosto e cila do të financohet nëpërmjet marrëveshjes së huas në fjalë prej 12 000 000 € dhe dy granteve që do të akordohen nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të financimit (në total vlera e granteve 8 834 862 €). Nga fondet e huas prej 12 000 000 eurosh, 10% do t’i kalohen Bashkisë Vlorë në formën e nën-huasë, me të njëjtët terma, si huaja bazë, ndërsa pjesa tjetër do t’i kanalizohet kësaj bashkie, në formë granti.

Buxheti i shtetit do të përballojë kostot lokale që lidhen me shpronësimin e tokës si dhe TVSH-në për projektin, të cilat parashikohen në vlerën 3 500 000 €.

Marrëveshja për këtë qëllim u miratua në parim nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet Vendimit Nr. 864, datë 7 12 2016, dhe pastaj u miratua në Parlament të Ligjit Nr. 74/2017 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, (Përfituesi), dhe KfW Frankfurt am main, (KfW), për programin e menaxhimit të Mbetjeve të ngurta, masat shoqëruese (Rajoni Vlorë)

Bashkia Vlorë referon si vend depozitim kryesor atë afër qytetit Vlorë, në vendin e quajtur “Fusha e Aviacionit”. Ky vend depozitim ndodhet shumë pranë qytetit të Vlorës dhe aktualisht është i rrethuar me shtëpi banimi . Ka një sipërfaqe rreth 12,6 ha dhe është shumë pranë (5-20 m) kanalit të ujërave të zeza, që derdhet në det. Është i rrethuar me një gardh të thjeshtë me lartësi 1m e cila e bën të lehtë hyrjen në brendësi të tij të personave të pa autorizuar dhe kafshëve shtëpiake. Sasia e mbetjeve që depozitohen aty është 140 ton/ditë ose 51100 ton në vit. Nga vend depozitimi largohet një pjesë e plastikës. Është propozuar për mbyllje si vend depozitim që në vitin 2015. Duhet theksuar se ky vend depozitim ndodhet në Zonën B të “Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë-Nartë””, shpallur zonë e mbrojtur me VKM nr.680, datë 22.10.2004. Duke patur parasysh shpërndarjen e popullsisë në territorin e Bashkisë Vlorë, duhet konsideruar që aktualisht përdoren disa vend depozitime përveç atij të cituar më sipër.

Në Njësinë Administrative Qendër, grupi i punës raporton tre vend depozitime: Xhyherinë dhe Nartë dhe Zvërnec, ndër të cilët ai në Xhyherinë është vetëm 50m distancë nga Lumi Vjosë. Në periudhën e reshjeve rritja e prurjeve bën që lumi të marrë një pjesë të mbetjeve dhe ti transportojë ato drejt detit Adriatik. Grupi i punës është shprehur për mbylljen e këtij vend depozitimi, por ndërhyrja e duhur do ishte është largimi. Ndërsa vend depozitimi Zvërnec ndodhet brenda Zonës së mbrojtur “Vjosë-Nartë Peizazh i Mbrojtur Natyror”.

Në njësinë administrative Orikum raportohet vend depozitimi Fushë Biz dhe Ishëm. Vendgrumbullimi ndodhet në juglindje të qytezës së Orikumit në një largësi rreth 380 m nga lagja më e afërt , afër rrugës nacionale Vlorë -Sarandë (70 m), në breg të Lumit të Dukatit dhe 900 m nga deti Adriatik. Këto janë arsytet të cilat shpesh sjellin probleme në shëndetin e banorëve por dhe cenimin e imazhit turistik që ka zona. Në këtë vendgrumbullim depozitohen rreth 9000 ton/vit mbetje urbane. Orikumi është shpallur “Zonë me përparësi turistike “(VKM nr 88, date date 21.04.1993). Në afërsi të vend depozitimit shtrihen zonat e mbrojtura mjedisore të: RNM Karaburun dhe PK Detar Karaburun-Sazan.

Në Njësinë Administrative Novoselë referohet një vend depozitim i cili është në brendësi të fshatit Mifol. Ky vend depozitim është i parrethuar dhe mbetjet e hedhura nuk trajtohen fare. Grupi i punës ka propozuar mbylljen e këtij vend depozitimi, por duke pasur parasysh sipërfaqen jo të madhe, largimi i tyre paraqitet më i thjeshtë dhe efikas. Ky vend depozitim nuk përcaktohet qartësisht si pozicion gjeografik dhe mund të përputhet me atë të referuar nga harta e ish-MZHU, në Novoselë.

Në Njësinë administrative Shushicë nga grupi i punës raportohen dy vend depozitime: Llakatund dhe Sherishtë. Vend depozitimi Llakatund ndodhet shumë pranë Lumit Vjosë dhe mundësia (rreziku) e zhvendosjes së mbetjeve në det nga lumi është i lartë. Sidomos gjatë stinëve me reshje, nga fryrja e lumit dhe përrenjve ndodhin përmbajtje në këtë zonë, ngjarje këto të përsëritura disa herë vitet e fundit që kanë sjellë zhvendosjen e mbetjeve në det. Ndërsa vend depozitimi Sherishtë është brenda qendrave të banuara.

Grupi i punës pranë bashkisë Vlorë, në kuadër të rakordimit të këtij studimi me hartën e vend depozitimeve të hartuar nga ish-MZHU ka bërë njehsimin e tyre duke shtuar gjithashtu dhe shtatë të tjera nga harta dixhitale. Për këto vend depozitime të dhënat e grumbulluara janë kryesisht hartografike (ish-MZHU dhe Google). Ndërhyrja e propozuar për të gjitha këto vend depozitime, për të cilat ja vlen të citohet se tre ndodhen afër brigjeve lumore, është largimi i tyre.

Bashkia Delvinë referon si infrastrukturë të vetme për depozitim të mbetjeve Landfillin Bajkaj, i cili nuk përfshihet në fokus të platformës “Për zbutjen e riskut në vend depozitime”. Në këtë bashki është njehsuar dhe një vend depozitim në kuadër të rakordimit me platformën e ish-MZHU për të cilin bashkia Delvinë ka konfirmuar se përdoret për mbetje inerte dhe mbetje të gurta të cilat nuk pranohen në Landfillin Bajkaj.

Bashkia Himarë referon vetëm një vend depozitim i cili nuk përdoret më, është abandonuar pasi mbetjet dërgohen në Landfillin e Bajkaj. Ky vend depozitim ndodhet pranë rrugës kombëtare Vuno – Himarë. Mbyllja sipas masave jo adekuate që duhen marrë në këto raste shfaq risk mjedisor lidhet me daljen në sipërfaqe të mbetjeve dhe spostimin e tyre, për shkak të pjerrësisë së terrenit, drejt përroit dhe pastaj në det. Kjo ndikon njëkohësisht edhe në riskun dhe ndikimin negativ në komunitetin e banorëve dhe vizitorëve të shumtë që frekuentojnë Himarën. Gjithashtu nga harta dixhitale e ish-MZHU janë identifikuar dhe katër vend depozitime të tjera në këtë bashki, të cilat janë relativisht të vogla, jo me sasi të konsiderueshme mbetjesh, por pastrimi i tyre paraqitet me shumë interes pasi Himara përfaqëson një zonë me atraksion të lartë turistik.

Bashkia Konispol që prej ndërtimit të Landfillit të Bajkaj i dërgon mbetjet urbane në këtë landfill. Grupi i punës në këtë bashki ka raportuar një vend depozitim i cili nuk përdoret më, por megjithatë, ka nevojë për punime mbylljeje. Gjithashtu në bashkinë Konispol janë identifikuar dhe vend depozitime nga harta dixhitale e ish-MZHU, për të cilat bashkia ka deklaruar se nuk përdoren më ose janë ilegale dhe është vendosur për largimin e mbeturinave në dy prej tyre dhe mbylljen e njërit (për shkak të sipërfaqes së madhe).

Bashkia Finiq referon se mbetjet urbane dërgohen në landfillin e Bajkaj dhe ka vetëm një vend depozitim në të cilin depozitohen mbetjet inerte dhe mbetje të tjera të ngurta të cilat nuk pranohen në landfillin e Bajkaj.

Bashkia Sarandë raporton si vend depozitim të vetëm atë në Volloder, i cili që nga viti 2015 përdoret vetëm për mbetjet inerte. Ky vend depozitim ndodhet në afërsi të rrugës kombëtare Nivicë-Sarandë, afër burimit të ujit me emërtim popullor “Volloder”. Sipërfaqe e pambrojtur dhe me mbetje të shumta në sipërfaqe. Pjerrësia e madhe e terrenit dhe prezenca e ujërave sipërfaqësor bën të mundur spostimin dhe shpërndarjen e mbetjeve në zonën përreth.

Bashkia Selenicë prodhon mesatarisht 1100 ton/vit mbetje urbane dhe ka raportuar katër vend depozitime. Vend depozitimi i mbetjeve në qytezën e Selenicës ndodhet në një largësi

500 m linear nga qendra e banuar, në një sipërfaqe toke bujqësore pa fryt pronë e Bashkisë Selenicë. Vend depozitimi ka formën e një gropë me thellësi 2,5 m dhe përmasa 20 X 30 m, e rrethuar dhe e veshur me plastmasë në fundin dhe anët e saj. Në momentin e inspektimit sasia e hedhur në gropë referohet afërsisht 10 % e kapacitetit mbajtës. Vend depozitimi është i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 14, datë 12.05.2014.

Në afërsi Selenicës është identifikuar edhe një vend depozitim nga platforma dixhitale e ish MZHU (VD MZHU 1). Nga afërsia me përroin mund të hamendësohet se mbetjet nga ky vend depozitim të jenë larguar nga rrjedhat ujore drejt Detit Adriatik. Megjithatë për kostimin e ndërhyrjes për këtë vend depozitim janë marrë të dhënat e hartës së ish-MZHU.

Vend depozitimi Kocul ndodhet në afërsi të rrugës Kocul – Pocem, afërsisht 700 m linear larg qendrave të banuara të fshatit Kocul. Sipërfaqja e vend depozitimit është e hapur, pa rrethim dhe në buzë të një përroi. Sipërfaqja me mbetje është rreth 900 m². Rreziku kryesor që shfaq ky vend depozitim është i lidhur me pozicionin e tyre buzë përroit gjë që bën të mundur spostimin e tyre nga reshjet. Në afërsi të mbetjeve ndodhen njëkohësisht dhe puse të nxjerrjes së naftës. Ia vlen për tu theksuar se ky vend depozitim në hartën e ish-MZHU është i pozicionuar në anën tjetër të rrugës (VD MZHU 2). Në këtë studim këto dy raste janë trajtuar si raste më vehte dhe vlera e ndërhyrjes (Largim) është përcaktuar më vehte për secilin rast.

Vend depozitimi Kote i cili përdoret nga banorët e fshatit Vajzë ndodhet në rrugën Vajzë-Kotë. Ky vend depozitim ndodhet në afërsi të shtëpive të banimit. Është i vendosur pranë një përroi. Natyra e mbetjeve është urbane. Rreziku mjedisor ka të bëjë me spostimin e mbetjeve për shkak të pjerrësisë së terrenit dhe afërsisë së përroit.

Vend depozitimi Sevaster ndodhet në afërsi të rrugës auto Vajzë–Sevaster. Përdoret nga banorët e fshatit Sevaster dhe ka një sipërfaqe prej 500-600 m². Rreziku mjedisor ka të bëjë me pozicionin buzë përroit ku është rreziku i spostimit të mbetjeve nga fenomene natyrore apo erozionit të dukshëm në sipërfaqe të tokës. Sipërfaqja e vend depozitimit është e pa mbrojtur dhe e hapur, gjë që shton rrezikun e hyrjes nga persona të pa autorizuar dhe kafshët shtëpiake.

Tabela 7-15 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Vlorë

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	DELVINË	Landfill Bajkaj		
2		Vend-depozitim nga MZHU 1	Largim	5 379 146
3	HIMARË	Vend-depozitimi 17-Bashkia Himare (Visha 325)	Mbyllje	5 251 388
4		Vend-depozitim nga MZHU 1	Largim	589 588
5		Vend-depozitim nga MZHU 2	Largim	240 031
6		Vend-depozitim nga MZHU 3	Largim	828 218
7		Vend-depozitim nga MZHU 4	Largim	885 657
8	KONISPOL	Vend-depozitimi 16 - Konispol	Mbyllje	3 721 361
9		Vend-depozitim nga MZHU 1	Largim	629 429
10		Vend-depozitim nga MZHU 2	Largim	68 979
11		Vend-depozitim nga MZHU 3	Mbyllje	2 494 554
12	FINIQ	Vend-depozitimi 14 - Finiq	Mbyllje	481 551
13	SARANDE	Vend-depozitimi 15 - Sarande (Volloder)	Largim	529 634
14		Vend-depozitim nga MZHU 1	Largim	788 356
15	SELENICË	Venddepozitimi 9 - Selenice	Largim	5 042 467
16		Venddepozitimi 10 - NJ.A. Vllahinë (Kocul)	Largim	529 634
17		Venddepozitimi 12 - NJ.A. Sevaster	Largim	427 099
18		Venddepozitimi 11 - Kote	Largim	243 257
19		Vend-depozitim nga MZHU 1	Largim	1 187 532
20		Vend-depozitim nga MZHU 2	Largim	508 105
21	VLORE	Vend-depozitimi 2 - NJ.A. Qendër (Xhyherine)	Mbyllje	1 384 764
22		Vend-depozitimi 5 - NJ.A. Novosele	Mbyllje	2 063 655
23		Vend-depozitimi 1 "Vlore"	Mbyllje	65 346 997
24		Vend-depozitimi 4 - Orikum	Mbyllje	12 220 984
25		Vend-depozitimi 6 - NJ.A. Shushice	Mbyllje	2 455 802
26		Vend-depozitimi 7 - NJ.A. Shushice (Sherishte)	Mbyllje	1 518 798
27		Vend-depozitimi 8 - NJ.A. Qendër (Zvernec)	Mbyllje	778 442
28		Vend-depozitimi 3 - NJ.A. Qendër (Narte)	Largim	981 372
29		Vend-depozitim nga MZHU 1	Largim	342 030
30		Vend-depozitim nga MZHU 2	Largim	4 449 529
31		Vend-depozitim nga MZHU 3	Largim	1 135 516
32		Vend-depozitim nga MZHU 4	Largim	1 917 998
33		Vend-depozitim nga MZHU 5	Largim	45 854
34		Vend-depozitim nga MZHU 6	Largim	722 318
35		Vend-depozitim nga MZHU 7	Largim	192 895
Total kosto për Qarkun Vlorë				125 328 940

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN VLORE




Fig. 7.24 Vend-depozitimet në Qarkun Vlorë

7.14. Qarku Gjirokastrë

Qarku Gjirokastrë përbëhet nga 7 bashki (Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet dhe Tepelenë). Nga grupet e punës në këtë qark raportohen 8 vend depozitime, më specifikisht nga një vend depozitim për secilën bashki me përjashtim të Bashkisë Përmet në të cilën janë raportuar dy vend depozitime. Gjithashtu 5 nga 8 vend depozitimet e raportuara në këtë qark ndodhen afër lumenjve, megjithatë si vend depozitimet e vetme në bashkitë përkatëse për to është rekomanduar rehabilitim dhe vazhdim i përdorimit të tyre deri kur të ndërtohet një infrastrukturë më e përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve.

Bashkia Dropull ka si vend depozitim të vetëm atë tek Ura e Glinës që ndodhet në një distancë më shumë se 300m nga vendbanimi me i afërt dhe në një distance rreth 1 km larg rrugës nacionale Gjirokastrë - Kakavijë. Pranë këtij vend depozitimi kalon shtrati i lumit Drino (distance prej 20m). Në këtë zonë ndodhen gjithashtu kanalet ujitëse të parcelave në fushën e Dropullit. Duke qenë se kjo zonë është me reliev fushor mund të bëhet shkak për përmblytje të vazhdueshme sidomos gjatë stinëve me reshje kur plotat e lumit rriten dhe shkaktojnë përmblytje të vend depozitimit. Përshkueshmëria e zonës është mesatare sepse struktura e tokës është një përzierje argjile me zhavorre. Vend depozitimi është i qëndrueshëm dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rrëshqitje toke. Gjatë vizitave në terren grupi i punës ka konstatuar prani edhe të mbetjeve inerte përveç atyre urbane . Vend depozitimi i Dropullit, Ura e Glinës nuk është i vendosur në zona të dukshme turistike pra nuk rrezikon degradimin e peizazhit përreth apo vlerave turistike të zonës. Nga tërësia e problematikave që shfaq ky vend depozitim, kryesisht afërsia me Lumin Drino, grupi i punës rekomandon largimin e mbetjeve, pavarësisht se i vetmi në Bashkinë Dropull.

Bashkia Gjirokastrë ka raportuar si vend depozitim të vetëm atë në Gërhot, i cili është funksional prej 15 vjetësh. Ai ndodhet në një distancë më shumë se 600m nga qyteti i Gjirokastrës dhe në distancë rreth 950 m nga rruga nacionale. Pranë këtij vend-depozitimi ka rrjedha të ujërave sipërfaqësore, konkretisht një nga degët e përroit të Cullos e cila është aktive në periudhat e reshjeve të dendura. Distanca nga lumi Drino është rreth 1.5 km ndërsa nga liqeni natyral i Viroit rreth 1200m. Duke qenë se kjo zonë është me reliev kodrinor nuk mund të bëhet shkak për përmblytje. Përshkueshmëria e zonës është e lartë për faktin që ka përbërje zhavorrishte, të sjella nga përroi i Cullos. Vend depozitimi është i qëndrueshëm dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rrëshqitje toke. Gjatë vizitave në terren është konstatuar prani të mbetjeve inerte dhe urbane. Vend depozitimi i Gërhotit nuk është i vendosur në zona të dukshme turistike pra nuk rrezikon degradimin e peizazhit përreth apo ndikim direkt në vlerat turistike të zonës. Në këtë aspekt vlen për tu përmendur afërsia me zonën turistike të mbrojtur të Viroit.

Sa më sipër grupi i punës rekomandon rehabilitimin e këtij vend depozitimi.

Bashkia Këlcyrë referon si vend depozitim të vetëm Varibopin, që ndodhet në një distancë më pak se 300 m nga lumi i Vjosës. Pranë këtij vend depozitimi nuk ndodhen rrjedha të sipërme të ujërave sipërfaqësore apo nëntokësorë duke përfshirë këtu edhe burimet e ujit të pijshëm. Përshkueshmëria e zonës është mesatare me përbërje toke të tipit argjilor. Vend depozitimi është i qëndrueshëm dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rrëshqitje toke. Zona me e afërt e banuar legalisht ndodhet me shume se 300 m larg prandaj nuk ka rrezik direkt të ekspozimit të popullatës ndaj ndotjeve potenciale. Distanca nga rruga nacionale është 500m. Gjatë vizitave në terren është konstatuar prani të mbetjeve inerte dhe urbane. Pavarësisht se në një pozicion të fshehur, afërsia e vend depozitimit me lumin Vjosë ndikon indirekt në degradimin e peizazhit dhe vlerave turistike. Grupi i punës rekomandon rehabilitimin e këtij vend depozitimi.

Bashkia Libohovë depoziton mbetjet prej dhjetë vjetësh në Kodrën e Doftisë Ky vend depozitim ndodhet në një distancë më shume se 800m nga lumi i Suhos dhe 500m nga rezervuari i Doftisë. Pranë këtij vend depozitimi nuk ndodhen rrjedha të sipërme të ujit të pijshëm apo nëntokësorë, ndërsa rrjeti i tubacionit të ujësjellës kanalizimeve UKD ndodhet në një distancë rreth 300m. Zona e pjerrët ku ndodhet vend depozitimi nuk rrezikohet nga përmblytjet ndërsa përshkueshmëria e terrenit është mesatare. Vend depozitimi është i qëndrueshëm dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rrëshqitje toke. Zona me e afërt e banuar legalisht është qyteti i Libohovës dhe fshati Bullo, ku distanca prej tyre është me e madhe se 2 km. Gjatë vizitës në terren u konstatua se kishte prani të mbetjeve urbane dhe atyre inerte. Vend depozitimi i Libohovës nuk është i vendosur në zona të dukshme turistike pra nuk rrezikon degradimin e peizazhit përreth apo vlerës turistike të zonës. Grupi i punës rekomandon rehabilitimin e këtij vend depozitimi.

Bashkia Memaliaj përdor vend depozitim Cepi i Janinave, i cili është i vetmi vend depozitim funksional në këtë bashki. Ndodhet në një distance më shumë se 300 m nga vendbanimi me i afërt që është fshati Memaliaj dhe në një distance rreth 1 km larg rrugës nacionale Memaliaj - Fier. Pranë këtij vend depozitimi, në një distance më pak se 300 m ndodhet shtrati i lumit Vjose. Në këtë zone ka rrjedhje të ujërave sipërfaqësore, përkatësisht përroi i Janinës i cili vazhdimisht ka rrjedhje uji që derdhet në lumin e Vjosës. Pranë këtij përroi është hapur një gropë 10x5x4 nga Bashkia Memaliaj e cila do të shërbente për depozitim të mbetjeve urbane por në inspektimin e kryer ka rezultuar e papërdorur. Ky vend depozitim është në një zone të qëndrueshme dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rrëshqitje toke dhe gjithashtu nuk rrezikohet nga përmblytjet e lumit Vjose (edhe në pikën me kritike të prurjeve). Përshkueshmëria e zonës është mesatare dhe struktura e tokës është një përzierje argjilore me zhavorre. Gjatë vizitës në terren u konstatua se kishte vetëm prani të mbetjeve urbane. Vend depozitimi i Cepit të Janinës nuk është i vendosur në zona të dukshme turistike pra nuk rrezikon degradimin e peizazhit përreth apo vlerës turistike. Në këtë aspekt mund të cilësohet vetëm prania e një zone të shpallur monument natyre, e mbrojtur me VKM, në një distance afërsisht 700m. Grupi i punës rekomandon rehabilitimin e këtij vend depozitimi.

Bashkia Përmet ka raportuar dy vend depozitime (Vend depozitimi i Brackoves dhe atë tek varrezat publike te qytetit). Shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane nuk arrin të mbulojë gjithë territorin e bashkisë. Me këtë shërbim mbulohet kryesisht qyteti i Përmetit, dhe qendrat e njësive administrative si zona që kanë popullsi të konsiderueshme. Në shumë fshatra, veçanërisht ato në zonat malore, ky shërbim nuk ofrohet. Mungesa e standardeve të ofrimit të këtij shërbimi që lidhet me kapacitete të dobëta njerëzore, burime financiare të kufizuara etj., bëjnë që ky shërbim të jetë jo cilësor. Bashkia ka nevojë për makinat dhe infrastrukturën shoqëruese (kosha mbeturinash, peshore etj.), por njëkohësisht edhe për Plan Menaxhimi të Mbetjeve.

Vend depozitimi i Brackoves është një nga vend depozitimet që përdoret në Bashkinë e Përmetit. Ndodhet në distance me shume se 800 nga lumi i Vjosës dhe shume pranë (afërsisht 20m) një përroi që derdhet në këtë lum. Pranë këtij vend depozitimi ndodhen rrjedha të sipërme të ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësorë. Duke qenë se zona është kodrinore-malore, nuk mund të bëhet shkak për përmbytje. Përshkueshmëria e zonës është mesatare. Vend depozitimi është i qëndrueshëm dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rrëshqitje toke. Nga vizita në terren konstatohet se ka prani vetëm te mbetjeve urbane. Vend depozitimi i Brackoves nuk është i vendosur ne zona te dukshme dhe si rrjedhim nuk rrezikon degradimin e peizazhit përreth. Aspekt negativ në lidhje me vlerat turistike të zonës është afërsia me zonën e mbrojtur e Bredhit te Hotovës.

Vend depozitimi ne zonën pranë varrezave te qytetit të Përmetit është një nga vend depozitimet qe është përdorur në të shkuarën për Bashkinë Përmet dhe në momentin e inspektimit nga grupi i punës konsiderohej jo-funksional. Ndodhet në një distancë 300 m nga lumi Vjose dhe pranë këtij vend depozitimi (200 m) kalon përroi i Kajenes qe derdhet direkt ne lumin e Vjosës. Ky përrua furnizohet më së shumti gjatë periudhave me reshje shiu dhe nga filtrimet e shpatit te malit ndërsa gjate stinës se verës është i thate. Duke qenë se zona është kodrinore, nuk mund të rrezikohet nga përmbytjet. Përshkueshmëria e zonës është mesatare dhe përbërja e tokës është flishore, ndërsa ne thellësi te përroit, formacioni rezulton konglomerat. Vend depozitimi është i qëndrueshëm dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rrëshqitje toke. Zona me e afërt e banuar legalisht është zona industriale e qytetit të Përmetit (afërsisht 300m). Gjatë vizitës në terren u konstatua se kishte prani te mbetjeve urbane dhe te atyre inerte. Ky vend depozitim nuk është i vendosur ne zona te dukshme turistike pra nuk rrezikon degradimin e peizazhit përreth. Vend ndodhja shumë të afër varrezave të qytetit rrit mundësinë e ekspozimit te njerëzve.

Grupi i ekspertëve propozon rehabilitim të dy vend depozitimeve.

Bashkia Tepelenë përdor vend depozitim Majkosh, i cili është i vetmi funksional në këtë bashki. Ai ndodhet në një distance me shume se 300 m nga vendbanimi me i afërt që është fshati Majkosh (lagje qyteti) dhe në një distancë rreth 1 km larg rrugës nacionale Tepelene - Memaliaj. Pranë këtij vend depozitimi kalon shume afër (30m) shtrati i lumit Vjosë. Ky vend depozitim është në një zone te qëndrueshme dhe nuk ka rrezik kolapsi apo rrëshqitje toke.

Përshkueshmëria e zonës është mesatare dhe struktura e tokës është një përzierje argjile me zhavorre. Gjatë vizitës në terren u konstatua se kishte prani të mbetjeve urbane dhe të atyre inerte.

Tabela 7-16 Ndërhyrja dhe kostimi i vend-depozitimeve të Qarkut Gjirokastrë

Nr.	Bashkia	Emërtimi i Vend-Depozitimit	Ndërhyrja	Kosto e ndërhyrjes (në Lek)
1	DROPULL	Ura e Glines	Largim	1.645.002
2	GJIROKASTËR	Gerhot	Rehabilitim	10.195.252
3	KËLCYRË	Variboh	Rehabilitim	4.771.835
4	LIBOHOVË	Kodra e Doftis	Rehabilitim	4.360.000
5	MEMALIAJ	Cepi i Janinave	Rehabilitim	3.122.481
6	PËRMET	Brackove	Rehabilitim	5.998.963
7		Tek Varrezat Publike te Qytetit	Rehabilitim	4.193.823
8	TEPELENË	Majkosh	Rehabilitim	5.641.617
Total kosto për Qarkun Gjirokastrë				39 928 973

VEND-DEPOZITIMET NË QARKUN GJIROKASTËR




Fig. 7.25 Vend-depozitimet në Qarkun Gjirokastrë

ANEKSE TË RAPORTIT

Aneks 1 Formular pikëzimi i vend depozitimit

Emri i Vend-depozitimit	Kodi/Emërtimi
Bashkia	
Qarku	

Përmbledhje	
Risku që lidhet me:	REZULTATI
Mbrojtja e ujit	0
Mbrojtja e popullatës dhe shqetësimi	0
Mbrojtja mjedisore dhe atraksion turistik	0
Kriteri i operimit	0
REZULTATI TOTAL	0

Risku që lidhet me të	Kriteret	Pesha	Rezultati
Mbrojtja e ujit			0
Ndotja e ujrave sipërfaqësore	Distanca nga lumi ose në breg të lumit	Ndërmjet 0 dhe 300 m : 0 (përfshirë ligjor) Ndërmjet 300 dhe 800 m : 3 Më shumë se 800 m : 5	<EMPTY>
Ndotja e ujrave sipërfaqësore	Distanca nga bregdeti	Ndërmjet 0 dhe 300 m : 0 (përfshirë ligjor) Ndërmjet 300 dhe 800 m : 3 Më shumë se 800 m : 5	<EMPTY>
Ndotja e ujrave sipërfaqësore	Distanca nga bregu i liqenit / rezervuarit	Ndërmjet 0 dhe 300 m : 0 (përfshirë ligjor) Ndërmjet 300 dhe 800 m : 3 Më shumë se 800 m : 5	<EMPTY>
Ndotja e ujit të pishëm	Rrjedha e sipërme e një burimi uji që përdoret për ujit të pijshëm (ujë sipërfaqësor apo nëntokësor) ose në një zonë të mbrojtur për ujin e pishëm (zona e menjëhershme e mbulimit)	Ndërmjet 0 dhe 300 m : 0 (përfshirë ligjor) Ndërmjet 300 dhe 800 m : 3 Më shumë se 800 m : 5	<EMPTY>
Mbrojtja e ujit / mbrojtja e popullatës	Në një zonë ku mund të ndodhin përmbajtje	Ndërmjet 0 dhe 300 m : 0 Ndërmjet 100 dhe 800 m : 3 Më shumë se 800 m : 5	<EMPTY>
Mbrojtja e ujit / mbrojtja e nëntokës	Gjeologjia e zonës së treguar	Përshkueshmëri e lartë nëntokësore : 0 Përshkueshmëri mesatare nëntokësore : 3 Përshkueshmëri e ulët : 5	<EMPTY>
Mbrojtja e popullatës dhe shqetësimi			0
Popullata / mbrojtja e operatorit	Në një zonë të paqëndrueshme (rrezik rrëshqitje toke)	Mbetjet apo Vend-depozitimi paraqesin risk të konfirmuar kolapsi : 0 Mbetjet apo Vend-depozitimi janë në një zonë potenciale për rrëshqitje toke: 3 Mbetjet apo Vend-depozitimi janë të qëndrueshme dhe nuk ka risk rrëshqitje: 5	<EMPTY>
Ekspozimi i njerëzve ndaj ndotjes potenciale	Zonë e afërt e banuar legalisht	Ndërmjet 0 dhe 100 m : 0 Ndërmjet 100 dhe 300 m : 3 Më shumë se 300 m : 5	<EMPTY>

Prani potenciale e mbetjeve të rrezikshme, risku për operatorin e vend-hedhjes së mbeturinave, banorë në afërsi të zonës dhe mjedisi	Mbetje industriale apo jo-urbane të pranishme në mbetjet hyrëse.	Prania e mbetjeve industriale të rrezikshme : 0 Prania e mbetjeve inerte : 3 Prania e mbetjeve urbane : 5	<EMPTY>
Mbrojtja mjedisore dhe atraksion turistik			0
Degradimi i Peizazhit, ulja e vlerës turistike	Vendosur në vende të dukshme nga zonat turistike	Po : 0 Jo : 1	<EMPTY>
Vende arkeologjike, zonë e trashëgimisë kulturore, dhe zona të tjera të mbrojtura të përcaktuara sipas VKM	Afër zonave të mbrojtura me VKM	Ndërmjet 0 dhe 300 m : 0 (përjashtim ligjor) Ndërmjet 300 dhe 800 m : 3 Më shumë se 800 m : 5	<EMPTY>
Ndotja e florës dhe faunës, ndikimi në turizëm	Në një zonë të mbrojtur natyrore (rezervate natyrore, parqe kombëtare, etj.)	Po : 0 Jo : 1	<EMPTY>
Zjarre në pyje, ndotja e florës dhe faunës	Në një pyll (distanca nga pylli duhet të jetë më e madhe se 10 m për të shmangur zjarret).	Po : 0 Jo : 1	<EMPTY>
Kriteret e operimit			0
vend-depozitimi së shpejti do jetë plot, si rrjedhim nuk janë të përshtatshme	Volumi i shfrytëzimit përfaqëson një kapacitet prej më pak se 1 vit operimi	Disponueshmëria e mbetjeve < 1 vit : 0 Disponueshmëria e mbetjeve < 2 vjet: 1 Disponueshmëria e mbetjeve < 5 vjet: 3 Disponueshmëria e mbetjeve > 5 vjet: 5	<EMPTY>
REZULTATI TOTAL			0

Aneks 2 Urdhër i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT
MINISTRI**

Nr 953 Prot

Tiranë, më 02 / 02 2018

URDHËR

Nr 35, Datë 02 / 02 /2018

“PËR

**NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS TASK - FORCËS
PËR VERIFIKIMIN E VENDEPOZITIMEVE EGZISTUESE DHE
PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE PËR PËRMIRËSIM/REHABILITIM TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 5, të nenit 16, të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 45, i ligji Nr.10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Kapitulli XI, të VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”, neni 24 i ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të Task - Forcës për identifikimin e vendepozitimeve egzistuese, përcaktimin kriterëve për përzgjedhjen e vendepozitimeve që do të konsiderohen për rehabilitim dhe vlerësimin e procedurave të dhënies së lejes së mjedisit për vendepozitimet informale që do të rehabilitohen.
2. Grupi i punës përbëhet si më poshtë sipas Rajoneve:

- Znj. Ornela ÇUÇI.....Kryetar
- Z. Rrezart FSHAZIRajonet Vlorë – Gjirokastrë;
- Z. Polikron HORESHKA.....Rajonet Tiranë – Dibër;
- Znj. Ledjana KARALLIU.....Rajonet Fier – Berat;
- Z. Juldin BRAHOLLI.....Rajonet Kukës – Durrës;
- Znj. Sonila PASHAJ.....Rajonet Elbasan – Korçë;
- Znj. Borana ANTONI.....Rajonet Lezhë – Shkodër;

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë - [hppt//eëë.turizmi.gov.al](http://eëë.turizmi.gov.al)

- Gjashtë (6) Përfaqësues të institucioneve nënvarësie të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si:
 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
 - Inspektoriatit Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU);
 - Agjencinë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);
3. Grupi i punës ka për detyrë koordinimin e punës direkt në terren për indentifikimin e vend depozitimeve të pakontrolluara të mbetjeve urbane, mbledhjen e të dhënave teknike për vlerësimin dhe klasifikimin e tyre sipas përcaktimeve dhe metodologjisë bashkëlidhur me këtë urdhër.
 4. Në bazë të indentifikimit të vend depozitimeve të parregullta të mbetjeve urbane dhe vlerësimit real të tyre, grupi i punës përgatit një raport për cdo venddepozitim dhe një raport të përmbledhur për cdo Qark. Forma dhe përmbajtja e raportit bëhet sipas formatit bashkëlidhur me këtë urdhër.
 5. Grupi i punës raporton tek Kryetari dhe ky i fundit tek Ministri çdo javë mbi ecurinë e punës dhe produktet e realizuara sipas planit të aktiviteteve bashkëlidhur.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTËR
Blendi KLOSI

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë - [hppt//ëëë.turizmi.gov.al](http://eëë.turizmi.gov.al)

Aneks 3 Trajnimet e Grupeve të Punës në nivel lokal

Prefektura Durrës



Prefektura Fier



Prefektura Tiranë



Prefektura Elbasan



Prefektura Lezhë



Prefektura Shkodër



Prefektura Vlorë dhe Gjirokastrë



Prefektura Kukës dhe Dibër



Aneks 4 Vlerësimi i Komitetit Shkencor të Simpoziumit “Trajtimi i mbetjeve dhe sfidat drejt të ardhmes”



Environmental Engineering Department
Faculty of Civil Engineering
Polytechnic University of Tirana



17th of May 2018 Hotel Mondial, Tirana, Albania
18th of May 2018 Hotel Grand, Korça, Albania

Review of Scientific Committee of International Symposium "Waste treatment and the challenges ahead" for “Dumpsite Risk Mitigation” Initiative

May 18, 2018

In the second day of International scientific symposium "Waste treatment and the challenges ahead", Mr. Rikard Luka¹, dldp expert (Decentralization and Local Development Programme), presented the “Initiative - Dumpsite Risk Mitigation”, a process entirely leaded from the Albanian Ministry of Tourism and Environment (MoTE) and supported from dldp through elaboration of the Methodology and training of experts at central and local level. The presentation consisted of 3 main parts:

- **Process and Methodology:** it was described the organization and the structure of the working groups, at local and central level, as well as the expertise involved and the training provided to achieve the scope of the initiative. Further on, there were elaborated the elements of the Methodology in reference to the 14 technical and legal criteria, based on which there were performed the preliminary evaluation of each single dumpsite, the local decision-making process, the intervention measures' catalogue, as well as costing of measures based on national standards. An important evidence was brought up in the presentation showing that the Ministry of Tourism and Environment has already taken steps forward into transposing the recommendations and the interventions proposed by the Methodology in waste sectorial legal frame.
- **Harmonization with other platforms and national strategic planning instruments.** In this part of the presentation there were explained the efforts done aiming to evaluating all the data provided by the local working groups, and to harmonizing these results with other platforms, such as the one administered by the Albanian Ministry of Energy and Infrastructure MoEI (former Ministry of Urban Development). The main outcomes were also treated from the point of view of the two main national strategical documents² that will lead the development of the waste management sector (currently its preparation ongoing from MoEI and MoTE). It was also referred the coordination with National Territory Planning Agency regarding the information contained at the 44 General Local Plans already

¹ Rikard Luka is part-time lecture at Faculty of Civil Engineering (PUT), Department of Mechanics of Structures.

² [Draft] National Strategy of Integrated Waste Management (2018-2033); and [Draft] Report of Investments for Solid Waste Integrated Management (2017-2032) (referred to as the Draft National Master Plan).



approved compared with those gathered from the local field teams related to the the respective geolocations of these dumpsites. All the gathered data was geolocated-referred according to the Albanian Geodesic Frame "KGJSH 2010". Based on this frame a WebGis platform is developed and soon will be accessible on the official page of MoTE.

- **Conclusions and possible Scenarios.** During this last part, there were introduced the results of this Initiative at national level, as well as the average costs per each of the interventions (either rehabilitations, closure or waste dumpsite removal), and the possible scenarios regarding interventions at the waste dumpsites according to national priorities concerning coastal tourism protection, river protections, etc.

Presentation was followed by a session of questions and discussions from the audience (lectors and students), which showed great interest for the performed work.

In conclusion:

1. The Initiative for dumpsite risk mitigation is based on a Methodology that takes into consideration the main environmental risks, as well as the risks for the population that are usually exposed to these facilities. It foresees appropriate intervention measures to mitigate such risks.
2. Costing of intervention measures is based on the National Manuals and the Technical Analysis and takes specifically into account the 13 interventions defined in the catalogue of measures. In some occasions, further technical detailing might be necessary. A margin of error is acknowledged from the author.
3. Decision-making process at local level tends to be more practical rather than technical, giving priority to the solving the problems of the municipality with waste disposal. As a consequence, prior to financial support from the government, in some cases it becomes necessary to assure an intermediary technical expertise taking into account the real conditions of a municipality for the waste dumpsites for a period of 3-5 years.
4. Data validation process and the involvement of a number of relevant actors increase considerably the technical agreement and the possibility that this Initiative is supported from the central and local level authorities.
5. The implemented process combines technical and governance aspects, focusing on the role and features of the local authorities. This Initiative may be used as a Good Practice, replicable in similar cases.

Chair of Scientific Committee

Assoc. Prof. Oltion Marko



Environmental Engineering Department
Faculty of Civil Engineering
Polytechnic University of Tirana



17th of May 2018 Hotel Mondial, Tirana, Albania
18th of May 2018 Hotel Grand, Korça, Albania

INTERNATIONAL SCIENTIFIC COMMITTEE

Alfred Lako	Polytechnic University of Tirana
Blerina Beqaj	Polytechnic University of Tirana
Dritan Profka	Polytechnic University of Tirana
Enkelejda Gjinali	Polytechnic University of Tirana
Entela Çobani	Polytechnic University of Tirana
Konalsi Gjoka	Polytechnic University of Tirana
Ledia Aleksi	Polytechnic University of Tirana
Liljana Rodic	Leiden University of Netherland
Martin Wittmaer	Environmental Protection Institute in Bremen University of Applied Sciences Germany
Mirel Mico	Polytechnic University of Tirana
Neritan Shkodrani	Polytechnic University of Tirana
Oltion Marko	Polytechnic University of Tirana
Ornela Çuçi	Ministry of Turism and Environment
Valbona Karakaçi	Decentralization and Local Developing Program

Aneks 5 Baza Ligjore për menaxhimin e mbetjeve

VKM Nr. 532, datë 05.10.2000 "Për miratimin e studimit "Strategjia dhe Plan i veprimit për biodiversitetin"

Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, datë 4.2.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906 datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"

Vendimi Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"

VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare"

VKM 177, date 31/03/2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe Kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritesë"

Udhëzim nr.8 date 27.11.2007 'Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara.

Ligji Nr.10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër"

VKM Nr.519, datë 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal"

VKM Nr.175, datë 19.1.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"

VKM Nr.897. datë 21.2.2011 "Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Vecanta të Ruajtjes"

Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 'Për mbrojtjen e mjedisit', të ndryshuar; Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', të ndryshuar;

Ligji Nr.10448 date 14.07.2011 I ndryshuar " Per Lejet e Mjedisit "

Ligji Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;

VKM nr. 221, datë 20.02.2013 "Caktimi i Zonave si Brezi i Gjelber i Tiranës"

VKM Nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"

VKM Nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore"

VKM Nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme"

VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"

Vendim Nr. 419, datë 25.06.2014 'Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja'

VKM Nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"

VKM Nr 352, datë 29.04.2015. "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa

VKM Nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"

VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 'Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore';

Ligji Nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.

Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"